



BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS  
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA  
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO



# Raporti Vjetor 2018

P R I S H T I N Ě , Q E R S H O R 2 0 1 9



BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS  
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA  
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

# Raporti Vjetor 2018



## PËRMBAJTJA

Fjala e Kryetarit të Bordit .....	11
Fjala hyrëse e Guvernatorit .....	13
Bordi i Bankës Qendrore dhe Bordi Ekzekutiv .....	15
Struktura organizative e BQK-së, 31 dhjetor 2018 .....	19
1. Përmbledhje ekzekutive .....	20
2. Mjedisi i jashtëm ekonomik .....	25
2.1. Eurozona dhe Ballkani Perëndimor .....	25
3. Ekonomia e Kosovës.....	28
3.1. Sektori real .....	28
3.2. Sektori fiskal .....	31
3.3. Sektori i jashtëm.....	33
3.4. Sektori financiar .....	35
3.5. Projektionet makroekonomike për vitin 2019 .....	48
4. Licencimi dhe rregullimi i sistemit financiar .....	50
4.1. Licencimi .....	50
4.2. Rregullimi .....	55
4.3. Korniza rregullative për institucione mikrofinanciare dhe institucione financiare jobankare.....	57
4.4. Korniza rregullative për sigurues dhe ndërmjetësues në sigurime .....	58
4.5. Korniza rregullative për fonde pensionale.....	60
5. Mbikëqyrja e sistemit financiar .....	61
6. Shërbimet e siguruar për autoritetet, komunitetin financiar dhe publikun .....	65
6.1. Operacionet dhe menaxhimi i parave të gatshme .....	65
6.2. Mirëmbajtja dhe transaksionet e llogarive.....	68
6.3. Sistemi i Pagesave.....	71
6.4. Menaxhimi i Mjeteve .....	79
6.5. Teknologjia Informativë .....	84
6.6. Regjistri i Kredive të Kosovës .....	84
6.7. Aktivitetet në fushën e analizave ekonomike dhe stabilitetit financiar .....	86
6.8. Aktivitetet kryesore në fushën e statistikave gjatë vitit 2018.....	87
6.9. Rishqyrtimi i kërkesave të institucioneve financiare të mbikëqyrura nga BQK-ja.....	88
7. Zhvillimet e brendshme .....	89
7.1. Auditimi i Brendshëm .....	89
7.2. Burimet Njerëzore .....	90
7.3. Aktiviteti ligjor i BQK-së.....	91
7.4. Funkzioni i Menaxhimit të Rrezikut .....	92

8. Marrëdhëniet me jashtë dhe bashkëpunimi ndërkombëtar.....	93
8.1. Marrëdhëniet Ndërkombëtare .....	93
8.2. Komunikimi dhe Edukimi Financiar .....	94
8.3. Asistenca Teknike.....	95
8.4. Integrimet Evropiane .....	96
9. Pasqyrat financiare të BQK-së .....	98
10. Shtojca statistikore .....	147
11. Referencat.....	168

## LISTA E SHKURTESAVE

ACH	Sistemi Automatik i Pagesave Individuale (angl. Automated Clearing House)
AJN	Asetet e Jashtme Neto
AKP	Agjencioni Kosovar i Privatizimit
APR	Asetet e Peshuara ndaj Riskut
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
ATK	Administrata Tatimore e Kosovës
ATM	Bankomat (angl. Automated Teller Machine)
ATP	Agjencionet për Transferimin e Parave
BB	Banka Botërore
BE	Bashkimi Evropian
BEC	Kategoritë Kryesore Ekonomike (angl. Broad Economic Categories)
BEEP	Projekti mbi Përmirësimin e Ambientit Biznesor (angl. Business Environment Enhancement Project)
BERZH	Banka Evropiane për Zhvillim dhe Rindërtim
BIC	Business Identifier Code
BIS	Banka për Rregullimin Ndërkombëtar (angl. Bank for International Settlements)
BKS	Byroja Kosovare e Sigurimeve
BKT	Banka Kombëtare Tregtare
BPB	Banka për Biznes
BPV	Bruto Produkti Vendor
BQE	Banka Qendrore Evropiane
BQK	Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
CEFTA	Marrëveshja e Tregtisë së Lirë e Vendeve të Evropës Qendrore (angl. Central European Free Trade Agreement)
DJI	Dow Jones Industrial Average
DPP	Departamenti i Punës dhe Punësimit
DST	Drejtat Speciale të Tërheqjes
EFSE	Fondi Evropian për Evropën Juglindore (angl. European Fund for Southeastern Europe)
EJL	Evropa Juglindore
EULEX	Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit
EUROSTAT	Drejtoria Gjenerale për Statistika Evropiane
FKPK	Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
FSKP	Fondi Slloveno-Kosovar i Pensioneve
GBP	Great Britain Pound
IAIS	Asociacioni Ndërkombëtar i Mbikëqyrësve të Sigurimeve (angl. International Association for Insurance Supervisors)
ICAAP	Procesi i Brendshëm i Vlerësimit të Mjaftueshmërisë së Kapitalit (angl. the Internal Capital Adequacy Assessment Process)
IÇI	Indeksi i Çmimeve të Importit
IÇK	Indeksi i Çmimeve të Konsumit

IÇP	Indeksi i Çmimeve të Prodhimit
IHD	Investimet e Huaja Direkte
IHH	Indeksi Herfindahl-Hirschman
IJSHEF	Institucione Jofitimprurëse në Shërbim të Ekonomive Familjare
IMF	Institucionet Mikrofinanciare
IOPS	Organizata Ndërkombëtare për Mbikëqyrje të Pensioneve (angl. International Organisation of Pension Supervisors)
KEDS	Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike SH.A
KEK	Korporata Energjetike e Kosovës SH.A
KJP	Kreditë Joperformuese
KKP	Këshilli Kombëtar i Pagesave
KMA	Kthimi Mesatar në Asete
KMB	Komercijalna Banka
KMK	Kthimi Mesatar në Kapital
KTD	Korporatat Tjera Depozituese
MF	Ministria e Financave
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
MTPL	Sigurimi i Autopërgjegjësishë
NLB	Nova Ljubljanska Banka
NREK	Norma Reale Efektive e Këmbimit
PCB	Procredit Bank
PNI	Pozicioni Ndërkombëtare i Investimeve
POS	Pikë e Shitjes (angl. Point of Sale)
pp	Pikë Përqindje
PTK	Posta dhe Telekomit i Kosovës
RBK	Raiffeisen Bank of Kosovo
RKK	Regjistri i Kredive të Kosovës
RTGS	Shlyerja e Pagesave në Kohë Reale (angl. Real Time Gross Settlement)
SEBQ	Sistemi Evropian i Bankave Qendrore
SEKN	Sistemi Elektronik i Kliringut Ndërbankar
SEPA	Zona e Përdorimit të Euros si Njësi e Vetme Pagese (angl. Single Euro Payment Area)
SFR	Swiss Franc
SRK	Sistemi i Regjistrimit të Kontabilitetit
SWIFT	Society for Worldwide International Financial Telecommunication
TEB	Türk Ekonomi Bankasi
TMK	Treguesit e Mjaftueshmërisë së Kapitalit
TPL	Përgjegjësia ndaj Palës së Tretë (angl. Third Party Liability)
TVSH	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar
UNMIK	Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë (angl. United Nations Mission in Kosovo)
USAID	Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (angl. United States Agency for International Development)
VPN	Teknologjia e Enkriptimit dhe Lidhjeve Virtuale



## LISTA E FIGURAVE

1.	Shkalla e inflacionit në Eurozonë -----	25
2.	Rritja vjetore e BPV-së në Ballkanin Perëndimor-----	26
3.	Rritja vjetore e inflacionit në Ballkanin Perëndimor -----	26
4.	Rritja reale e PBB-së-----	28
5.	Norma e inflacionit-----	29
6.	Lëvizja e çmimeve të komponentëve kryesorë-----	29
7.	Indekset e çmimeve të konsumit, prodhimit dhe importit -----	29
8.	Indeksi i vëllimit të prodhimit industrial -----	30
9.	Indeksi i qarkullimit në tregtinë me pakicë-----	30
10.	Regjistrimi i bizneseve,-----	30
11.	Struktura e ndërmarrjeve të reja -----	30
12.	Eksportet, importet dhe bilanci tregtar-----	33
13.	Struktura e eksporteve sipas kategorive -----	33
14.	Struktura e importeve sipas kategorive -----	34
15.	Remitencat -----	34
16.	Struktura e investimeve të huaja direkte sipas komponenteve -----	34
17.	Vlera e asetëve të sistemit financiar të Kosovës-----	35
18.	Asetet e bankave komerciale -----	35
19.	Norma vjetore e rritjes së kredive-----	36
20.	Kreditë e ndërmarrjeve dhe ekonomive familjare-----	36
21.	Kreditë sipas sektorëve të ekonomisë-----	37
22.	Rritja vjetore e kredive sipas sektorëve të ekonomisë -----	37
23.	Struktura e depozitave-----	38
24.	Norma mesatare e interesit në kredi dhe depozita -----	38
25.	Norma mesatare e interesit në kreditë ndaj ekonomive familjare dhe ndërmarrjeve -----	39
26.	Norma mesatare e interesit në kredi, sipas sektorëve të ekonomisë-----	39
27.	Norma mesatare e interesit në depozita -----	39
28.	Norma mesatare e interesit në depozitat për ndërmarrje-----	39
29.	Norma mesatare e interesit në depozitat për ekonomitë familjare -----	39
30.	Profiti neto i sektorit bankar -----	40
31.	Të hyrat dhe shpenzimet e sektorit bankar -----	40
32.	Treguesit e profitabilitetit të sektorit bankar -----	40
33.	Treguesit e kualitetit të portfolios kreditorë dhe norma e rritjes së KJP-ve -----	41
34.	Asetet e sektorit pensional -----	41
35.	Investimet e FKPK-së-----	42
36.	Asetet e sektorit të sigurimeve -----	42
37.	Primet e shkruara dhe dëmet e paguara -----	44

38.	Asetet e sektorit mikrofinanciar-----	46
39.	Vlera e kredive ndaj ekonomive familjare dhe ndërmarrjeve dhe rritja vjetore e kredive-----	46
40.	Rritja e kredive ndaj ndërmarrjeve, sipas sektorëve ekonomikë-----	46
41.	Lizingjet e sektorit mikrofinanciar-----	47
42.	Norma mesatare e interesit në kreditë e sektorit mikrofinanciar-----	47
43.	Norma mesatare e interesit në kredi, sipas sektorëve ekonomikë-----	47
44.	Të hyrat dhe shpenzimet e sektorit mikrofinanciar-----	47
45.	Treguesit e profitabilitetit të sektorit mikrofinanciar-----	47
46.	Treguesit e kualitetit të portofolios kreditore-----	48
47.	Struktura e sistemit financiar në Kosovë-----	51
48.	Rrjeti bankar sipas numrit të degëve/zyrave-----	51
49.	Shpërndarja e popullësisë në Kosovë sipas regjioneve-----	52
50.	Rrjeti i siguruesve-----	52
51.	Furnizimi me para të gatshme-----	65
52.	Pranimi i parave të gatshme-----	65
53.	Furnizimi me kartëmonedha euro sipas denominimeve-----	66
54.	Furnizimi me monedha euro sipas denominimeve-----	66
55.	Pranimi i kartëmonedha euro sipas denominimeve-----	66
56.	Pranimi i monedha euro sipas denominimeve-----	66
57.	Eksporti i parave të gatshme-----	67
58.	Importi i parave të gatshme-----	67
59.	Kartëmonedha të papërshtatshme të tërhequra nga qarkullimi-----	67
60.	Kartëmonedha të papërshtatshme të tërhequra nga qarkullimi nga gjithsej të pranuar-----	67
61.	Kartëmonedha të reja të lëshuara në qarkullim-----	68
62.	Kartëmonedhave të reja të lëshuara në qarkullim në raport me gjithsej të furnizuara-----	68
63.	Kartëmonedha euro të falsifikuara në qarkullim sipas viteve, sipas viteve-----	68
64.	Kartëmonedha euro të falsifikuara të konfiskuara në qarkullim, sipas denominimeve-----	68
65.	Vëllimi i transaksioneve vendore dalëse-----	69
66.	Vlera e transaksioneve vendore dalëse-----	69
67.	Vëllimi i transaksioneve vendore hyrëse-----	70
68.	Vlera e transaksioneve vendore hyrëse-----	70
69.	Vëllimi i transaksioneve ndërkombëtare dalëse-----	70
70.	Vlera e transaksioneve ndërkombëtare dalëse-----	70
71.	Vëllimi i transaksioneve ndërkombëtare hyrëse-----	71
72.	Vlera e transaksioneve ndërkombëtare hyrëse-----	71
73.	Evoluimi i depozitave të klientëve kryesorë të BQK-së-----	71
74.	Numri i transaksioneve në SPN-----	73
75.	Vlera e transaksioneve në SPN-----	73
76.	Mesatarja ditore e numrit të transaksioneve në SPN-----	73

77.	Mesatarja ditore e vlerës së transaksioneve në SPN -----	73
78.	Vëllimi vjetor i transaksioneve të SPN-së sipas llojeve të tyre -----	73
79.	Vlera vjetore e transaksioneve të SPN-së sipas llojeve të tyre -----	73
80.	Numri i transaksioneve sipas sesioneve në SPN-----	74
81.	Vlera e transaksioneve sipas sesioneve në SPN-----	74
82.	Numri i kartelave të debitit sipas llojit -----	76
83.	Numri i kartelave të kreditit sipas llojit -----	76
84.	Numri i terminaleve ATM-----	77
85.	Numri i terminaleve POS-----	77
86.	Vëllimi vjetor i transaksioneve të instrumenteve elektronike të pagesave -----	77
87.	Vlera vjetore e transaksioneve të instrumenteve elektronike të pagesave-----	77
88.	Portofolio e rezervave të BQK-së-----	79
89.	Raporti i shpërndarjes së investimeve të portofolit të BQK-së -----	80
90.	Saldo përfundimtare e mjeteve të investuara sipas gjendjes së tyre më 31 dhjetor të viteve përkatëse -----	81
91.	Shpërndarja e portofolios investuese në çdo fundvit -----	81
92.	Struktura e Letrave me Vlerë të Qeverisë sipas afatit të maturimit -----	82
93.	Struktura e pjesmarrësve në ankande -----	83
94.	Normat mesatare vjetore të kthimit për vitin 2017 dhe 2018 -----	83
95.	Ankandet e Letrave me Vlerë të Qeverisë në vitin 2018-----	83
96.	Numri i hulumtimeve në sistemin e RKK-së -----	84
97.	Numri i kredive të aprovuara në sistemin e RKK-së -----	85
98.	Numri i kërkesave për raportet kreditore-----	85
99.	Rangimi i Kosovës në raportin “Doing Business 2019” -----	85
100.	Struktura sipas edukimit-----	90

## LISTA E TABELAVE

1.	Rritja reale vjetore e BPV-së-----	25
2.	Numri i institucioneve financiare -----	35
3.	Struktura e aseteve të sektorit bankar-----	36
4.	Struktura e detyrimeve të sektorit bankar-----	38
5.	Prime nga sigurimet Jojetë-----	44
6.	Primet e shkruara bruto sipas klasave të biznesit -----	45
7.	Rezultati financiar në miliona euro -----	45
8.	Shpërndarja gjeografike e degëve dhe zyrave të bankave -----	51
9.	Rrjeti i siguruesve sipas shpërndarjes gjeografike -----	52
10.	Rrjeti i IMF-ve sipas shpërndarjes gjeografike -----	53
11.	Rrjeti i IFJB-ve sipas shpërndarjes gjeografike -----	53
12.	Struktura e kërkesave të sistemit financiar të miratura/refuzuara nga BQK -----	54
13.	Numri i ekzaminimeve në banka-----	61
14.	Numri i ekzaminimeve në IMF dhe IFJB-----	61
15.	Numri i ekzaminimeve të sektorit të sigurimeve-----	62
16.	Numri i ekzaminimeve -----	63
17.	Numri i ekzaminimeve -----	63
18.	Numri i ankesave sipas institucionevei-----	64
19.	Numri i ankesave sipas institucioneve -----	64
20.	Shuma e transaksioneve sipas llojeve kryesore të pagesave -----	69
21.	Niveli i depozitave të klientëve kryesorë -----	71
22.	Treguesit e përqendrimit për transaksionet e iniciuara/dërguara në SPN-----	75
23.	Numri i llogarive -----	78
24.	Tabela krahasuese e instrumenteve dhe terminaleve të pagesave -----	78

## Fjala e Kryetarit të Bordit

Në përmbushje të detyrave ligjore mbi bazën e transparencës dhe llogaridhënies, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) ka hartuar Raportin Vjetor për vitin 2018. Ky raport përmban të dhëna të rëndësishme lidhur me zhvillimet ekonomike globale dhe zhvillimet në ekonominë dhe sistemin financiar të vendit, përfshirë këtu aktivitetin e detajuar të BQK-së gjatë vitit të kaluar.

BQK-ja në ushtrimin e veprimtarisë së saj ka për qëllim përmbushjen e objektivave dhe detyrave të përcaktuara me Ligjin për BQK-në. Realizimi i objektivave dhe detyrave si më sipër bazohet në një proces të vendimmarrjes i cili udhëhiqet nga parimet e ligjshmërisë, profesionalizmit, pavarësisë dhe transparencës.

Bordi i BQK-së (Bordi) si organi me i lartë vendimmarrës ka ushtruar kompetencat e tij në përputhje me Ligjin për BQK-në dhe aktet tjera juridike relevante në fuqi. Aktiviteti i Bordit ka qenë i orientuar në drejtim të përmbushjes së detyrimeve kushtetuese dhe ligjore të BQK-së duke bashkërenduar aktivitetet me menaxhmentin, si dhe duke mbikëqyrur këtë të fundit në funksion të zbatimit të politikave dhe operacioneve të institucionit. Duke qenë proaktiv në avancimin e kornizës juridike në sektorin financiar, kemi arritur të kemi një sektor financiar stabil, duke ndikuar njëkohësisht në rritjen e ndërmjetësimit financiar, uljen e kostos së ndërmjetësimit financiar, rritjen e konkurrencës dhe zgjerimin e gamës së produkteve të ofruara për shfrytëzuesit e shërbimeve financiare, si dhe në përgjithësi mbështetjen e zhvillimit ekonomik të vendit.

Zhvillimet e reja në legjislacionin e BE-së dhe të institucioneve financiare ndërkombëtare, kanë ndikuar në rritjen e dinamikës së aktivitetit të Bordit në veçanti dhe të BQK-së në përgjithësi, në funksion të harmonizimit të kornizës rregullative me zhvillimit e lartcekura. Ndërlidhur me këtë, Bordi gjatë vitit 2018 ka qenë i fokusuar në avancimin e kornizës rregullative financiare me qëllim të krijimit të infrastrukturës juridike gjithëpërfshirëse dhe në harmoni me zhvillimet e reja të legjislacionit të BE-së dhe praktikave më të mira ndërkombëtare.

Përveç aktiviteteve të mësipërme, Bordi gjithashtu është përkujdesur që BQK të jetë një kontribuues aktiv në avancimin e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe në përmbushjen e detyrave të saj lidhur me realizimin e Planit Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit si dhe të kërkesave të tjera lidhur me integrimet evropiane.

Duke u mbështetur në të arriturat e BQK-së gjatë vitit 2018, shpreh falënderim të veçantë për menaxhmentin dhe stafin e BQK-së dhe njëkohësisht përkushtimi dhe profesionalizmi i tyre premtan suksese të tjera në të ardhmen.

Faleminderit!

**Flamur MRASORI**



**Kryetar i Bordit të Bankës Qendrore**

**të Republikës së Kosovës**



## Fjala hyrëse e Guvernatorit

Zhvillimet ekonomike ndërkombëtare në përgjithësi ishin pozitive gjatë vitit 2018. Sidoqoftë, norma e rritjes ekonomike në Eurozonë, megjithëse ishte pozitive, rezultoi me ngadalësim të ritmit të rritjes në krahasim me vitin paraprak. Në anën tjetër, ekonomitë e Ballkanit Perëndimor në përgjithësi shënuan përsheptim të ritmit të rritjes ekonomike, përderisa treguesit e nivelit të përgjithshëm të çmimeve treguan për stabilitet në normën e inflacionit, e cila vazhdon të jetë e moderuar. Aktiviteti kreditor në këto vende vazhdoi të rritet, por në përgjithësi ritmi i rritjes së kreditimit ishte më i ulët në krahasim me vitin paraprak.

Kosova vazhdoi të ketë normë pozitive të rritjes ekonomike edhe gjatë vitit 2018, si rezultat i rritjes së konsumit dhe investimeve si të sektorit privat ashtu edhe të sektorit publik. Përsheptimi i rritjes së investimeve kapitale të Qeverisë, rritja e qëndrueshme e kreditimit nga ana e sektorit bankar, si dhe rrjedha e qëndrueshme e dërgesave të emigrantëve shërbyen si burime të rëndësishme të financimit të rritjes ekonomike në vend. Megjithatë duhet theksuar se deficit i lartë tregtar, i cili është pasojë e mospërputhjes së lartë ndërmjet vlerës së eksporteve dhe të importeve, vazhdon të ndikojë negativisht në rritjen ekonomike.

Ekonomia e Kosovës edhe gjatë vitit 2018 ka vazhduar të karakterizohet me tregues të favorshëm të stabilitetit makroekonomik. Norma e inflacionit ka vazhduar të jetë e moderuar dhe në nivel të përafërt me vitin paraprak, përderisa treguesit e shëndetit fiskalë dhe financiarë vazhdojnë ta vendosin Kosovën në një pozicion shumë të favorshëm në krahasim me vendet e rajonit, por edhe më gjerë.

Zgjerimi i aktivitetit të sistemit financiar të Kosovës ka vazhduar edhe gjatë vitit 2018, përderisa treguesit e shëndetit financiar vazhdojnë të konfirmojnë stabilitetin e sektorit financiar. Sektori bankar ka vazhduar të zgjerojë kreditimin për sektorin privat dhe mbetet burim shumë i rëndësishëm i financimit të konsumit dhe investimeve. Normat e interesit në kredi kanë vazhduar trendin rënës, duke përmirësuar kështu edhe më tutje kushtet e qasjes në financimin bankar. Cilësia e mirë e portofolit kreditor, e cila në vazhdimësi ka shërbyer si tipar dallues i sektorit bankar të Kosovës, ka vazhduar të jetë e tillë, madje me përmirësim të mëtejshëm në krahasim me vitin paraprak.

Sektori pensional vazhdoi të zgjerojë bazën e kontributeve të arkëtuara, përderisa kthimi në investime u karakterizua me luhatje si rezultat i zhvillimeve që karakterizuan tregjet financiare ndërkombëtare, sidomos gjatë tremujorit të fundit të vitit 2018. Sektori i sigurimeve vazhdoi të ketë performancë financiare pozitive, duke reflektuar kështu një përmirësim të qëndrueshëm të gjendjes së këtij sektori, përderisa shfitytëzimi i produkteve të sigurimeve në ekonominë tonë vazhdoi të rritet. Institucionet mikrofinanciare dhe ato financiare jobankare mbetën një burim i besueshëm i financimit, sidomos për ekonomitë familjare dhe bizneset e vogla, duke luajtur kështu një rol të rëndësishëm në financimin e ekonomisë së vendit.

Roli i BQK-së në ofrimin e një sistemi financiar stabil dhe në funksion të zhvillimit ekonomik ka vazhduar të rritet si rrjedhojë e zhvillimit të vazhdueshëm të kapaciteteve të BQK-së. Avancimi i kornizës rregullative për sektorin financiar dhe harmonizimi i vazhdueshëm me standardet ndërkombëtare, së bashku me zhvillimin e vazhdueshëm të kapaciteteve mbikëqyrëse, paraqesin shtylla shumë të rëndësishme për mbështetjen e zhvillimit të qëndrueshëm të sistemit financiar. Mbrojtja e të drejtave të konsumatorëve të shërbimeve financiare ka vazhduar të ketë vëmendje të shtuar nga ana e BQK-së, e cila ka rritur intensitetin e angazhimeve rreth trajtimit të ankesave dhe gjithashtu ka shtuar aktivitetet që kanë të bëjnë me edukimin financiar të publikut.

Në vijim, më lejoni të ju prezantoj Raportin Vjetor të BQK-së për vitin 2018, i cili ofron një pasqyrë të detajuar të zhvillimeve ekonomike dhe financiare, si dhe një raport të detajuar të aktiviteteve

sipas fushave të ndryshme të veprimit në kuadër të BQK-së. Raporti po ashtu përmban raportin e auditorit të pavarur dhe pasqyrat financiare të audituara, të cilat konfirmojnë qeverisjen e mirë që ka karakterizuar BQK-në edhe gjatë vitit 2018.

Fehmi MEHMETI



Guvernator i Bankës Qendrore  
të Republikës së Kosovës



## Bordi i Bankës Qendrore dhe Bordi Ekzekutiv

### Bordi i Bankës Qendrore

Procesi i vendimmarrjes në Bordin e BQK-së udhëhiqet nga parimet e ligjshmërisë, profesionalizmit, pavarësisë dhe transparencës.

Aktivitetet e Bordit të Bankës Qendrore kanë qenë të orientuara në përmbushjen e kompetencave dhe detyrave të përcaktuara me Ligjin për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës. Për këtë qëllim, Bordi i Bankës Qendrore ka mbajtur takime të vazhdueshme në të cilat është informuar dhe është diskutuar lidhur me ecuritë e përgjithshme të sistemit financiar në Kosovë.

Gjatë vitit 2018, Bordi i Bankës Qendrore ka mbajtur gjithsej 13 mbledhje në të cilat janë marrë gjithsej 24 vendime.

Bordi i Bankës Qendrore, si një nga organet vendimmarrëse të BQK-së, ka shqyrtuar dhe ka aprovuar nxjerrjen dhe plotësimin e rregulloreve nga fusha e sistemit financiar bazuar në rekomandimet e Bordit Ekzekutiv, si në vazhdim:

- Rregullore për licencimin e trajtuesve të dëmeve në sigurime;
- Rregullore për sistemin e pagesave ndërbankare;
- Rregullore për faktoringun;
- Rregullore për menaxhuesit e mjeteve pensionale;
- Rregullore për themelimin e pensionit plotësues individual nga ofruesit e pensioneve;
- Rregullore për themelimin e fondit flotësues pensional të punëdhënësit;
- Rregullore për financimin dhe vlerësimin aktuarial të pensioneve me shuma të caktuara;
- Rregullore për adekuatshmërinë e kapitalit të bankave;
- Rregullore për treguesin e leverazhit;
- Rregullore për procesin e vlerësimit të brendshëm të mjaftueshmërisë së kapitalit;
- Rregullore për auditimin e jashtëm të institucioneve financiare jobankare;
- Rregullore për kontrollet e brendshme dhe auditimin e brendshëm të institucioneve financiare jobankare;

Bordi i Bankës Qendrore, gjithashtu ka miratuar:

- Raportin Vjetor të BQK-së për vitin 2017;
- Pasqyrat Financiare të BQK-së për vitin 2017 dhe Raportin e Auditorit të Pavarur;
- Buxhetin e BQK-së për vitin 2019;
- Planin vjetor të Auditimit të Brendshëm për vitin 2019;
- Raportet dhe pasqyrat periodike të gjendjes financiare të BQK-së.

Me qëllim të përmbushjes së kompetencave të përcaktuara me ligj, Bordi i Bankës Qendrore me kohë ka kryer të gjitha detyrat lidhur me:

- Zbatimin e procesit të nominimeve dhe emërimeve në kuadër të kompetencave të përcaktuara me Ligjin e BQK-së;

- Shqyrtimin e të gjitha raporteve dhe rekomandimeve të Bordit Ekzekutiv dhe Guvernatorit, me qëllim të përmbushjes së stabilitetit financiar.

Gjithashtu, Bordi ka ushtruar edhe detyra tjera të cilat kanë qenë në harmoni me Ligjin për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës dhe legjislacionin tjetër në fuqi.

Më 31 dhjetor 2018, Bordi i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës përbëhej nga anëtarët e mëposhtëm:

Flamur Mrasori, Kryetar i Bordit të Bankës Qendrore;

Fehmi Mehmeti, Guvernator;

Behxhet Brajshori, Anëtar;

Nuhi Ahmeti, Anëtar.

Gjatë vitit 2018 një pozitë e anëtarit joekzekutiv të Bordit të Bankës Qendrore ka qenë vakante.

### **Komiteti i Auditimit**

Në pajtim me nenin 62 të Ligjit nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës dhe Statutin e Komitetit të Auditimit është themeluar dhe funksionon Komiteti i Auditimit.

Objektivat e Komitetit të Auditimit janë që të ndihmojë Bordin e Bankës Qendrore në lidhje me përmbushjen e përgjegjësisë në relacion me veprimin e auditimit të brendshëm dhe të jashtëm, kontrolleve të brendshme, etikën afariste dhe qeverisjen transparente, si dhe për raportin financiar të BQK-së. Komiteti i Auditimit, ndër të tjera ka për qëllim të sigurojë që auditimi i brendshëm dhe ai i jashtëm kryejnë auditime të pavarura, objektive dhe profesionale.

Komiteti i Auditimit emërohet nga Bordi i Bankës Qendrore dhe përbëhet prej tre anëtarëve (dy anëtarë joekzekutiv të zgjedhur nga radhët e Bordit të Bankës Qendrore dhe një anëtar – ekspert i jashtëm nga fusha e kontabilitetit dhe auditimit).

Më 31 dhjetor të vitit 2018, Komiteti i Auditimit përbëhej nga këta anëtarë:

Prof. Dr. Behxhet Brajshori, Kryetar i Komitetit të Auditimit;

Nuhi Ahmeti, Anëtar; dhe

Prof. Dr. Arben Dermaku, Anëtar i Jashtëm.

Komiteti i Auditimit gjatë vitit 2018 ka mbajtur gjithsej 5 takime. Në takimet e Komitetit janë trajtuar çështje të ndryshme të cilat kanë të bëjnë me fusha të cilat gjenden nën fushëveprimin e tij në kontekst të rishikimit dhe mbikëqyrjes. Komiteti i Auditimit, gjatë vitit 2018 ka zhvilluar një numër aktivitete, ndër të cilat:

- Ka shqyrtuar rezultatet e auditimit të prezantuara në raportet tremujore dhe vjetor të auditimit të brendshëm;
- Ka shqyrtuar Planin Vjetor të Auditimit të Brendshëm për vitin 2019 të propozuar për aprovim në Bord të BQK-së;
- Ka shqyrtuar rezultatet e Auditimit të Jashtëm për periudhën 2017;
- Ka vazhduar të kontribuojë në procesin e zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga vlerësues të jashtëm të pavarur dhe ka ndihmuar Menaxhmentin në këtë drejtim; si dhe
- Ka zhvilluar aktivitete të tjera të rëndësishme që kanë të bëjnë me fushëveprimin e tij.

## Bordi Ekzekutiv

Bordi Ekzekutiv i BQK-së përbëhet nga Guvernatori, që është kryesues i Bordit Ekzekutiv dhe zëvendësguvernatorët. Më 31 dhjetor 2018, Bordi Ekzekutiv përbëhej nga Fehmi Mehmeti, Guvernator, Lulzim Ismajli, Zëvendësguvernator për Operacione Bankare dhe Sokol Havolli, Zëvendësguvernator për Mbikëqyrje Financiare. Bordi Ekzekutiv është i ngarkuar me zbatimin e politikave dhe operacioneve të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës. Kompetencat e Bordit Ekzekutiv janë të përcaktuara me Ligjin për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës.


Gjatë vitit 2018, Bordi Ekzekutiv ka mbajtur 25 mbledhje. Në kuadër të kompetencave të tij, Bordi Ekzekutiv gjatë vitit 2018 ka shqyrtuar dhe rekomanduar për miratim në Bordin e Bankës Qendrore 12 rregullore të aplikueshme për sistemin financiar të vendit, raportin vjetor të BQK-së për vitin 2017, pasqyrat financiare të audituara për vitin 2017, pasqyrat financiare tremujore, si dhe buxhetin e BQK-së për vitin 2019. Po ashtu gjatë vitit 2018, Bordi i Bankës Qendrore është njoftuar rregullisht mbi ushtrimin e detyrave dhe kompetencave të Bordit Ekzekutiv.

Bordi Ekzekutiv në pajtim me legjislacionin në fuqi gjatë vitit 2018 ka miratuar një udhëzim dhe një manual udhëzues metodologjik të aplikueshëm për sistemin financiar të vendit. Në të njëjtën sferë të kompetencave, Bordi Ekzekutiv ka miratuar regjistrimin e shtatë institucioneve financiare jobankare si dhe transformimin në bankë të një dege të bankës së huaj. Në fushën e mbikëqyrjes financiare, Bordi Ekzekutiv ka revokuar regjistrimin e dy institucioneve financiare jobankare dhe licencat e katër institucioneve në sektorin e sigurimeve. Në të njëjtën periudhë, në funksion të arritjes së objektivave dhe duke u bazuar në detyrat mbikëqyrëse të realizuara nga njësitë organizative përgjegjëse, në 13 raste janë miratuar masa ndëshkuese-administrative ndaj institucioneve financiare dhe palëve të lidhura.

Në fillim të vitit 2018, Bordi Ekzekutiv ka miratuar raportimin periodik lidhur me implementimin e planit strategjik të BQK-së për vitin 2017, ndërsa në fund të vitit ka miratuar planin e ri strategjik për periudhën 2019-2021. Po ashtu Bordi Ekzekutiv ka miratuar nxjerrjen/ndryshimin dhe plotësimin e 11 akteve juridike të brendshme ku përfshihen politika dhe rregulla të brendshme, plane dhe të ngjashme, si dhe ka mbikëqyrur raportimet e organeve të brendshme relevante për ushtrimin e kompetencave të tij. Bordi Ekzekutiv ka ushtruar edhe detyra të tjera në pajtim me legjislacionin në fuqi.



Struktura organizative e BQK-së, 31 dhjetor 2018





## 1. Përmbledhje ekzekutive

Pasigurinë e rritura në mjedisin e jashtëm ekonomik gjatë vitit 2018 u përkthye në rritje më të ngadalëshme ekonomike në Eurozonë prej 1.8 përqind, në krahasim me rritjen prej 2.4 përqind në vitin 2017, përderisa projeksionet e BQE-së sugjerojnë për një rritje më të ngadalshme ekonomike edhe në tri vitet e ardhshme (1.5 përqind në vitin 2021). Pritjet për rritje më të ngadalëshme kryesisht mbështeten në rënien potenciale të besueshmërisë së bizneseve dhe të individëve në periudhat në vazhdim si pasojë e rritjes së pasigurive lidhur me marrëdhëniet e ardhshme tregtare, shtrëngimin e kushteve të financimit dhe ngadalësimin e rritjes ekonomike të Kinës. Kryesisht si rezultat i politikës ekspansioniste monetare, shkalla mesatare e inflacionit në Eurozonë shënoi rritje në 1.7 përqind në vitin 2018, duke ju afruar objektivit të BQE-së prej afër por nën 2 përqind. Parashikimi për shkallën vjetore të inflacionit për vitin 2019 është rreth 1.6 përqind, ndërsa prospektet për një ngadalësim të rritjes ekonomike kanë ndikuar që parashikimet për periudhën afatmesme të mos jenë edhe aq optimiste sa i përket arritjes së nivelit të përcaktuar me objektivat monetare.

Në vendet e Ballkanit Perëndimor për dallim nga Eurozona, rritja e aktivitetit ekonomik në përgjithësi është përshpejtuar gjatë vitit 2018, megjithëse me ritëm të ndryshëm ndërmjet vendeve. Normat mesatare e rritjes ekonomike në vendet e rajonit vlerësohet të ketë arritur në 3.4 përqind gjatë vitit 2018, mbështetur kryesisht nga rritja e kërkesës së brendshme. Për vitin 2019, parashikimet e FMN-së sugjerojnë se norma e rritjes ekonomike në vendet e Ballkanit Perëndimor do të jetë e ngjashme me vitin 2018.

Në vitin 2018, sipas vlerësimeve tremujore të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), ekonomia e Kosovës ka shënuar rritje reale prej 3.9 përqind. Kjo rritje e aktivitetit ekonomik është gjeneruar kryesisht nga rritja e investimeve dhe konsumit. Në anën tjetër, eksportet neto, si pasojë e rritjes së theksuar të importit por edhe ngadalësimit të rritjes së eksportit, ndikuan negativisht në rritjen e BPV-së. Ngjashëm me vitin paraprak, rritja e aktivitetit ekonomik në vitin 2018 vlerësohet të jetë mbështetur kryesisht nga sektori i tregtisë, pasuar nga sektori i ndërtimtarisë, si dhe sektori i aktiviteteve financiare dhe të sigurimit. Ndërsa, rënie vlerësohet të jetë shënuar te sektori i industrisë nxjerrëse dhe sektori i furnizimit me energji elektrike, gaz, ujë. Vlerësimet për rritjen e vlerës së shtuar në sektorin e tregtisë mbështeten edhe nga indeksi i qarkullimit të këtij sektori, i cili shënoi rritje. Në anën tjetër, indeksi i vëllimit të prodhimit industrial në vitin 2018, në mesatare është karakterizuar me rënie të lehtë, ndikuar kryesisht nga rënia e indeksit tek industria nxjerrëse, industria përpunuese dhe furnizimi me rrymë. Parashikimet e BQK-së për vitin 2019 sugjerojnë se norma reale e rritjes së BPV-së pritet të jetë rreth 4.2 përqind.

Në vitin 2018, ngadalësimi i rritjes së çmimeve të importit është reflektuar edhe në ngadalësimin e rritjes së çmimeve në ekonominë e Kosovës. Norma mesatare vjetore e inflacionit, shprehur përmes indeksit të çmimeve të konsumit, ishte 1.1 përqind (1.5 përqind në vitin 2017).

Statistikat e tregut të punës në Kosovë tregojnë për shkallë të lartë të normës së papunësisë, mirëpo krahasuar me vitin paraprak, rezulton të jetë shënuar një rënie e lehtë. Shkalla mesatare e papunësisë në vitin 2018 ishte 29.6 përqind apo 0.9 pikë përqindje më e ulët krahasuar me vitin paraprak. Në anën tjetër, është raportuar edhe për rënie të shkallës së pjesëmarrjes në fuqinë punëtore. Në vitin 2018, shkalla e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore në Kosovë ishte 40.9 përqind, që krahasuar me vitin 2017, tregon për një rënie të shkallës së pjesëmarrjes në fuqinë punëtore për 1.9 pikë përqindje.

Sektori fiskal u karakterizua me rritje më të lartë të shpenzimeve buxhetore krahasuar me të hyrat. Shpenzimet buxhetore arritën vlerën prej 1.92 miliardë euro që paraqet një rritje vjetore prej 10.3 përqind, përderisa të hyrat buxhetore arritën vlerën neto prej 1.76 miliardë euro, që

paraqet një rritje vjetore prej 4.5 përqind. Rrjedhimisht, buxheti i Kosovës regjistroi deficit primar buxhetor prej 162.7 milionë euro, apo 2.4 përqind e BPV-së, krahasuar me deficitin prej 59.0 milionë euro në vitin 2017, apo 0.9 përqind e BPV-së. Borxhi publik në vitin 2018 ka arritur në 1.1 miliardë euro, që është për 9.7 përqind më i lartë krahasuar me vitin 2017. Si përqindje e BPV-së, borxhi publik ka arritur në 17.1 përqind nga 16.6 përqind sa ishte në vitin 2017.

Spektori i jashtëm i Kosovës u karakterizua me rritje të deficitit të llogarisë rrjedhëse dhe kapitale në 551.7 milionë euro (8.2 përqind e BPV-së), një rritje vjetore prej 39.7 përqind, kryesisht si pasojë e rritjes së deficitit të mallrave, si dhe zvogëlimit të bilancit pozitiv të shërbimeve. Në anën tjetër, bilancet pozitive të llogarisë së të ardhurave parësore dhe dytësore shënuan rritje. Rënia e eksportit të mallrave si dhe rritja e konsiderueshme e importit ka ndikuar që deficitin në tregtinë e mallrave të shënojë rritje prej 11.3 përqind dhe të arrijë në rreth 3.0 miliardë euro (44.6 përqind e BPV-së). Remitencat e pranuar në Kosovë, që njëherësh paraqesin edhe kategorinë më të madhe në kuadër të llogarisë së të ardhurave dytësore, arritën vlerën prej 800.5 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 5.4 përqind. Në kuadër të llogarisë financiare, Investimet e Huaja Direkte (IHD) në Kosovë shënuan rënie vjetore prej 16.3 përqind dhe arritën vlerën prej 213.7 milionë euro.

Rritja vjetore e gjithsej asetëve të sistemit financiar të Kosovës prej 6.9 përqind në vitin 2018 i atribuohet kryesisht zgjerimit të asetëve të sektorit bankar, pasuar nga sektori mikrofinanciar. Asetet e sektorit bankar në vitin 2018 shënuan rritje vjetore prej 8.2 përqind, duke arritur vlerën prej 4.19 miliardë euro. Rritja e asetëve të sektorit gjatë vitit 2018 i atribuohet kryesisht dinamikave pozitive me të cilat u karakterizua aktiviteti kreditor, aktivitetet që u mbështet si nga përmirësimi i kushteve të financimit nga ana e bankave, ashtu edhe nga rritja e kërkesës për kredi. Ndër tjerash, oferta kreditore u ndikua pozitivisht nga presionet e konkurrencës, pozita e favorshme e likuiditetit dhe përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë së portofolit kreditor. Për të tretin vit me radhë, kreditë e sektorit bankar u karakterizuan me rritje vjetore dyshifrore prej 10.9 përqind në vitin 2018 dhe arritën vlerën prej 2.76 miliardë euro. Në të njëjtën periudhë, depozitat në sektorin bankar të Kosovës arritën vlerën prej 3.36 miliardë euro dhe shënuan rritje vjetore prej 8.7 përqind (6.8 përqind në vitin 2017).

Treguesit e performancës dhe shëndetit financiar të sektorit bankar vazhdojnë të reflektojnë shkallë të lartë të stabilitetit. Profiti i realizuar gjatë vitit 2018 arriti në 88.0 milionë euro, që përkon me një rritje vjetore prej 3.0 përqind. Sektori bankar vazhdon të ketë nivel dhe cilësi të lartë të kapitalit. Megjithatë, shpërndarja e dividendës nga disa banka, si dhe rritja e vazhdueshme e kreditimit ndikoi në rritjen më të lartë të mjeteve të peshuara me rrezik, gjë që u reflektua në rënie të treguesit të mjaftueshmërisë së kapitalit në 17.0 përqind nga 18.1 përqind në vitin paraprak, por që vazhdon të mbetet lartë mbi nivelin minimal rregullativ prej 12 përqind. Gjithashtu, cilësia e portofolit kreditor të sektorit bankar vazhdoi të përmirësohet edhe gjatë vitit 2018, ku raporti i kredive joperformuese ndaj gjithsej kredive zbriti në 2.7 përqind. Për më tepër, niveli i mbulueshmërisë së kredive joperformuese me provizione në këtë periudhë arriti në 152.1 përqind si rezultat i përmirësimit të cilësisë së portofolios kreditor. Edhe pozita e likuiditetit të sektorit bankar mbetet e qëndrueshme, ku raporti i mjeteve likuide ndaj detyrimeve afatshkurtra qëndroi në 38.5 përqind, lartë mbi minimumin e kërkuar rregullator prej 25 përqind.

Spektori pensional në vitin 2018 u karakterizua me ngadalësim të rritjes së asetëve në 2.2 përqind, nga 16.0 përqind sa ishte në vitin paraprak, vlera e përgjithshme e të cilave arriti në 1.69 miliardë euro. Dinamikat në sektorin pensional në vitin 2018 u ndikuan negativisht nga rezultati negativ financiar nga investimet, përderisa kontribut pozitiv dhanë rritja e kontributeve të arkëtuara nga të dy fondet.

Niveli i ndërmjetësimit të sektorit të sigurimeve, më saktësisht primet e shkruara bruto në raport me BPV-në e vendit, rezulton të jetë në nivel të ulët prej 1.41 përqind. Asetet e sektorit të sigurimeve, që përfaqësojnë 2.8 përqind të gjithsej asetëve të sistemit financiar, shënuan vlerën



prej 175.7 milionë euro në vitin 2018. Rënia marginale e shënuar në asetet e sektorit të sigurimeve prej 0.6 përqind kryesisht iu atribuua tërheqjes nga tregu të një kompanie të sigurimit jetë gjatë vitit 2018. Gjatë vitit 2018, vlera e primeve të shkruara nga siguruesit arriti në 92.1 milionë euro, një rritje vjetore prej 6.2 përqind, përderisa dëmet e paguara nga siguruesit dhe Byroja Kosovare e Sigurimit (BKS) shënuan ngadalësim të rritjes vjetore në 5.0 përqind duke arritur në 48.3 milionë euro në vitin 2018. Sektori i sigurimeve mbylli vitin 2018 me rezultat pozitiv financiar edhe pse me fitim neto më të ulët për dallim nga viti i kaluar. Fitimi i regjistruar në vitin 2018 ishte 1.6 milionë euro, krahasuar me fitimin prej 6.4 milionë euro në vitin 2017.

Sektori mikrofinanciar në vitin 2018 shënoi rritje të aktivitetit kredidhënës. Vlera e gjithsej aseteve të IMF-ve dhe IFJB-ve arriti në 250.0 milionë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 30.0 përqind. Gjatë vitit 2018, aktiviteti kreditor i sektorit mikrofinanciar shënoi rritje vjetore prej 27.7 përqind, me vlerën e gjithsej kredive që arritën në 183.8 milionë euro. Si rezultat i rritjes së lartë të të hyrave (kryesisht të hyrave nga interesi), sektori mikrofinanciar realizoi profit në vlerë prej 9.7 milionë euro, që rezulton të jetë më i lartë krahasuar me vitin paraprak për 31.0 përqind.

Gjithashtu gjatë vitit 2018 BQK-ja, ka hartuar kornizën ligjore dhe rregullative të procesit të rimëkëmbjes dhe përmbylljes (recovery and resolution) së bankave, i cili është bërë në tri nivelet legislative me mbështetjen e asistencës teknike të BERZH-it. BQK-ja ka finalizuar edhe rregulloren, e cila për afron kornizën e vendit me Standardin Ndërkombëtar të Raportimit Financiar (SNRF) 9, rregullore që parashihet të hyjë në fuqi nga 1 janari i vitit 2020.

Gjatë vitit 2018, BQK-ja gjithashtu ka hartuar draftin e Ligjit të ri për IMF dhe IFJB. Ligji i ri është miratuar nga Qeveria gjatë vitit 2018 dhe më pas është proceduar në Kuvendin e Republikës së Kosovës për miratim, ku edhe ka kaluar leximin e parë. I njëjti pritjet të miratohet nga Kuvendi i Republikës së Kosovës gjatë vitit 2019.

Në funksion të një sistemi bankar stabil, gjatë vitit 2018 janë bërë ekzaminimet e bankave komerciale konform planit të paraparë dhe ekzaminime të fokusuara. Në përputhje me praktikat ndërkombëtare në fushën përkatëse, vëmendje e veçantë i është kushtuar rrezikut të likuiditetit, rrezikut kreditor, rrezikut të tregut dhe rrezikut operacional. Në përputhje me objektivat e BQK-së, respektivisht sigurimit të qëndrueshmërisë së tregut të sigurimeve dhe mbrojtjes së policëmbajtësve, BQK-ja edhe gjatë vitit 2018 ka vazhduar aktivitetin e saj duke realizuar në vazhdimësi ekzaminime në vend të siguruesve si ekzaminime të plota dhe të fokusuara, si dhe ekzaminime ad-hoc për siguruesit dhe ndërmjetësuesit e sigurimeve. Në funksion të ruajtjes së qëndrueshmërisë së sektorit financiar, gjatë vitit 2018 BQK-ja ka vazhduar me ekzaminimet e rregullta edhe të fondeve pensionale dhe institucioneve tjera financiare.

Sa i përket fushës së parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, pas aprovimit të ligjit dhe rregullores që kanë të bëjnë me këtë fushë, gjatë vitit 2018, BQK-ja ka hartuar plotësim ndryshimin e rregullores për parandalimin e pastrimit të parave dhe udhëzimin për formularin e prejardhjes së fondeve.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës luan rol kyç në mbrojtjen e shfrytëzuesve të shërbimeve financiar në Kosovë. Në këtë kontekst, në kuadër të procesit të brendshëm të trajtimit të ankesave, gjatë vitit 2018, BQK-ja ka shqyrtuar 927 ankesa të shfrytëzuesve të shërbimeve financiare (persona fizikë e juridikë), ku 532 ankesa kanë qenë të deponuara për banka, IMF, IFJB dhe fonde pensionale, përderisa 395 ankesa kanë qenë të deponuara për siguruesit.

Ngjashëm me vitet paraprake edhe gjatë vitit 2018, BQK-ja siguroi një ofertë kualitative dhe kuantitative të parave të gatshme për sektorin bankar për të mundësuar kryerjen e transaksioneve me para të gatshme në ekonomi. Gjithashtu edhe sistemi i pagesave është karakterizuar me një dinamikë të zhvillimeve gjatë vitit 2018, si nga aspektet rregullative e po ashtu edhe në funksionet operationale, përderisa progres është shënuar edhe në fushën e

mbikëqyrjes dhe analizave të sistemeve të pagesave. Edhe Regjistri i Kredive të Kosovës (RKK) ka shënuar progres gjatë vitit 2018, ku janë regjistruar 463 përdorues të ri, si rrjedhojë e kërkesave të paraqitura nga institucionet anëtare, përderisa hulumtimi mbi obligimet dhe historitë kreditore të aplikantëve kreditor arriti në 938,682 hulumtime.

Në vitin 2018 të gjitha mjetet nën menaxhimin e BQK-së, janë investuar në instrumente financiare që hyjnë në kategorinë e instrumenteve të sigurta dhe likuide. Vazhdimi i politikës së normës negative të interesit në depozita nga Banka Qendrore Evropiane që ka rezultuar me çmime të larta të instrumenteve të borxhit në Eurosistem dhe ka diktuar shpërndarjen e portofolit të investimeve. Karakteristika kryesore e vitit 2018 është plasmani i mjeteve në instrumente borxhi me normë fikse të interesit me afat më të gjatë kohor (në periudha deri në pesë vite), si rrjedhojë e pamundësisë për të investuar me kthime pozitive në periudha më të shkurtra.

Në funksion të realizimit të objektivave të saj, BQK-ja ka vazhduar t'i kushtojë vëmendje të veçantë analizave rreth zhvillimeve të përgjithshme ekonomike në vend, si dhe analizave që kanë të bëjnë me vlerësimin e stabilitetit financiar dhe me aktivitetin e sistemit financiar të vendit.

Në kuadër të përgjegjësisë së përpilimit dhe publikimit të statistikave të sektorit monetar e financiar dhe statistikave të sektorit të jashtëm gjatë vitit 2018, Kosova ka pranuar një asistencë teknike nga Eurostat, me ç'rast janë iniciuar dy projekte që kanë për qëllim përmirësimin e statistikave që janë nën përgjegjësinë e BQK-së: "Macroeconomic Imbalance Procedure (MIP)" dhe "International Trade in Services Statistics (ITSS)", me afat të përmbushjes së detyrave që ngarkojnë këto dy projekte deri në shtator 2019. Gjatë vitit 2018, gama me statistika të reja është zgjeruar, duke publikuar disa tabela të reja për asetet rezervë, eksportet dhe importet e mallrave sipas shteteve e llojeve të mallrave.

BQK-ja ka vazhduar të përfitojë nga asistencë teknike gjatë vitit 2018, e ofruar nga institucionet financiare ndërkombëtare dhe donatorët e ndryshëm si me projektet ekzistuese, po ashtu edhe me iniciativat të reja. Mbështetje është ofruar kryesisht nga Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN), Thesari Amerikan, Unioni Evropian, Banka Botërore, Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim dhe GIZ-i.

## 2. Mjedisi i jashtëm ekonomik

### 2.1. Eurozona dhe Ballkani Perëndimor

Ekonomia e Eurozonës sipas vlerësimeve preliminare të Eurostat-it ka shënuar rritje prej 1.8 përqind në vitin 2018, që përbën një rritje më të ngadalshme kundrejt vitit 2017 kur ishte shënuar rritje prej 2.4 përqind. Rritja më e ngadalshme e aktivitetit ekonomik në Eurozonë kryesisht i atribuohet dobësimit të tregtisë ndërkombëtare dhe ndikimit negativ të disa faktorëve të përkohshëm (kushtet e këqija atmosferike, zvogëlimi i prodhimit të makinave veçanërisht në TM3), si dhe ritmit shumë të fortë të rritjes në vitin 2017. Me rritje më të ngadalshme vjetore u karakterizuan pothuajse të gjitha ekonomitë kryesore të Eurozonës e veçanërisht Gjermania dhe Franca, ku ngadalësimi ishte më i theksuar (tabela 1). Projektionet e BQE-së sugjerojnë një rritje më të ngadalshme ekonomike edhe në tri vitet e ardhshme (1.5 përqind në vitin 2021), pritje që mbështeten kryesisht në rënien potenciale të besueshmërisë së bizneseve dhe të individëve në periudhat në vazhdim si pasojë e rritjes së pasigurive lidhur me marrëdhëniet e ardhshme tregtare, shtrëngimin e kushteve të financimit dhe ngadalësimin e rritjes ekonomike të Kinës.


**Tabela 1. Rritja reale vjetore e BPV-së**

Përshkrimi	2015	2016	2017	2018
Eurozona	2.1	2.0	2.4	1.8
Gjermania	1.5	2.2	2.5	1.5
Franca	1.1	1.2	2.2	1.5
Italia	0.9	1.1	1.6	0.9
Austria	1.1	2.0	2.6	2.7
Spanja	3.7	3.2	3.0	2.5
Greqia	-0.4	-0.2	1.5	2.1

Burimi: FMN, WEO (2019)

Inflacioni në Eurozonë ka shënuar rritje në vitin 2018, duke ju afruar objektivit të BQE-së prej afër por nën 2.0 përqind. Norma mesatare e shkallës së inflacionit në vitin 2018 arriti në 1.7 përqind, nga 1.5 përqind sa ishte në vitin 2017 (figura 1). Kontribut të rëndësishëm në rritjen e shkallës së inflacionit ka dhënë politika ekspansioniste monetare dhe masat jokonvencionale të ndërmarra nga BQE-ja në kuadër të programit të lehtësimit sasior. Në dhjetor të vitit 2018, Këshilli Mbikëqyrës i BQE-së ka vendosur që të përmbyllë programin për blerjen e aseteve, si dhe ka paralajmëruar se ka për qëllim që të vazhdojë riinvestimin në pagesat e plota të principalit nga asetet që maturaonë (që janë blerë në kuadër të programit), për një periudhë të zgjatur kohe, për aq sa do të vlerësohet si e nevojshme për të siguruar kushte të favorshme të likuiditetit në treg. Parashikimi për shkallën vjetore të inflacionit për vitin 2019 është rreth 1.6 përqind, ndërsa prospektet për një ngadalësim të rritjes ekonomike kanë ndikuar që parashikimet për periudhën afatmesme të mos jenë edhe aq optimiste sa i përket arritjes së nivelit të përcaktuar me objektivat monetare.

**Figura 1. Shkalla e inflacionit në eurozonë, në përqindje**



Burimi: Eurostat (2019)


Dobësimi i tregtisë ndërkombëtare ka ndikuar negativisht ekonomitë e Eurozonës. Vlera e eksportit të mallrave dhe shërbimeve shënoi një rritje të ngadalësuar prej 3.8 përqind në vitin 2018, nga rritja e shënuar në vitin 2017 prej mesatarisht 5.2 përqind. Në anën tjetër, importi i mallrave dhe shërbimeve vlerësohet të ketë shënuar përsheptim të rritjes në rreth 4.0 përqind, nga 3.7 përqind sa ishte në vitin 2017. Për pasojë, në vitin 2018 pozicioni i neto eksporteve kontribuoi negativisht në rritjen reale të BPV-së në Eurozonë.

Aktiviteti kreditues në Eurozonë vazhdoi rimëkëmbjen graduale, si rezultat i mbështetjes nga faktorët e ofertës dhe të kërkesës. Politika monetare akomoduese ka stimuluar zgjerimin e aktivitetit kreditues, ndërkohë që kërkesa për kredi është mbështetur nga normat e interesit të cilat janë në nivelet më të ulëta historike. Rritja vjetore e kreditimit ndaj ndërmarrjeve në Eurozonë shënoi rritje prej 2.8 përqind në vitin 2018, një rritje më e lartë krahasuar me rritjen prej 1.9 përqind në vitin paraprak, ndërsa kreditimi ndaj ekonomive familjare shënoi rritje vjetore prej 3.0 përqind që është nivel pothuajse i njëjtë me vitin paraprak. Edhe depozitat vazhduan trendin e rritjes së qëndrueshme, kryesisht si rezultat i masave stimuluese monetare të BQE-së dhe kostos së ulët oportune të investimit në një ambient me norma të ulëta të interesit. Depozitat e ekonomive familjare shënuan rritje vjetore prej 5.2 përqind në vitin 2018, që paraqet një përsheptim të rritjes krahasuar me vitin paraprak kur kishin shënuar rritje prej 4.2 përqind. Në anën tjetër, depozitat e ndërmarrjeve shënuan rritje prej 3.9 përqind, e cila është rritje më e ulët krahasuar me rritjen prej 8.6 përqind të shënuar në vitin 2017.

Në vendet e Ballkanit Perëndimor për dallim nga Eurozona, rritja e aktivitetit ekonomik në përgjithësi është përsheptuar gjatë vitit 2018, por me ritëm të ndryshëm ndërmjet vendeve (figura 2). Normat mesatare e rritjes ekonomike në vendet e rajonit vlerësohet të ketë arritur në 3.8 përqind gjatë vitit 2018, mbështetur kryesisht nga rritja e kërkesës së brendshme. Normat më të larta të rritjes ekonomike vlerësohet se janë shënuar në Mal të Zi, Serbi, Shqipëri dhe Kosovë, ndërsa në Bosnje e Hercegovinë dhe Maqedoni të Veriut janë shënuar norma më të ulëta të rritjes ekonomike. Për vitin 2019, parashikimet e FMN-së sugjerojnë se norma e rritjes ekonomike në vendet e Ballkanit Perëndimor do të jetë më e ngadalësuar krahasuar me vitin 2018 (3.4 përqind).


Stabilizimi i çmimeve në tregjet ndërkombëtare ka ndikuar në stabilizimin e presioneve inflacioniste në vendet e Ballkanit Perëndimor, të cilat u karakterizuan me një shkallë mesatare të inflacionit prej 1.9 përqind që është nivel i ngjashëm me mesataren e vitit 2017 (figura 3). Presione më të dobëta inflacioniste krahasuar me vitin paraprak ishin të pranishme në Kosovë (1.1 përqind) dhe Serbi (2.1 përqind), ndërsa në vendet tjera norma e inflacionit ishte më e lartë.

Figura 2. Rritja vjetore e BPV-së në Ballkanin Perëndimor



Burimi: FMN, WEO (2019)

Figura 3. Rritja vjetore e inflacionit në Ballkanin Perëndimor



Burimi: FMN, WEO (2019)

Deficiti i llogarisë rrjedhëse në vendet e Ballkanit Perëndimor është përkeqësuar në vitin 2018 duke arritur mesatarisht në 7.3 përqind të BPV-së nga 6.9 përqind sa ishte në vitin 2017. Rritja e deficitit të llogarisë rrjedhëse kryesisht iu atribuua dobësimit të tregtisë ndërkombëtare, por edhe rënies së kërkesës së jashtme, gjë që u përkatte në kontribut më të ulët eksporteve neto. Eksporti i mallrave dhe shërbimeve nga rritja vjetore prej mesatarisht 10.9 përqind në vitin 2017 u reduktua në një rritje prej 7.1 përqind në vitin 2018. Edhe importi i mallrave dhe shërbimeve vlerësohet të jetë karakterizuar me rritje prej 7.0 përqind në vitin 2018 (8.2 përqind në vitin 2017).

Kreditimi bankar vazhdoi të jetë kontribuues i rëndësishëm i rritjes së ekonomive të rajonit, ndonëse u shënuar një ngadalësim i rritjes në shumicën e vendeve. Norma mesatare e rritjes së kreditimit deri në nëntor 2018 ishte 6.0 përqind (6.7 përqind në periudhën e njëjtë të vitit 2017), ku Kosova dhe Mali i Zi shënuan normat më të larta të rritjes së kredive me norma prej 11.1 përqind përkatësisht 9.9 përqind. Cilësia e portofolit kreditor ka vazhduar përmirësimin, por ende mbetet e lartë në shumicën e vendeve, me përjashtim të Kosovës e cila karakterizohet me një cilësi shumë të mirë të kredive. Vendet e rajonit raportuan edhe për rritje të depozitave, por me shkallë mesatare lehtësisht më të ulët sesa në vitin paraprak si rezultat i ngadalësimit të shkallës së rritjes në Mal të Zi dhe Shqipëri. Bosnja e Hercegovina dhe Serbia përshpejtuan rritjen e depozitave, përderisa mesatarja vjetore e rritjes së depozitave për rajonin në tërësi ishte 8.9 përqind deri në nëntor 2018 (9.2 përqind në periudhën e njëjtë të vitit 2017). Edhe në Kosovë është shënuar përshpejtim i rritjes së depozitave në vitin 2018, ku norma e rritjes ka arritur në 8.7 përqind krahasuar me normën prej 6.8 përqind në vitin 2017.

Valuta euro ka shënuar vlerësim kundrejt dollarit amerikan, frangut zviceran dhe sterlinës britanike në vitin 2018. Norma mesatare e këmbimit të euros ndaj dollarit amerikan dhe frangut zviceran është vlerësuar për 4.6 përkatësisht 3.9 përqind, ndërsa ndaj sterlinës britanike është vlerësuar për 1.0 përqind. Bilanci pozitiv tregtar si dhe sinjalizimi i BQE-së për ngadalësimin e mundshëm të programit të blerjes së aseteve ndër të tjera, kanë ndikuar në forcimin e monedhës së euros kundrejt këtyre valutave kryesore. Ndërsa, kundrejt monedhave të rajonit si leku shqiptar, dinari serb dhe denari maqedonas, euro është zhvlerësuar me 4.9, përkatësisht 2.6 përqind dhe 0.2 përqind.


### 3. Ekonomia e Kosovës

#### 3.1. Sektori real

##### 3.1.1 Bruto prodhimi vendor

Sipas vlerësimeve tremujore të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), në vitin 2018, vlera nominale e BPV-së arriti në 6.5 miliardë euro, që në terma real paraqet një rritje prej rreth 3.9 përqind. Ngjashëm, vlerësimet e BQK-së për vitin 2018 sugjerojnë se ekonomia e Kosovës është karakterizuar me rritje reale prej rreth 4.0 përqind (figura 4), një rritje më e ngadalshme krahasuar me vitin paraprak, si pasojë e rritjes së kontributit negativ të komponentës së neto eksporteve.

Figura 4. Rritja reale e PBB-së



\* Parashikim i BQK-së  
Burimi: ASK (2019)

Sipas vlerësimeve të ASK-së, rritja e aktivitetit ekonomik gjatë vitit 2018 është gjeneruar kryesisht nga rritja e investimeve prej 14.7 përqind. Shpenzimet kapitale të Qeverisë shënuan rritje prej 13.4 përqind (5.4 përqind në vitin 2017). Kontribut të rëndësishëm në rritjen e investimeve vlerësohet të ketë pasur rritja e kreditimit bankar, i cili gjatë tërë vitit është karakterizuar me rritje dyshifrore. Vetëm kreditë e reja investuese kanë shënuar rritje vjetore prej 20.9 përqind në vitin 2018. Po ashtu, ndryshimet në politikën tatimore gjatë viteve të kaluara vlerësohen të kenë ndikuar në stimulimin e investimeve. Në kuadër të investimeve, me dinamika negative janë karakterizuar IHD-të, të cilat në vitin 2018 shënuan rënie prej 16.3 përqind. Konsumi, si komponenta kryesore e kërkesës së brendshme, ka shënuar rritje reale prej 3.7 përqind, mbështetur nga rritja në konsumin privat prej 3.8 përqind dhe konsumin publik prej 5.7 përqind. Rritja e konsumit privat gjatë vitit 2018, ngjashëm me vitet paraprake, ka vazhduar të mbështetet kryesisht nga rritja e remitencave dhe rritja e kreditimit bankar. Remitencat shënuan normë të rritjes prej 5.4 përqind (9.9 përqind në vitin 2017). Ndërsa, kreditë e reja konsumuese shënuan rritje prej 10.4 përqind (14.0 përqind në vitin 2017). Përveç konsumit privat edhe konsumi publik është karakterizuar me rritje të konsiderueshme, ku në kuadër të shpenzimeve buxhetore, shpenzimet rrjedhëse janë rritur për 9.2 përqind në vitin 2018 (5.0 përqind në vitin 2017).

Në anën tjetër, dinamikat që kanë karakterizuar sektorin e jashtëm të ekonomisë, veçanërisht bilancin tregtar të mallrave dhe shërbimeve, janë reflektuar negativisht në pozicionin e neto eksporteve dhe për pasojë, në rritjen reale të BPV-së. Për dallim nga viti 2017 kur komponenta e neto eksporteve kishte kontribuar pozitivisht në rritjen reale të BPV-së, në vitin 2018 kjo komponentë rezultoi të ketë pasur kontribut negativ në BPV. Rritja reale e eksportit të mallrave dhe shërbimeve për 1.4 përqind dhe importit të mallrave dhe shërbimeve për 8.1 përqind ka rezultuar në thellim të deficitit tregtar (mallra dhe shërbime) për 22.6 përqind në terma real. Ngjashëm me vitin paraprak, rritja e aktivitetit ekonomik në vitin 2018 vlerësohet të jetë mbështetur kryesisht nga sektori i tregtisë, pasuar nga sektori i ndërtimitarisë, si dhe sektori i aktiviteteve financiare dhe të sigurimit. Ndërsa, rënie reale vlerësohet të jetë shënuar tek sektori i industrisë nxjerrëse dhe sektori i furnizimit me energji elektrike, gaz, ujë, sektorë që njëherësh kanë pjesëmarrje më të ulët në gjithësej BPV-në.

### 3.1.2 Çmimet


Niveli i përgjithshëm i çmimeve në Kosovë, shprehur nëpërmjet indeksit të çmimeve të konsumit, është karakterizuar me rritje mesatare prej 1.1 përqind në vitin 2018 (figura 5). Sa i përket komponentëve të IÇK-së, me rritje u karakterizuan çmimet e transportit (4.0 përqind), çmimet e pijeve alkoolike dhe duhanit (2.4 përqind), si dhe çmimet e restoranteve dhe hoteleve (2.1 përqind). Me rritje prej 1.5 përqind u karakterizuan edhe çmimet e ushqimit dhe pijeve joalkoolike, që përfaqësojnë rreth 39.8 përqind të shportës së konsumatorit kosovar. Në anën tjetër, rënia më e lartë e çmimeve është shënuar te rryma, gazi dhe lëndët tjera djegëse (5.5 përqind), si dhe rekreacioni dhe kultura (1.5 përqind) (figura 6).

Lëvizja e çmimeve në Kosovë vazhdon të përcaktohet kryesisht nga lëvizja e çmimeve në tregjet ndërkombëtare, si pasojë e varësisë së lartë të ekonomisë së Kosovës nga importet. Indeksi i çmimeve të importit shënoi rritje mesatare prej 2.5 përqind (figura 7). Çmimet e produkteve minerale dhe metaleve bazë, të cilat janë kategoritë kryesore të indeksit të çmimeve të importit, shënuan rritjen më të lartë (15.1 përkatësisht 5.6 përqind), ndërsa çmimet e këpucëve dhe çmimet e letrës shënuan rënie më të lartë (11.5 përkatësisht 4.5 përqind). Indeksi i çmimeve të prodhimit u karakterizua me rritje prej 1.4 përqind. Me rritje të çmimeve u karakterizuan prodhimi i metaleve, prodhimi i pajisjeve elektrike, prodhimi i drurit, etj. Ndërsa, me rënie u karakterizuan kryesisht çmimet e nxjerrjes së xehes së metalit, prodhimi i produkteve kimike, prodhimi i pijeve, etj.

### 3.1.3 Pozicioni financiar i ndërmarrjeve


Indeksi i vëllimi të prodhimit industrial në vitin 2018, në mesatare është karakterizuar me rënie të lehtë (-0.7 përqind), i ndikuar kryesisht nga rënia e indeksit tek industria nxjerrëse, industria përpunuese dhe furnizimi me rrymë (figura 8).

Figura 5. Norma e inflacionit, ndryshimi vjetor në përqindje




Burimi: ASK (2019)

Figura 6. Lëvizja e çmimeve të komponentëve kryesorë, ndryshimi vjetor në përqindje



Burimi: ASK (2019)


Figura 7. Indekset e çmimeve të konsumit, prodhimit dhe importit



Burimi: ASK (2019)




Figura 8. Indeksi i vëllimit të prodhimit industrial (2017=100)



Burimi: ASK (2019)

Figura 9. Indeksi i qarkullimit në tregtinë me pakicë (2013=100)




Burimi: ASK (2019)

Indeksi i qarkullimit të sektorit të tregtisë me pakicë, që së bashku me sektorin e industrisë përbëjnë dy sektorët ekonomikë me pjesëmarrjen më të lartë në qarkullimin e gjithsej ndërmarrjeve<sup>1</sup>, në vitin 2018 shënoi rritje vjetore mesatare prej 16.8 përqind. Me rritje janë karakterizuar pothuajse të gjithë komponentët përbërës (figura 9).

Në vitin 2018 është shënuar numër më i madh i ndërmarrjeve të regjistruara dhe numër më i vogël i ndërmarrjeve të mbyllura. Numri i ndërmarrjeve të reja të regjistruara ishte 9,805 apo 6.3 përqind më shumë sesa në vitin paraprak, ndërsa u mbyllën 1,426 ndërmarrje apo 12.1 përqind më pak se sa në vitin paraprak (figura 10).


Numri më i madh i ndërmarrjeve të regjistruara vazhdon të jetë i koncentruar në sektorin e tregtisë me 25.8 përqind e gjithsej ndërmarrjeve të reja të regjistruara, pasuar nga sektori i prodhimit me 11.3 përqind, hotelierisë me 10.1 përqind dhe ndërtimitarisë me 9.8 përqind (figura 11). Krahasuar me vitin 2017, në shumicën e sektorëve është shënuar numër më i madh i ndërmarrjeve të regjistruara. Në sektorin e prodhimit janë regjistruar 219 ndërmarrje më shumë, në sektorin e ndërtimit 120 ndërmarrje më shumë, në sektorin e tregtisë 63 ndërmarrje më shumë, etj. Ndërsa, sektorët që shënuan numër më të vogël të ndërmarrjeve të regjistruara ishin sektori i bujqësisë (196 ndërmarrje më pak), transportit (38 ndërmarrje më pak), aktiviteteteve financiare (26 ndërmarrje më pak).

Figura 10. Regjistri i bizneseve



Burimi: ASK (2019)

Figura 11. Struktura e ndërmarrjeve të reja



Burimi: ASK (2019)

<sup>1</sup> Databaza ASK Data: Raporti 'Struktura e qarkullimit sipas seksioneve ekonomike për vitet 2008-2017'.



### 3.1.4 Tregu i punës<sup>2</sup>

Në vitin 2018, shkalla e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore në Kosovë ishte 40.9 përqind, që krahasuar me vitin 2017, tregon për një rënie të shkallës së pjesëmarrjes në fuqinë punëtore për 1.9 pikë përqindje. Shkalla e ulët e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore (mesatarja në rajon rreth 50 përqind) i atribuohet deri në një masë popullsisë relativisht të re (nxënës, studentë), si dhe kategorisë së punonjësve të dekurajuar, amviseve, dhe personave të tjerë të cilët nuk ishin aktivë në kërkim të një pune.

Bazuar në Anketën e Fuqisë Punëtore shkalla mesatare e punësimit<sup>3</sup> rezultoi të jetë 28.8 përqind, që paraqet një rënie prej 1.0 pikë përqindje krahasuar me vitin 2017. Shkalla e punësimit, rezultoi të jetë më e lartë tek meshkujt kundrejt femrave, ku 45.3 përqind e meshkujve në moshë pune ishin të punësuar kundrejt 12.3 përqind të femrave. Sipas rezultateve të anketës, shkalla e punësimit të gjinia femërore ka shënuar një rënie të lehtë (0.4 pikë përqindje) krahasuar me vitin 2017, ndërsa të gjinia mashkullore është shënuar rënie e shkallës së punësimit për 1.3 pikë përqindje krahasuar me vitin 2017.

Sipas grup-moshave, popullsia e moshës mes 35-44 vjeç ka normën më të lartë të punësimit (39.1 përqind), përderisa grup-mosha 15-24 vjeç ka normën më të ulët të punësimit (10.0 përqind). Sipas nivelit arsimor, shkalla më e lartë e punësimit rezultoi të jetë në mesin e fuqisë punëtore me edukim të lartë, pasuar nga arsimit mesëm profesional dhe gjimnazi. Punëtorët që kishin të përfunduar arsimin e mesëm profesional ishin kryesisht të punësuar në sektorin privat (kompani private, individuale private), përderisa punëtorët që kishin të përfunduar arsimin terciar ishin të punësuar kryesisht në sektorin publik.

Diktuar edhe nga struktura e ekonomisë së vendit, shkalla e punësimit rezultoi të jetë e koncentruar në sektorin e tregtisë me 17.0 përqind të gjithë të punësuarve, pasuar nga sektori i ndërtimit me 11.9 përqind, sektori i arsimit me 11.3 përqind, sektori i prodhimit me 10.3 përqind, etj. Krahasuar me vitin 2017, të dhënat tregojnë se punësimi në sektorin e tregtisë dhe të arsimit ka shënuar rritje, përderisa sektorët si ndërtimtaria dhe prodhimi kanë shënuar rënie.

Statistikat e tregut të punës në Kosovë tregojnë se shkalla mesatare e papunësisë<sup>4</sup> në vitin 2018 ishte 29.6 përqind, dhe krahasuar me vitin 2017, rezultoi më e ulët për 0.9 pikë përqindje. Në baza gjinore, tregu i punës në Kosovë vazhdon të karakterizohet me një shkallë më të lartë të papunësisë tek femrat. Shkalla e papunësisë të femrat ishte 33.4 përqind (28.5 përqind tek meshkujt), ku grup-mosha e femrave të reja (15-24 vjeç) kanë shkallën më të lartë të papunësisë (rreth 64.7 përqind). Edukimi ka përmirësuar perspektivat në tregun e punës në Kosovë. Sipas ASK-së, shkalla e papunësisë ishte më e larta për personat e pashkolluar (rreth 57.8 përqind), ndërsa më e ulët për personat që kishin të përfunduar arsimin terciar (19.2 përqind).

### 3.2. Sektori fiskal

Të hyrat buxhetore<sup>5</sup> në vitin 2018 arritën vlerën neto prej 1.76 miliardë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 4.5 përqind. Shpenzimet buxhetore<sup>6</sup> arritën vlerën prej 1.92 miliardë euro që paraqet një rritje vjetore prej 10.3 përqind. Rrjedhimisht, buxheti i Kosovës regjistroi deficit primar

<sup>2</sup> Seksioni "Tregu i punës" bazohet në të dhënat e Anketës së Fuqisë Punëtore, publikuar nga Agjencia e Statistikave të Kosovës.

<sup>3</sup> Shkalla e punësimit paraqet përqindjen e popullsisë në moshë pune që është e punësuar.

<sup>4</sup> Shkalla e papunësisë është përqindja e fuqisë punëtore, që nuk është e punësuar.

<sup>5</sup> Në kuadër të të hyrave buxhetore nuk përfshihen të hyrat nga huamarrjet, të hyrat nga privatizimi, pranimet nga grantet e përcaktuara të donatorëve dhe pranimet nga depozitat në mirëbesim.

<sup>6</sup> Në kuadër të shpenzimeve buxhetore nuk përfshihen pagesat e borxhit, pagesat për anëtarësim në Institucionet Financiare Ndërkombëtare dhe kthimet nga fondet e depozitave.

buxhetor prej 162.7 milionë euro krahasuar me deficitin prej 59.0 milionë euro në vitin 2017, përderisa si përqindje e BPV-së, deficitin primar ishte 2.4 përqind.

Në kuadër të të hyrave, vërehet rritje më e lartë e të hyrave tatimore direkte të cilat arritën vlerën prej 267.5 milionë euro (12.4 përqind rritje), ndërsa të hyrat tatimore indirekte shënuan rritje prej 2.2 përqind dhe arritën vlerën prej 1.3 miliardë euro. Të hyrat j-tatimore shënuan rritje prej 3.8 përqind dhe arritën vlerën prej 192.9 milionë euro.

Pothuajse të gjitha kategoritë e shpenzimeve buxhetore u karakterizuan me rritje. Shpenzimet qeveritare për paga dhe mëditje shënuan rritje prej 7.6 përqind dhe arritën vlerën prej 591.9 milionë euro. Shpenzimet qeveritare për mallra dhe shërbime (përfshihen edhe shpenzimet komunale) shënuan rritje për 10.7 përqind dhe arritën vlerën prej 250.2 milionë euro. Subvencionet dhe transferet shënuan rritje për 10.2 përqind dhe arritën vlerën prej 558.0 milionë euro. Investimet kapitale, të cilat përfaqësojnë rreth 27.6 përqind të gjithë shpenzimeve buxhetore, shënuan rritje prej 13.4 përqind dhe arritën vlerën 530.0 milionë euro.

Borxhi publik në fund të vitit 2018 ka arritur në 1.1 miliardë euro, që është për 9.7 përqind më i lartë krahasuar me vitin 2017. Si përqindje e BPV-së, borxhi publik ka arritur në 17.1 përqind nga 16.6 përqind sa ishte në vitin 2017. Kjo rritje e borxhit publik i atribuohet rritjes së borxhit të brendshëm prej 17.8 përqind (i cili ka arritur në 676.6 milionë euro), ndërsa borxhi i jashtëm publik ka shënuar rënie prej 1.4 përqind duke arritur në 416.4 milionë euro. Pjesëmarrja e borxhit të jashtëm publik në gjithë borxhin publik është zvogëluar në 38.1 përqind nga 42.4 përqind sa ishte në vitin 2017.

Në vitin 2018, mbështetur në kalendarin e publikuar nga Ministria e Financave, numri i ankandeve për emetimin e Letrave me Vlerë të Qeverisë së Kosovës arriti në 20, përderisa vlera e shpallur në ankandë arriti vlerën prej 425.0 milionë euro.

Gjatë vitit 2018, Qeveria e Kosovës ka shpallur numër dhe vlerë më të vogël të bonove të thesarit krahasuar me vitin paraprak, kundrejt rritjes së numrit dhe vlerës të obligacioneve. Vlen të theksohet se me konsolidimin e tregut të letrave me vlerë, për herë të parë që prej fillimit të emetimit në vitin 2012, në vitin 2018 është realizuar për herë të parë me sukses emetimi i obligacioneve dhjetë vjeçare. Vlera e letrave me vlerë të emetuara në vitin 2018 arriti në 399.8 milionë euro, për 1.3 përqind më e ulët se në vitin paraprak. Sipas afatit të maturimit, struktura e Letrave me Vlerë të Qeverisë së Kosovës vazhdon të tregon tendencë të zhvendosjes nga letrat me vlerë me maturitet afatshkurtër në letra me vlerë me maturitet afatgjatë. Në vitin 2018, struktura e letrave me vlerë regjistroi ndryshime: përderisa në të kaluarën struktura dominohej nga bonot e thesarit me afat maturimi 364 ditë, në vitin 2018 kategoria kryesore rezultoi të ishte ajo e obligacioneve me afat maturimi prej pesë vitesh.

Në vitin 2018, kërkesa për të investuar në bono dhe obligacione qeveritare ishte më e ulët se në vitin paraprak. Madje, në disa ankandë të realizuara kërkesa rezultoi të jetë më e ulët se shuma e shpallur nga Ministria e Financave. Kjo u reflektua në raportin e përgjithshëm të kërkesës ndaj ofertës në letrat me vlerë, e cila në vitin 2018 ishte për 1.4 herë më e lartë, krahasuar me 1.6 sa ishte në vitin e kaluar. Në vitin 2018, norma mesatare e interesit në Letrat me Vlerë të Qeverisë së Kosovës ishte 1.8 përqind, një rritje kundrejt normës prej 0.8 përqind në vitin 2017. Rritja e normës mesatare të interesit mund t'i atribuohet deri në një masë rritjes së frekuencës së numrit të obligacioneve të emetuara, sidomos atyre 5 vite e më shumë, kundrejt rënies për bonot e emetuara.

### 3.3. Sektori i jashtëm


Deficiti i llogarisë rrjedhëse dhe kapitale në vitin 2018 ka shënuar vlerën prej 551.7 milionë euro, që është për 39.7 përqind më i lartë krahasuar me vitin 2017. Në raport me BPV-në, deficiti i llogarisë rrjedhëse dhe kapitale ka arritur në 8.2 përqind, nga 6.2 përqind sa ishte në vitin 2017. Rritja e deficitit të llogarisë rrjedhëse dhe kapitale i atribuohet rritjes së deficitit të mallrave si dhe zvogëlimit të bilancit pozitiv të shërbimeve. Në anën tjetër, bilancet pozitive të llogarisë së të ardhurave parësore dhe dytësore kanë shënuar rritje.

Rënia e eksportit të mallrave si dhe rritja e konsiderueshme e importit ka ndikuar që deficiti në tregtinë e mallrave të shënoi rritje prej 11.3 përqind dhe të arrijë në rreth 3.0 miliardë euro. Në raport me BPV-në, deficiti i tregtar i mallrave ka arritur në 44.6 përqind nga 41.6 përqind sa ishte në vitin 2017. Vlera e eksportit të mallrave zbriti në 367.3 milionë euro, që përkon me një rënie vjetore prej 2.8 përqind (rritje prej 22.1 përqind në vitin 2017) (figura 12).<sup>7</sup> Performanca jo e mirë e eksportit të mallrave mund të jetë

ndikuar ndër të tjera nga ngadalësimi i rritjes së kërkesës së jashtme. Rënia e eksportit të mallrave dhe rritja e importit rezultoi në zvogëlimin e shkallës së mbulueshmërisë së importeve me eksporte nga 12.4 përqind sa ishte vitin 2017 në 11.0 përqind në vitin 2018. Shumica e kategorive të eksportit shënuan rënie, ndërsa rënia më e lartë u shënuar te produktet minerale, pasuar nga makineritë dhe pajisjet mekanike si dhe lëkura dhe artikujt e lëkurës (figura 13). Me rënie të lehtë u karakterizua edhe eksporti i metaleve bazë, të cilat kanë pjesëmarrjen më të lartë në strukturën e gjithsej eksporteve të vendit (rreth 34.0 përqind). Në anën tjetër, me rritje u karakterizua eksporti i produkteve të plastikës dhe gomës, ushqimeve të përgatitura, perimeve, tekstilit, etj.


Rritja e kërkesës së brendshme gjatë vitit 2018 ka ndikuar në rritjen e importit, vlera e përgjithshme e të cilit arriti në 3.3 miliardë euro dhe shënoi rritje vjetore prej 9.6 përqind. Në kuadër të importit të mallrave, rritja më e lartë është shënuar tek importi i metaleve bazë, pasuar nga importi i makinerive dhe pajisjeve mekanike, importi i tekstilit dhe artikujve të tekstilit, importi i produkteve minerale, etj. (figura 14).

Figura 12. Eksportet, importet dhe bilanci tregtar, në milionë euro



Burimi: ASK (2019)

Figura 13. Struktura e eksporteve sipas kategorive, në përqindje



Burimi: ASK (2019)


<sup>7</sup> Burimi i të dhënave për eksportin dhe importin e mallrave në Kosovë është Agjencia e Statistikave të Kosovës.

Bilanci në tregtinë e shërbimeve shënoi vlerën prej 770.6 milionë euro, një rënie kundrejt vitit paraprak prej 2.9 përqind. Vlera e eksportit të shërbimeve shënoi rritje vjetore prej 5.4 përqind, duke arritur në 1,401.9 milionë euro. Eksporti i shërbimeve të udhëtimit, të cilat përbëjnë rreth 78.0 përqind të gjithsej eksportit, shënoi vlerën prej mbi 1 miliardë euro që është nivel pothuajse i njëjtë me vitin e kaluar, ndërsa eksporti i shërbimeve kompjuterike u karakterizuan me rritje vjetore prej 19.9 përqind. Në anën tjetër, importi i shërbimeve shënoj rritje prej 17.7 përqind dhe arriti në 631.3 milionë euro. Tek importi i shërbimeve, rritjen më të lartë e shënuan shërbimet financiare (82.8 përqind rritje).

Llogaria e të ardhurave parësore u karakterizua me rritje prej 26.2 përqind. Të ardhurat nga kompensimi i punëtorëve<sup>8</sup> shënuan rritje për 11.2 përqind. Bilanci i të ardhurave dytësore shënoj rritje për 8.5 përqind, që i atribuohet kryesisht nivelit më të lartë të remitencave. Remitencat e pranuar në Kosovë, që njëherësh paraqesin edhe kategorinë më të madhe në kuadër të llogarisë së të ardhurave dytësore, shënuan vlerën prej 800.5 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 5.4 përqind (figura 15). Remitencat në Kosovë vijnë kryesisht nga Gjermania dhe Zvicra, vende këto nga të cilat dërgohen 40.4 përqind përkatësisht 21.7 përqind të gjithsej remitencave të pranuar në Kosovë. Një pjesë e konsiderueshme e remitencave është pranuar edhe nga SHBA-të, gjegjësisht 6.7 përqind e gjithsej remitencave.


Investimet e Huaja Direkte (IHD) në Kosovë arritën vlerën prej 213.7 milionë euro, që paraqet rënie prej 16.3 përqind krahasuar me vitin 2017. Në kuadër të strukturës së IHD-ve, kapitali dhe fondi i investimeve në aksione por edhe investimet në instrumentet e borxhit shënuan rënie (figura 16). Kapitali dhe fondi i investimeve në aksione shënoi vlerën prej 217.4 milionë euro, që është për 6.6 përqind më pak krahasuar me vitin paraprak. IHD-të në formë të instrumenteve të borxhit

Figura 14. Struktura e importeve sipas kategorive, në përqindje




Burimi: ASK (2019)

Figura 15. Remitencat, në milionë euro



Burimi: BQK (2019)

Figura 16. Struktura e investimeve të huaja direkte sipas komponenteve, në milionë euro



Burimi: BQK (2019)

<sup>8</sup> Kompensimi i punonjësve përfshinë pagat, mëditjet dhe beneficionet e tjera të pranuar nga punëtorët rezidentë jashtë vendit. Në këtë kontekst, përfshin punëtorët sezonalë apo punëtorët tjerë afatshkurtër (më pak se një vit) dhe punëtorët kufitarë të cilët qendrën e interesit ekonomik e kanë në ekonominë e tyre.

shënuan vlerën prej -3.6 milionë euro (22.7 milionë euro në vitin 2017). Rritje e IHD-ve u evidentua kryesisht tek patundshmëritë, sektori i minierave, energjetika dhe tregtia, ndërsa shërbimet financiare dhe sektori i ndërtimitarisë shënuan rënie.

### 3.4. Sektori financiar

#### 3.4.1 Karakteristikat e përgjithshme

Vlera e gjithsej asetëve të sistemit financiar të Kosovës arriti në 6.32 miliardë euro në vitin 2018, që përkon me një rritje vjetore prej 6.9 përqind (figura 17). Sektori bankar vazhdon të ketë kontributin kryesor në zgjerimin e aktivitetit të sistemit financiar në vend, pasuar nga sektori mikrofinanciar.

Sa i përket strukturës së sistemit financiar, numri i bankave komerciale dhe fondeve të pensioneve mbeti i pandryshuar nga viti i kaluar, përderisa numri i institucioneve mikrofinanciare shënoi rritje. Gjithashtu në vitin 2018, numri i kompanive të sigurimit u zvogëlua në 14 për shkak të likuidimit vullnetar të një kompanie të sigurimit, duke shitur portofolin e saj të një kompani tjetër. Ndhmësit financiarë vazhdojnë të kenë numrin më të madh të institucioneve financiare, pavarësisht pjesëmarrjes prej 0.3 përqind në gjithsej asetet e sistemit financiar (tabela 2).

**Tabela 2. Numri i institucioneve financiare**

Përshkrimi	2015	2016	2017	2018
Bankat komerciale	10	10	10	10
Siguruesit	15	15	15	14
Fondet pensionale	2	2	2	2
Ndërmjetësuesit financiarë	44	48	52	51
Institucionet mikrofinanciare dhe financiare jo-bankare	18	16	18	22

Burimi: BQK (2019)


#### 3.4.2 Sektori Bankar

##### Asetet

Asetet e sektorit bankar në vitin 2018 shënuan rritje vjetore prej 8.2 përqind, duke arritur vlerën prej 4.19 miliardë euro (figura 18). Rritja e asetëve të sektorit bankar gjatë vitit 2018 i atribuohet kryesisht dinamikave pozitive me të cilat u karakterizua aktiviteti kreditor, aktivitet që u mbështetet kryesisht nga depozitat të cilat përbëjnë rreth 80.0 përqind të detyrimeve dhe shënuan rritje vjetore prej 8.7 përqind.


Oferta kreditore u ndikua, përveç tjerash edhe nga presionet e konkurrencës, pozita e favorshme e likuiditetit dhe përmirësimi i

**Figura 17. Vlera e asetëve të sistemit financiar të Kosovës**



Burimi: BQK (2019)

**Figura 18. Asetet e bankave komerciale, ndryshimet vjetore, në milionë euro**



Burimi: BQK (2019)

vazhdueshëm i cilësisë së portofolit kreditor. Stoku i letrave me vlerë për të dytin vit me radhë u karakterizua me rënie vjetore (11.5 përqind në vitin 2018). Strategjia e bankave për t'u fokusuar në kreditim kundrejt investimit në letra me vlerë në dy vitet e fundit, përveç kthimit më të lartë në investim, mund t'i atribuohet deri në një masë rënies së rrezikut kreditor, kur kemi parasysh rritjen e aktivitetit të FKGK-së dhe rënien e vazhdueshme të pjesëmarrjes së kredive joperformuese në gjithsej kreditë. Kategoritë e tjera në kuadër të aseteve si paraja e gatshme dhe bilanci me BQK-në si dhe mjetet e mbajtura në bankat komerciale shënuan rritje prej 8.5 përkatësisht 14.9 përqind.

**Tabela 3. Struktura e aseteve të sektorit bankar**


Përshkrimi	2015		2016		2017		2018	
	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)
Paraja e gatshme dhe bilanci me BQK-në	491.0	14.5%	457.3	12.6%	499.4	12.9%	541.8	12.9%
Bilanci me bankat komerciale	316.0	9.3%	342.0	9.4%	296.6	7.7%	340.8	8.1%
Letrat me vlerë	473.3	14.0%	510.3	14.0%	486.4	12.6%	430.2	10.3%
Kreditë bruto	2,019.5	59.7%	2,230.0	61.3%	2,485.5	64.2%	2,755.5	65.8%
Asetet Fikse	57.0	1.7%	58.5	1.6%	60.1	1.6%	79.6	1.9%
Asetet Tjera	28.5	0.8%	39.0	1.1%	41.8	1.1%	37.5	0.9%
<b>Gjithsej</b>	<b>3,385.3</b>	<b>100%</b>	<b>3,637.1</b>	<b>100%</b>	<b>3,869.8</b>	<b>100%</b>	<b>4,185.5</b>	<b>100%</b>

Burimi: BQK (2019)

## Kreditë


Kreditë e sektorit bankar për të tretin vit me radhë u karakterizuan me rritje vjetore dyshifrore. Në vitin 2018, portofoli kreditor u zgjerua për 10.9 përqind (figura 19) përderisa vlera e gjithsej kredive arriti në 2.76 miliardë euro. Faktorët që ndikuan në rritjen e kreditimit në vitin 2018 ishin rritja e kërkesës për kredi si nga ndërmarrjet (më e theksuar nga NVM-të) ashtu edhe nga ekonomitë familjare (për kredi konsumuese dhe hipotekare).

Figura 19. Norma vjetore e rritjes së kredive



Burimi: BQK (2019)

Figura 20. Kreditë e ndërmarrjeve dhe ekonomive familjare




Burimi: BQK (2019)

Po ashtu, përmirësimi i ofertës kreditore nga bankat, kryesisht përmes uljes së normës mesatare të interesit në kredi dhe zgjatjes së maturitetit të kredive, ka rezultuar në rritje të stokut të gjithsej kredive. Faktorë tjerë me ndikim në dinamikën e kreditimit ishin përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë së portofolit kreditor, likuiditeti i mjaftueshëm dhe konkurrenca bankare që luajtën rol kyç në zgjerimin e aktivitetit kreditor të bankave në këto tri vitet e fundit.

Kreditë ndaj ndërmarrjeve në vitin 2018 shënuan rritje vjetore prej 10.8 përqind, një rritje dyshifrore për të dytin vit me radhë (figura 20). Në vitin 2018, rritje të kreditimit shënuan pothuajse të gjithë sektorët e ekonomisë, me përjashtim të minierave që shënoi rënie vjetore prej 54.4 përqind. Sektorët që shënuan rritje më të theksuar të kreditimit gjatë vitit 2018 ishin sektori i ndërtimit, prodhimit dhe tregtisë (20.7 përqind, 16.3 përqind, përkatësisht 7.6 përqind) (figura 22).




Figura 21. Kreditë sipas sektorëve të ekonomisë, në përqindje (2018)



Burimi: BQK (2019)

Figura 22. Rritja vjetore e kredive sipas sektorëve të ekonomisë



Burimi: BQK (2019)

Përderisa, kreditë e reja ndaj ndërmarrjeve në vitin 2018 shënuan rritje vjetore prej 4.9 përqind, duke përjashtuar kreditë e reja ndaj sektorëve tjerë<sup>9</sup> që shënuan rënie, të gjitha kategoritë tjera të kredive të reja u karakterizuan me rritje. Struktura e kredive të ndërmarrjeve sipas veprimtarive ekonomike vazhdon të mbetet e dominuar nga kreditë e destinuar për sektorin e tregtisë, pasuar nga ato për prodhimtari dhe ndërtimtari (figura 21).

Ndër faktorët që mbështetën kreditimin për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme në vitin 2018 ishte edhe Fondi Kosovar për Garanci Kreditore, shfrytëzimi i të cilit ka shënuar trend të vazhdueshëm të rritjes. Numri kumulativ i kredive të bankave për NVM-të, të garantuara nga FKGK, arriti në 2,262 në fund të vitit 2018 (785 në fund të vitit 2017). Shuma totale e kredive të garantuara në vitin 2018 shënoi 87.2 milionë euro, një rritje kundrejt vlerës së garantuar prej 30 milionë euro në vitin paraprak. Struktura e kredive të garantuara është përfaqësimit i strukturës së përgjithshme të kredive të sektorit bankar, me ç'rast dominojnë kreditë për sektorin e tregtisë me shumicë dhe pakicë, të pasuara nga sektori i shërbimeve dhe ai i prodhimit. Sektori i bujqësisë, pylltarisë dhe peshkatarisë kishte përfaqësimit prej 7.0 përqind në gjithsej portofolin e kredive të garantuara. Prospektet pozitive të rritjes së vlerës së FKGK-së dhe fokusimit në mbështetjen e sektorëve specifikë me qasje më të vështirësuar në financa siç është sektori i bujqësisë, pritet të reflektohen në rritjen e mëtejme të kreditimit për NVM-të në përgjithësi dhe sektorë të caktuar në veçanti. Kreditë për ekonomitë familjare, të cilat në vitet e fundit kanë rritur peshën në strukturën e gjithsej stokut të kredive (rreth 36.0 përqind në vitin 2018), për të pestin vit me radhë shënuan rritje të konsiderueshme. Në vitin 2018, kreditë ndaj ekonomive familjare shënuan rritje vjetore prej 11.2 përqind, që paraqet ngadalësim të rritjes krahasuar me vitin e kaluar (rritje vjetore prej 12.7 përqind) (figura 22). Ritmi i ngadalësuar i rritjes së kredive për këtë kategori mund t'i atribuohet rritjes më të ngadalshme të kredive të reja gjatë kësaj periudhe, të cilat shënuan rritje prej 7.1 përqind në vitin 2018 kundrejt rritjes vjetore prej 15.0 përqind në vitin 2017. Të dy kategoritë më të rëndësishme të kredive të reja ndaj ekonomive familjare, konsumuese dhe ato hipotekare, shënuan ngadalësim të rritjes në vitin 2018.

### Detyrimet dhe burimet vetanake

Struktura e detyrimeve të sektorit bankar dominohet nga depozitat, të cilat në dhjetor 2018 përbënin 80.3 përqind të gjithsej detyrimeve dhe mjeteve vetanake.

Mjetet vetanake të sektorit bankar u karakterizuan me rritje vjetore prej 5.7 përqind, kryesisht si rezultat i profitabilitetit të lartë të sektorit.

<sup>9</sup> Përjashtuar kredinë e re ndaj sektorit të bujqësisë, industrisë dhe shërbimeve.

Tabela 4. Struktura e detyrimeve të sektorit bankar

Përshkrimi	2015		2016		2017		2018	
	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)
Bilanci nga bankat tjera	43.4	1.3%	59.1	1.6%	67.2	1.7%	108.3	2.6%
Depozitat	2,702.9	79.8%	2,897.8	79.7%	3,094.5	80.0%	3,362.9	80.3%
Huatë tjera	17.6	0.5%	17.8	0.5%	16.0	0.4%	14.1	0.3%
Detyrimet tjera	191.8	5.7%	203.4	5.6%	184.0	4.8%	169.1	4.0%
Borxhi i ndërvuarur	36.9	1.1%	38.4	1.1%	37.4	1.0%	33.5	0.8%
Mjetet vetanake	392.7	11.6%	420.6	11.6%	470.8	12.2%	497.7	11.9%
<b>Gjithsej detyrimet dhe burimeve vetanake</b>	<b>3,385.3</b>	<b>100%</b>	<b>3,637.1</b>	<b>100%</b>	<b>3,869.8</b>	<b>100%</b>	<b>4,185.5</b>	<b>100%</b>

Burimi: BQK (2019)

## Depozitat


Depozitat në sektorin bankar të Kosovës shënuan rritje vjetore të përsheptuar prej 8.7 përqind në vitin 2018, krahasuar me rritjen prej 6.8 përqind në vitin 2017. Ritmi i rritjes së gjithsej depozitave diktohet kryesisht nga depozitat e ekonomive familjare, kategori që dominon strukturën e gjithsej depozitave në sektorin bankar, të cilat në vitin 2018 përsheptuan rritjen në 7.7 përqind nga 2.1 përqind një vit më parë (figura 23).

Në të njëjtën periudhë, depozitat e ndërmarrjeve<sup>10</sup> gjithashtu shënuan rritje vjetore, por më të ngadalësuar prej 6.1 përqind nga 9.8 përqind një vit më parë. Rritja e përsheptuar e depozitave, në veçanti atyre të ekonomive familjare, ndër të tjera, mund t'i atribuohet rritjes së normës mesatare të interesit në depozita në vitin 2018. Vlen të theksohet se rritja në normën mesatare të interesit në depozita ka ndikuar në strukturën e depozitave, me ç'rast depozitat e transferueshme kanë ndaluar rritjen e shënuar ndër vite krahas zvogëlimit të pjesëmarrjes së depozitave të afatizuara dhe të kursimit që rezultoi nga ambienti i normave të ulëta të interesit. Në dhjetor 2018, depozitat e transferueshme zvogëluan pjesëmarrjen për 0.4 pikë përqindje në 60.0 përqind, ndërsa depozitat e afatizuara rritën pjesëmarrjen në 26.1 përqind nga 24.2 përqind një vit më parë.

## Normat e Interesit


Dallimi në mes të normës mesatare të interesit në kredi dhe asaj në depozita u ngushtua në 4.5 përqind në krahasim me 5.5 përqind sa ishte në periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Norma mesatare e interesit në kredi në dhjetor 2018 zbriti në 6.0 përqind, përderisa norma mesatare e interesit në depozita arriti në 1.5 përqind (figura 24).

Figura 23. Struktura e depozitave, në përqindje



Burimi: BQK (2019)

Figura 24. Norma mesatare e interesit në kredi dhe depozita



Burimi: BQK (2019)


<sup>10</sup> Ndërmarrjet private dhe publike jo financiare



## Normat e interesit në kredi


Norma mesatare e interesit në kreditë ndaj ndërmarrjeve u zvogëlua në 6.0 përqind nga 6.5 përqind sa ishte në dhjetor 2017 (figura 25).

Figura 25. Norma mesatare e interesit në kreditë ndaj ekonomive familjare dhe ndërmarrjeve



Burimi: BQK (2019)


Figura 26. Norma mesatare e interesit në kredi, sipas sektorëve të ekonomisë



Burimi: BQK (2019)


Në kuadër të kësaj kategorie, norma e interesit në kreditë investuese shënoi rënie, ndërsa norma e interesit në kreditë joinvestuese shfaqti tendencë rritëse në fund të vitit.

Figura 27. Norma mesatare e interesit në depozita



Burimi: BQK (2019)

Figura 28. Norma mesatare e interesit në depozitat për ndërmarrje, sipas kategorive




Burimi: BQK (2019)

Sipas sektorëve të veçantë të ekonomisë, kreditë për sektorin e bujqësisë u karakterizuan me rritje të normës së interesit, pas shumë viteve me rënie. Ndërsa, sektorët tjerë vazhduan të karakterizohen me rënie të normave të interesit por me ritëm më të ngadalësuar krahasuar me periudhat paraprake, duke përjashtuar sektorin e "shërbimeve tjera" për të cilin norma e interesit zbriti dukshëm në fundvit (figura 26). Kreditë për ekonomitë familjare gjithashtu shënuan rënie të normës mesatare të interesit në 6.3 përqind, nga 7.3 përqind sa ishte në dhjetor 2017.

## Normat e interesit në depozita

Norma mesatare e interesit në gjithsej depozitat vazhdoi rritjen e lehtë. Në dhjetor 2018, interesi në depozita arriti në 1.5 përqind, për 0.13 pikë përqindje më lartë sesa në periudhën e njëjtë të vitit paraprak (figura 27). Norma mesatare e interesit në depozitat e ndërmarrjeve zbriti për 0.2 pikë përqindje në 1.5 përqind,

Figura 29. Norma mesatare e interesit në depozitat për ekonomitë familjare, sipas kategorive



Burimi: BQK (2019)


ndërsa norma mesatare e interesit në depozitat e ekonomive familjare shënoi rritje prej 0.4 pikë përqindje në 1.4 përqind në dhjetor 2018 (figura 27 dhe 28).

### Performanca e sektorit bankar

Sektori bankar gjatë vitit 2018 vazhdoi të karakterizohet me performancë të mirë financiare, duke mbajtur nivel të lartë të profitabilitetit. Vlera neto e profitit ishte 88.0 milionë euro, që përkon me një rritje vjetore prej 3.0 përqind (figura 30). Rritja e profitit të sektorit bankar gjatë kësaj periudhe kryesisht i atribuohet rritjes së të hyrave nga interesi, të cilat u karakterizuan me rritje për herë të parë që nga viti 2013.


Të hyrat e sektorit bankar arritën vlerën prej 252.5 milionë euro dhe u karakterizuan me rritje vjetore prej 4.7 përqind (figura 31). Kategoritë kryesore të të hyrave shënuan rritje, por që kontributin më të madh e kishte rritja e të hyrave nga interesi në kredi, që u ndikua kryesisht nga volumi i rritur i kredive.

Figura 30. Profiti neto i sektorit bankar, në milionë euro



Burimi: BQK (2019)

Figura 31. Të hyrat dhe shpenzimet e sektorit bankar




Burimi: BQK (2019)

Shpenzimet e sektorit bankar shënuan vlerën prej 164.5 milionë euro dhe u karakterizuan me rritje vjetore prej 5.6 përqind (figura 31). Shpenzimet u karakterizuan me rritje në pothuajse të gjitha kategoritë, por atributin kryesor në rritje e kishin shpenzimet e jointerestit, përkatësisht shpenzimet e provizioneve për humbje të mundshme nga kreditë, si dhe shpenzimet për tarifa dhe komisione.

Rritja më e lartë e shpenzimeve krahas të hyrave ndikoi që raporti i shpenzimeve ndaj të hyrave të sektorit të rritet në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit paraprak (figura 31).

Treguesit e profitabilitetit vazhdojnë të jenë të qëndrueshëm. Kthimi në Mesataren e Aseteve (KMA) dhe Kthimi në Mesataren e Kapitalit (KMK) ishin 2.5 përqind dhe 20.4 përqind, respektivisht (figura 32).

Figura 32. Treguesit e profitabilitetit të sektorit bankar



Burimi: BQK (2019)

### Treguesit e shëndetit financiarë

Cilësia e portofolit kreditor të sektorit bankar vazhdoi të përmirësohet. Raporti i kredive joperformuese ndaj gjithsej kredive zbriti në 2.7 përqind, për 0.4 pikë përqindje më të ulët sesa në vitin paraprak. Ky raport i kredive joperformuese ndaj gjithsej stokut të kredive mbetet më i ulëti në nivel të vendeve të Ballkanit. Raporti i mbulueshmërisë së kredive joperformuese me provizione arriti në 152.1 përqind (figura 33).

Sektori bankar vazhdon të ketë nivel dhe cilësi të lartë të kapitalit. Megjithatë, shpërndarja e dividendës nga disa banka, si dhe rritja e vazhdueshme e kreditimit ndikoi në rritjen më të lartë të mjeteve të peshuara me rrezik, gjë që u reflektua në rënie të treguesit të mjaftueshmërisë së kapitalit në 17.0 përqind nga 18.1 përqind në vitin paraprak, por që vazhdon të mbetet lartë mbi nivelin minimal rregullativ prej 12.0 përqind. Pozita e likuiditetit të sektorit bankar mbetet e qëndrueshme. Raporti i mjeteve likuide ndaj detyrimeve afatshkurtra qëndroi në 38.5 përqind, që është lartë mbi minimumin e kërkuar rregullator prej 25.0 përqind.

### 3.4.3 Sektori pensional

Sektori pensional në vitin 2018 u karakterizua me ngadalësim të rritjes, ku rritja vjetore e aseteve zbriti në 2.2 përqind nga 16.0 përqind sa ishte në vitin paraprak. Vlera e përgjithshme e aseteve të sektorit pensional arriti në 1.69 miliardë euro (figura 34). Në ngadalësimin e rritjes së aseteve në periudhën raportuese ndikoi rezultati financiar negativ nga investimet, përderisa kontribut pozitiv dha rritja e kontributeve të arkëtuara nga Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës (FKPK) dhe Fondi Slloveno-Kosovar i Pensioneve (FSKP).


Vlera e kontributeve të arkëtuara nga sektori pensional arriti në 173.2 milionë euro (160.3 milionë euro në 2017), që paraqet rritje vjetore prej 8.1 përqind. Vlera e arkëtimit të FKPK-së arriti në 172.7 milionë euro, ndërsa ajo e FSKP-së arriti në 515.3 mijë euro.

Sektori pensional për vitin 2018 u karakterizua me rënie të vlerës së investimeve prej 84.9 milionë euro, si pasojë e zhvillimeve në tregjet financiare ndërkombëtare. Çmimi i njësisë për FKPK zbriti në 1.39 nga 1.46 euro sa ishte në dhjetor 2017, dhe çmimi i njësisë së FSKP-së zbriti në 156.6 euro nga 165.5 euro sa ishte në dhjetor 2017.

Viti 2018 në tregjet financiare në SHBA u karakterizua si një vit i luhatjeve ekstreme. Indekset kyçe në një rën të arritën rezultate financiare pozitive rekorde nga investimet gjatë muajve shtator dhe tetor, përderisa në anën tjetër ato mbyllën vitin me rënie të theksuar.


Kjo rënie në fund të vitit u ndikua nga shitja e madhe e instrumenteve financiare, nga investitorët dhe tregtuesit e letrave me vlerë, nxitur nga pasiguria si pasojë e mosmarrëveshjeve tregtare mes SHBA-së dhe Kinës, indikacioneve për ngadalësim ekonomik global, rritjes së mëtutjeshme të normës bazë nga Rezerva Federale, pasiguria në lidhje me rritjen potenciale të inflacionit dhe gjendjes politike brenda SHBA-ve si dhe jashtë saj (ndikimi i BREXIT-it në Britaninë e Madhe dhe Evropë, si dhe ngadalësimi ekonomik i Kinës).

Figura 33. Treguesit e kualitetit të portofolios kreditore dhe norma e rritjes së KJP-ve



Burimi: BQK (2019)

Figura 34. Asetet e sektorit pensional, në milionë euro



Burimi: BQK (2019)

Këto zhvillime si dhe ekspozimi i lartë i sektorit pensional me investime të aseteve jashtë vendit ndikuan në rezultatin financiar negativ bruto nga investimet në fund të vitit 2018.

FKPK, e cila dominon asetet e sektorit pensional me pjesëmarrje prej 99.6 përqind, rriti investimin në Letrat me Vlerë të Qeverisë së Kosovës, të cilat arritën vlerën prej 209.0 milionë euro (95.0 milionë euro në dhjetor 2017), apo e shprehur si pjesëmarrje në gjithsej asetet e sektorit në 12.4 përqind nga 5.8 përqind në dhjetor 2017. Në të njëjtën kohë, vlera e investimeve në fondet e përbashkëta investive jashtë vendit zbriti në 1.23 miliardë euro, që përfaqëson 73.0 përqind të gjithsej aseteve të sektorit për dallim nga 89.8 përqind në dhjetor 2017, apo në vlerë prej 1.48 miliardë euro (figura 35).


### 3.4.4 Sektori i sigurimeve

Edhe pse është ende me shkallë të ulët të zhvillimit, sektori i sigurimeve reflekton potencial për zhvillim të mëtutjeshëm. Niveli i penetrimit (ndërmjetësimit) të sektorit, më saktësisht primet e shkruara bruto në raport me BPV-në e vendit, është në nivel të ulët prej 1.4 përqind. Ndërsa niveli i densitetit, që paraqet primet e shkruara për kokë banori, edhe pse është në nivel të ulët në krahasim me vendet e rajonit, gradualisht ka shënuar rritje ndër vite në 51.2 euro nga 48.2 euro për kokë banori sa ishte në dhjetor 2017.

Tregu i sigurimeve në Kosovë karakterizohet me një koncentrim të ulët, që është parakusht për funksionalizimin e një konkurrence më të madhe në treg. Indeksi i Herfindahl-it<sup>11</sup> i kalkuluar për primet e shkruara bruto (PSHB) për vitin 2018 tregon 870 pikë (2017 – 875). Ndërsa, po i njëjti indeks i kalkuluar duke marrë për bazë asetet e tregut të sigurimeve tregon vlera më të ulëta, përkatësisht 808 pikë për vitin 2018 nga 765 në vitin 2017. Në të njëjtën kohë, indeksi CR5<sup>12</sup> për vitin 2018, i llogaritur në raport me PSHB për sektorin e sigurimeve rezulton 52.8 përqind (2017 - 53.2 përqind), ndërsa i llogaritur në raport me asetet rezulton me 49.8 përqind (2017 - 47.7 përqind). Sipas sektorëve, koncentrimi është më i lartë te sektori i sigurimeve jetë, kjo si rezultat i numrit më të vogël të siguruesve në këtë sektor.

Asetet e sektorit të sigurimeve, që përfaqësojnë 2.8 përqind të gjithsej aseteve të sistemit financiar, në dhjetor 2018 zbritën në 175.7 milionë euro, duke shënuar rënie vjetore marginale prej 0.6


Figura 35. Investimet e FKPK-së



Burimi: FKPK (2019)

investimeve në fondet e përbashkëta investive jashtë vendit zbriti në 1.23 miliardë euro, që përfaqëson 73.0 përqind të gjithsej aseteve të sektorit për dallim nga 89.8 përqind në dhjetor 2017, apo në vlerë prej 1.48 miliardë euro (figura 35).

Figura 36. Asetet e sektorit të sigurimeve



Burimi: BQK (2019)

<sup>11</sup> Indeksi Herfindahl është llogaritur me formulën në vijim:  $HI = \sum_{i=1}^n (s_i)^2$ , ku S pjesëmarrjen e kompanisë në gjithsej mjetet (primet e shkruara bruto) e tregut të sigurimeve, n është gjithsej numri i institucioneve në sektorin përkatës. Në qoftë se indeksi shtrihet ndërmjet intervaleve 1,000 – 1,800 njësi, niveli i koncentrimit në sektorin e sigurimeve konsiderohet i pranueshëm.

<sup>12</sup> Indeksi CR5 kombinon pjesëmarrjen në treg të 5 kompanive me vlerat më të larta të aseteve në raport me gjithsej asetet e sektorit dhe PSHB ndaj gjithsej PSHB të sektorit.

përqind, krahas rritjes prej 9.3 përqind të vitit të kaluar (figura 36). Në rënien e aseteve të sektorit të sigurimeve ndikoi tërheqja nga tregu e një prej kompanive të sigurimit jetë gjatë vitit 2018. Përderisa, zërat të cilat shënuan rritje vjetore në kuadër të aseteve ishin investimet në Letra me Vlerë të Qeverisë së Kosovës, si dhe të arkëtueshmet nga të siguruarit. Ndërsa, depozitat e mbajtura në bankat komerciale shënuan rënie duke sugjeruar investim të mjeteve drejt instrumenteve me kthim më të lartë. Sidoqoftë, depozitat e mbajtura në bankat komerciale mbeten kategori dominuese në bilancin e gjendjes së sektorit të sigurimeve me pjesëmarrje prej 49.6 përqind.

Sigurimet jojetë, që njëherësh kanë edhe pjesëmarrjen më të lartë në gjithsej asetet e sektorit (90.8 përqind), shënuan rritje vjetore prej 2.7 përqind në vitin 2018. Në kuadër të aseteve të sigurimit jojetë, asetet likuide kanë vazhduar të dominojnë me pjesëmarrje në kuadër të gjithsej mjeteve me 62.6 përqind (2017 – 64.2 përqind), dhe të njëjtat kanë shënuar rritje vjetore marginale prej 0.2 përqind. Mjetet likuide kryesisht përbëheshin nga depozitat në banka komerciale dhe investimet në Letra me Vlerë të Qeverisë së Kosovës. Ndërsa, sigurimet "jetë", që përbëjnë pjesën e mbetur të aseteve, shënuan rënie vjetore të konsiderueshme prej 24.8 përqind, si pasojë e likuidimit vullnetar të një prej siguruesve 'jetë' gjatë vitit 2018.

Sa i përket detyrimeve të sektorit, rezervat teknike dhe matematike përbëjnë pjesën më të madhe me gjithsej 70.8 përqind, pasuar nga ekuiteti me 25.0 përqind dhe detyrimet e tjera me 7.6 përqind. Vlera e gjithsej kapitalit të siguruesve u zvogëlua për 6.1 përqind dhe zbriti në 44.0 milionë euro, për 2.8 milionë euro më pak në krahasim me vitin paraprak 2017.

Rënia e kapitalit i atribuohet rënies së kapitalit të siguruesve jetë, të cilët në krahasim me vitin paraprak shënuan rënie vjetore prej 20.7 përqind si pasojë e tërheqjes nga tregu i njërit nga siguruesve 'jetë'. Në nivel të gjithsej kapitalit të tregut të sigurimeve afër 78.8 përqind e kapitalit përbëhej nga sigurimet jojetë ndërsa 21.2 përqind nga sigurimet jetë. Në kuadër të kapitalit, në vitin 2018 rezervat e rivlerësimit shënuan rritje vjetore prej 30.7 përqind krahas vitit paraprak, ndërsa humbjet e akumuluar (vlera negative e fitimeve të mbajtura) u zvogëluan për 11.9 përqind. Përderisa, fitimi neto i periudhës u zvogëlua për 75.3 përqind krahas vitit paraprak 2017.

Provizionet teknike të cilat përbëjnë pjesën më të madhe të detyrimeve të siguruesve gjatë vitit 2018, shënuan rritje vjetore prej 4.0 përqind në krahasim me vitin paraprak 2017. Kryesisht, rritja e provizioneve teknike u ndikua pozitivisht nga rritja vjetore prej 5.6 përqind e provizioneve për prime të sektorit të sigurimeve jojetë. Po ashtu, rritje prej 17.8 përqind shënuan rezervat matematikore në krahasim me vitin 2017.

Gjatë vitit 2018, vlera e primeve të shkruara nga siguruesit arriti në 92.1 milionë euro, një rritje vjetore prej 6.2 përqind. Struktura e primeve të shkruara kryesohet nga primet e sigurimit jojetë të cilat përfaqësojnë 96.8 përqind të gjithsej primeve të shkruara. Vlera e tyre gjatë kësaj periudhe prej 89.1 milionë euro është për 5.8 përqind më e lartë se në vitin 2017. Nga gjithsej 12 siguruesit jojetë gjatë këtij viti 8 prej tyre shënuan rritje në nivelin e primeve të shkruara bruto, ndërsa 4 sigurues tjerë shënuan rënie të primeve në krahasim me vitin 2017. Për më tepër, sigurimet jojetë vazhdojnë të dominohen nga sigurimet e detyrueshme me një pjesëmarrje prej 61.7 përqind në gjithsej bruto primet e shkruara jojetë, ndërsa sigurimet vullnetare përbëjnë 38.3 përqind të gjithsej primeve të shkruara bruto jojetë. Ndërsa, vlera e primeve të shkruara nga sigurimi jetë arriti në 3.0 milionë euro që paraqet vlerë më të lartë për 16.6 përqind.

Raporti i vetëmbajtjes së primeve krahas gjithsej primeve bruto të shkruara vazhdon të jetë i lartë me pjesëmarrje prej 87.7 përqind (89.5 përqind në dhjetor 2017), ndërsa pjesëmarrja e primeve të risiguruarra qëndroi në 12.3 përqind (10.5 përqind në dhjetor 2017).


**Tabela 5. Prime nga sigurimet jo-jetë (në miliona euro)**

Aktiviteti	2017	2018	Ndryshimi në %	Pjesëmarrja 2017	Pjesëmarrja 2018
Sigurime të detyrueshme	54.3	55.0	1.3%	64.5%	61.7%
Sigurime vullnetare	29.9	34.1	14.1%	35.6%	38.3%
Gjithsejtë sigurime jo-jetë	84.2	89.1	5.8%	100.0%	100.0%

Burimi: BQK (2019)

Gjatë vitit 2018 produktet e sigurimeve të detyrueshme shënuan rritje prej 1.3 përqind, përderisa pjesëmarrja e tyre në gjithsej primet e shkruara bruto shënoi rënie në 61.7 përqind nga 64.4 përqind sa ishte në vitin 2017 (tabela 5). Rënia e pjesëmarrjes së sigurimeve të detyrueshme u ndikua nga produktet “MTPL” dhe “Sigurimet kufitare”. Ndërsa, sigurimet vullnetare shënuan rritje prej 14.1 përqind, njëkohësisht edhe pjesëmarrja e tyre në gjithsej primet e shkruara bruto shënoi rritje në 38.3 përqind nga 35.5 përqind sa ishte në vitin 2017. Rritja e pjesëmarrjes së sigurimeve vullnetare në gjithsej primet e shkruara bruto u ndikua nga rritja e primeve për produktet si “Kredi dhe Garancione”, “Kasko”, “Sigurime në Pronë”, “Aksident dhe Shëndet” dhe produktet tjera që shënuan rritje të lehta (tabela 6).

Dëmet e paguara nga sektori i sigurimeve, ku përfshihen dëmet e kompanive të sigurimit dhe Byrosë Kosovare të Sigurimit (BKS), shënuan ngadalësim të rritjes vjetore në 5.0 përqind duke arritur në 48.3 milionë euro në vitin 2018 krahas rritjes prej 17.9 përqind në vitin 2017. Nga gjithsej shuma e dëmeve të paguara, 42.8 milionë euro (41.2 milionë euro në dhjetor 2017) ishin dëme të paguara nga siguruesit, ndërsa 5.4 milionë euro (4.8 milionë euro në dhjetor 2017) dëme të paguara nga BKS. Dëmet e paguara nga risiguruesit marrin pjesë me vetëm 10.0 përqind në gjithsej shumën e paguar të dëmeve për vitin 2018.

**Figura 37. Primet e shkruara dhe dëmet e paguara**

Rritja e nivelit të dëmeve të paguara gjatë vitit 2018 u ndikua kryesisht nga pagesa e dëmeve në emër të produkteve të sigurimeve tjera vullnetare. Gjatë vitit 2018 shuma e dëmeve të paguara nga sigurimet vullnetare arriti në 16.0 milionë euro ose 8.3 përqind më shumë në krahasim me vitin paraparak 2017. Për dallim nga sigurimet vullnetare, dëmet e paguara nga sigurimet e detyrueshme edhe pse me një pjesëmarrje më të madhe në gjithsej portofolin, gjatë vitit 2018 shënuan rritje prej 2.6 përqind. Kjo rritje në dëmet e paguara nga sigurimet e detyrueshme u ndikua nga produkti “autopërgjegjësia e brendshme”.

Ndërsa, shuma e dëmeve të paguara nga sigurimet jetë zbriti në 552 mijë euro nga 777 mijë euro sa ishte në vitin 2017, duke shënuar rënie vjetore prej 28.9 përqind.

Rritja më e lartë e primeve të shkruara gjatë kësaj periudhe krahas rritjes më të vogël të dëmeve të paguara, rezultoi në rënie të raportit të gjithsej dëmeve të paguara ndaj primeve të shkruara (figura 37).



**Tabela 6. Primet e shkruara bruto sipas klasave të biznesit (në miliona euro)**

Përshkrimi	2017	2018	Ndryshimi	Pjesëmarrja 2017	Pjesëmarrja 2018
Aksident dhe shëndet	17.0	18.0	6.1%	19.6%	19.6%
Sigurimet Kufitare	7.2	7.4	2.7%	8.3%	8.1%
Kasko	3.9	4.5	16.4%	4.4%	4.9%
Kredi dhe Garancione	2.5	3.6	43.7%	2.9%	3.9%
Sigurime në pronë	4.6	5.4	16.3%	5.3%	5.8%
Sigurime nga humbjet financiare	0.8	1.0	17.8%	1.0%	1.1%
Sigurimi i përgjegjësisë	1.1	1.6	42.6%	1.3%	1.7%
Marinë dhe transport	0.0	0.1	191.2%	0.0%	0.1%
MTPL	44.9	45.3	0.9%	51.7%	49.2%
TPL+	2.2	2.3	4.8%	2.5%	2.5%
Gjithsej Jo-jetë	84.2	89.1	5.8%	97.1%	96.8%
Gjithsej Jetë	2.5	3.0	16.6%	2.9%	3.2%
Gjithsej TREGU	86.7	92.1	6.2%	100.0%	100.0%

Burimi: BQK (2019)

**3.4.4.1 Performanca e sektorit të sigurimeve**

Sektori i sigurimeve këtë vit e mbylli me rezultat pozitiv financiar edhe pse me fitim neto më të ulët për dallim nga viti i kaluar. Fitimi i regjistruar në vitin 2018 ishte 1.6 milionë euro krahasuar me fitimin prej 6.4 milionë euro në vitin 2017. Në kuadër të këtij fitimi të realizuar, siguruesit jojetë operuan me fitim prej 1.0 milionë euro, ndërsa siguruesit jetë 0.6 milionë euro. Ky rezultat financiar pasqyron rritjen më të lartë të dëmeve të ndodhura prej 39.5 përqind kundrejt rritjes së të hyrave neto nga primi, prej 5.8 përqind dhe njëkohësisht rënies vjetore të shpenzimeve të sektorit prej 3.4 përqind.

**Tabela 7. Rezultati financiar në miliona euro**

Përshkrimi	2017	2018	Ndryshimi
Sigurimet Jo-jetë	6.2	1.0	-84.0%
Sigurimet Jetë	0.2	0.6	194.1%
Gjithsejtë tregu	6.4	1.6	-75.3%

Burimi: BQK (2019)

Një ndër faktorët kryesorë në realizimin e rezultatit financiar pozitiv është raporti i kombinuar në masë prej 97.7 përqind, i cili paraqet raportin e dëmeve prej 50.6 përqind dhe raportin e shpenzimeve prej 47.1 përqind, pa përfshirë të hyrat nga interesat e investimeve, ku sipas këtij raporti tregu i sigurimeve për 1 euro të fituar ka shpenzuar 0.98 cent.

Bazuar në Rregulloren për investimin e aseteve në mbulim të provizioneve teknike dhe matematike si dhe investimin e kapitalit themeltar të siguruesve, siguruesit janë të detyruar të mbajnë asete të mjaftueshme në mbulim të provizioneve teknike dhe matematike jo më pak se vlera bruto e provizioneve teknike, respektivisht matematike. Treguesi i mbulueshmërisë së provizioneve teknike me asete likuide në vitin 2018 për sigurimet jojetë ishte në normën 100.6 përqind (120.6 përqind në vitin 2017). Ndërsa, treguesi i mbulueshmërisë së provizioneve teknike me asete likuide në vitin 2018 për sigurimet Jetë ishte në normën 137.4 përqind.

Rënia vjetore e parasë së gatshme dhe ekuivalentëve të saj prej 3.1 përqind, krahas rritjes prej 4.0 përqind të rezervave teknike të sektorit të sigurimeve ndikuan në rënien e nivelit të likuiditetit. Raporti ndërmjet parasë së gatshme dhe ekuivalentëve të saj ndaj rezervave u zvogëlua në 97.2 përqind në vitin 2018 nga 104.3 përqind sa ishte në vitin 2017, gjithashtu raporti ndërmjet parasë së gatshme dhe ekuivalentëve të saj ndaj gjithsej detyrimeve u zvogëlua në 87.3 përqind (91.3 përqind në vitin 2017).


### 3.4.5 Sektori mikrofinanciar

#### Asetet

Gjatë vitit 2018, asetet e sektorit mikrofinanciar arritën në 250.0 milionë euro dhe shënuan rritje vjetore prej 30.0 përqind (figura 38).

Rritja e aseteve të sektorit mikrofinanciar në vitin 2018 kryesisht i atribuohet rritjes së kredive bruto, aktivitet që kryesisht financohet nga huamarrjet në sektorin e jashtëm. Struktura e aseteve të sektorit mikrofinanciar vazhdon të dominohet nga kreditë bruto (73.5 përqind), pasuar nga lizingjet (15.2 përqind).

Figura 38. Asetet e sektorit mikrofinanciar




Burimi: BQK (2019)

#### Kreditë

Aktiviteti kreditor i sektorit mikrofinanciar gjatë vitit 2018 shënoi rritje vjetore prej 27.7 përqind, ku vlera e kredive arriti në 183.8 milionë (figura 39).


Dinamikat në zhvillimet e aktivitetit kreditor të sektorit pasqyruan kryesisht ecuritë pozitive të kreditimit ndaj ekonomive familjare, si kategori me pjesëmarrje prej 66.0 përqind të gjithsej kreditimit të sektorit. Kreditë ndaj ekonomive familjare shënuan rritje vjetore prej 31.7 përqind duke arritur vlerën prej 121.4 milionë euro. Ndërsa kreditë ndaj ndërmarrjeve, me një pjesëmarrje prej 34.0 përqind në gjithsej kreditë e sektorit, u rritën për 20.6 përqind duke arritur vlerën prej 62.4 milionë euro.

Figura 39. Vlera e kredive ndaj ekonomive familjare dhe ndërmarrjeve dhe rritja vjetore e kredive



Burimi: BQK (2019)

Figura 40. Rritja e kredive ndaj ndërmarrjeve, sipas sektorëve ekonomik



Burimi: BQK (2019)

Kreditë e të gjithë sektorëve ekonomikë shënuan rritje, por ritmi i rritjes ishte më i ulët krahasuar me vitin paraprak (figura 40). Rritjen më të lartë e kishin kreditë e dedikuara për sektorin e industrisë pasuar nga kreditë për sektorin e tregtisë dhe bujqësisë.

#### Lizingjet

Lizingjet, si kategoria e dytë për nga pesha në strukturën e aseteve të sektorit mikrofinanciar, shënuan rritje vjetore prej 43.2 përqind në vitin 2018 dhe arritën vlerën prej 38.1 milionë euro (figura 41).




Në rritjen e lizingjeve kontribuoi rritja e "lizingjeve tjera" dhe lizingjeve hipotekare, të cilat regjistruan rritje vjetore prej 39.3 përkatësisht 25.8 përqind, e që po ashtu dominojnë strukturën e lizingjeve të sektorit.

### Normat e interesit


Norma mesatare e interesit në kreditë e sektorit mikrofinanciar në dhjetor 2018 shënoi rënie në 21.7 përqind nga 22.6 përqind sa ishte në dhjetor 2017. Norma e interesit për kreditë ndaj ekonomive familjare regjistroi rënie prej 1.7 pikë përqindje, ndërsa norma e interesit në kreditë ndaj ndërmarrjeve regjistroi rënie prej 0.6 pikë përqindje (figura 42).

Figura 41. Lizingjet e sektorit mikrofinanciar (në përqindje)




Burimi: BQK (2019)

Figura 42. Norma mesatare e interesit në kredi të sektorit mikrofinanciar



Burimi: BQK (2019)

Figura 43. Norma mesatare e interesit në kredi, sipas sektorëve ekonomik




Burimi: BQK (2019)

Në kuadër të kredive ndaj ndërmarrjeve, për të gjithë sektorët kishte rënie të normës mesatare të interesit. Sektori i shërbimeve rezultoi të ketë normën më të ulët të interesit në kredi, për më tepër shënoi edhe rënie më të madhe prej 4.5 pikë përqindje. Ndërsa, kreditë për sektorin e industrisë vazhdojnë të kenë normën më të lartë të interesit në kredi edhe pse shënoi rënie prej 2.2 pikë përqindje për dallim nga viti i kaluar (figura 43).

### Performanca e sektorit mikrofinanciar


Gjatë vitit 2018, sektori mikrofinanciar realizoi profit në vlerë prej 9.7 milionë euro, që përbën një rritje vjetore prej 31.0 përqind krahasuar me profitin e realizuar në vitin 2017.

Figura 44. Të hyrat dhe shpenzimet e sektorit mikrofinanciar



Burimi: BQK (2019)


Figura 45. Treguesit e profitabilitetit të sektorit mikrofinanciar



Burimi: BQK (2019)

Rritja më e lartë e të hyrave (kryesisht të hyrave nga interesi) ishte kontribuues kryesor në rritjen e profitit për 2.3 milionë euro (figura 44). Në anën tjetër, përshpejtimi i rritjes së shpenzimeve të sektorit, kryesisht shpenzimet administrative dhe të personelit që mund të jetë ndikuar nga rritja e numrit të të punësuarve në këtë sektor, ndikoi që rritja e fitimit të sektorit të jetë më e ulët për dallim nga viti paraprak (rritje prej 85.9 përqind). Si rrjedhojë e rezultatit financiar pozitiv gjatë vitit 2018, treguesit e profitabilitetit shënuan rritje (figura 45). Niveli i kredive joperformuese në raport me gjithsej kreditë në vitin 2018 u zvogëlua për 0.6 pikë përqindje, duke zbritur në 2.2 përqind, nivel ky më i ulëti në vitet e fundit. Për më tepër, niveli i mbulueshmërisë së kredive joperformuese me provizione vazhdoi të jetë i lartë, në nivel prej 226.0 përqind (figura 46).

Figura 46. Treguesit e kualitetit të portofolios kreditore



Burimi: BQK (2019)

### 3.5. Projektionet makroekonomike për vitin 2019

Projektionet e BQK-së për vitin 2019 sugjerojnë që ekonomia e Kosovës pritet të karakterizohet me rritje reale prej 4.2 përqind. Konsumi, si komponenta kryesore e kërkesës së brendshme, pritet të shënojë rritje reale prej 3.4 përqind, bazuar në pritjet që konsumi privat do të rritet me 3.0 përqind dhe konsumi publik me 5.8 përqind. Faktorët që pritet të ndikojnë në rritjen e konsumit privat, ndër të tjera, janë edhe rritja e remitencave dhe rritja e kredive. Remitencat pritet të shënojnë rritje vjetore prej rreth 5.6 përqind. Gjithashtu, kreditë për ekonomitë familjare, të cilat në vitet e fundit kanë shënuar rritje të konsiderueshme (11.2 përqind në vitin 2018 dhe 12.7 përqind në vitin 2017), pritet të vazhdojnë këtë trend të rritjes edhe në vitin 2019.

Investimet në vitin 2019 parashihet të shënojnë rritje reale prej 11.6 përqind, bazuar në parashikimet për rritje të konsiderueshme të investimeve publike (19.9 përqind) por edhe të investimeve private (8.8 përqind). Rritja e investimeve private në vitin 2019 pritet të vazhdojë të mbështetet nga kreditimi bankar, aktivitet që është karakterizuar me ritëm të shpejtë të rritjes në vitet e fundit. Po ashtu, ndryshimet në politikën tatimore gjatë viteve të kaluara pritet të jenë mbështetëse për investimet private në vend. Rritjes së pozicionit të përgjithshëm të investimeve pritet t'i kontribuojë edhe rritja e IHD-ve në vitin 2019, investime që pritet të shënojnë rritje prej rreth 12.7 përqind.

Për dallim nga viti 2018 kur ishte shënuar rritje e kërkesës së brendshme dhe për pasojë, rritje e kontributit negativ të pozicionit të neto eksporteve kur kemi parasysh financimin e një pjese të aktivitetit të rritur ekonomik përmes importeve, në vitin 2019, projektionet sugjerojnë ngadalësim të komponentëve të kërkesës së brendshme dhe rënie të kontributit negativ të neto eksporteve. Eksporti i mallrave pritet të shënojë rritje nominale prej rreth 4.8 përqind, ndërsa importi pritet të rritet për rreth 4.5 përqind. Parashikimet për rritje jo edhe aq të lartë të eksportit të mallrave në vitin 2019 mbështeten në supozimin se kërkesa e jashtme pritet të jetë e ulët dhe çmimet (kryesisht çmimet e metaleve) në tregjet ndërkombëtare pritet të shënojnë rënie të lehtë. Rritja më e ngadalësuar e kërkesës së përgjithshme në vend, si dhe rënia e çmimeve të importit pritet të ndikojë në një rritje më të ngadalësuar të vlerës së importit të mallrave në vitin 2019. Ndryshimi ndërmjet nivelit shumë të lartë të importit të mallrave kundrejt eksportit do të rezultojë në thellim të deficitit tregtar të mallrave për rreth 4.5 përqind në terma nominal. Në anën tjetër, bilanci tregtar pozitiv në kuadër të shërbimeve pritet të rritet për 6.2 përqind. Eksporti dhe importi i shërbimeve pritet të shënojnë rritje prej rreth 4.5 përqind përkatësisht 2.3 përqind. Rritja e

eksportit të shërbimeve pritet të gjenerohet nga rritja e eksportit të shërbimeve të udhëtimit (kryesisht shpenzimet e emigrantëve gjatë qëndrimit në Kosovë) dhe komunikimit. Ndërkaq, rritja e importit të shërbimeve gjatë vitit 2019 pritet të gjenerohet kryesisht nga rritja e importit të shërbimeve të udhëtimit dhe transportit.

Sa i përket inflacionit, norma mesatare pritet të arrijë në rreth 2.3 përqind që është nivel më i lartë krahasuar me vitin 2018 kur ishte shënuar normë e inflacionit prej 1.1 përqind. Kjo rritje e shkallës së inflacionit është në përputhje me parashikimet për rritje të lehtë të inflacionit në nivel global por edhe të rritjes së aktivitetit ekonomik në vend.

Norma vjetore e rritjes së aktivitetit kreditues në vitin 2019 pritet të jetë rreth 11.0 përqind, supozim që mbështetet nga lehtësimi i standardeve të kreditimit nga bankat, rënia e normave të interesit në kredi, si dhe rritja e aktivitetit ekonomik. Parashikimet e BQK-së për rritje të kreditimit janë gjithashtu në linjë me raportimet e bankave në kuadër të anketës së kreditimit bankar, rezultatet e së cilës sugjerojnë se do të ketë rritje të aktivitetit kreditor gjatë periudhave në vazhdim. Edhe depozitat pritet të vazhdojnë trendin e rritjes që i ka karakterizuar në vitet e fundit. Rritja e depozitave gjatë vitit 2019 pritet të jetë rreth 7.0 përqind. Rrjedha e pritur e depozitave është e lidhur me të ardhurat kombëtare të disponueshme të cilat pritet të rriten për 7.0 përqind në vitin 2019.

## 4. Licencimi dhe rregullimi i sistemit financiar

Bazuar në Ligjin për BQK-në, objektiv parësor i saj është nxitja dhe mbajtja e një sistemi financiar stabil. BQK-ja angazhohet në arritjen e kësaj objektive përmes përbushjes së detyrave dhe përgjegjësi si autoritet përgjegjës për licencimin, mbikëqyrjen dhe rregullimin e institucioneve financiare që operojnë në Republikën e Kosovës.

BQK-ja, në zbatim të përgjegjësi ligjore si autoritet licencues, rregullues dhe mbikëqyrës i institucioneve financiare në vend, angazhohet në:

- Rregullimin e hyrjes në treg të investitorëve potencialë, duke përcaktuar kritere për licencimin e institucioneve financiare dhe të atyre institucioneve, që posedojnë kapital të mjaftueshëm për mbështetjen e aktiviteteve të parapara, që prezantojnë përgatitjet e duhura për vlerësimin dhe monitorimin e rrezikut, politika dhe procedura adekuate për kontrollin e tij, si dhe administratorë me nivel të lartë kualifikimi, profesionalizmi dhe etike.
- Hartimin dhe mirëmbajtjen e kornizës rregullatore të përbërë nga një tërësi kriteresh minimale dhe kërkesash rregullative të aplikueshme ndaj institucioneve financiare, në harmoni me legjislacionin primar, Direktivat Evropiane si dhe standardet ndërkombëtare;
- Zhvillimin e një procesi mbikëqyrës efektiv, duke zbatuar parimet e mbikëqyrjes së bazuar në rrezik, nëpërmjet ekzaminimeve në vend, si dhe analizimin, vlerësimin dhe interpretimin e të dhënave të institucioneve financiare, vlerësimin e trendëve të ardhshëm financiar; si dhe ndërmarrjen e masave përmirësuese për zgjidhjen e problemeve të ndryshme.
- Bashkëpunimin me institucionet financiare të licencuara dhe mbikëqyrura nga BQK-ja, si dhe me autoritetet e huaja mbikëqyrëse për bankat, që operojnë në territorin e Republikës së Kosovës.

Me qëllim të kryerjes së funksioneve të saj mbikëqyrëse, BQK-ja synon nivelet më të larta të integritetit, profesionalizmit, efikasitetit, transparencës dhe zhvillimit të përhershëm të kapaciteteve të saj mbikëqyrëse.


### 4.1. Licencimi

Sipas Ligjit për BQK-në, autoriteti i vetëm përgjegjës për rregullimin, licencimin/regjistrimin dhe mbikëqyrjen e institucioneve financiare në Republikën e Kosovës është Banka Qendrore e Republikës së Kosovës.

BQK-ja ka për qëllim që të sigurojë një proces transparent dhe gjithëpërfshirës të licencimit, i cili ndihmon për të siguruar një mjedis të sigurt, të qëndrueshëm dhe konkurrues financiar të ndërtuar mbi bazën e parimit të drejtësisë, ndershmërisë dhe barazisë. Kushtet dhe kriteret e licencimit janë të karakterit mbikëqyrës dhe nuk kanë për qëllim vendosjen e barrierave ndaj investitorëve qofshin ata të brendshëm apo të jashtëm. Hyrja e investitorëve të huaj në tregun kosovar, veçanërisht në sektorin financiar, dëshmon politikën e hapur të BQK-së ndaj investimeve të huaja, pa i cenuar kërkesat ligjore.

Struktura e sistemit financiar në fund të vitit 2018, sipas llojit të institucioneve financiare të licencuara dhe regjistruara që ofrojnë shërbime financiare në Kosovë, bazuar në legjislacionin e aplikuar në Republikën e Kosovës dhe në kuadrin rregullator në fuqi të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, të renditura sipas peshës së tyre në sistem, është paraqitur në figurën 47.

Figura 47. Struktura e sistemit financiar në Kosovë




Struktura e sistemit financiar përbëhet nga gjithsej 113 institucione financiare, të cilat janë licencuar dhe regjistruar si dhe ushtrojnë veprimtarinë e tyre në Kosovë bazuar në legjislacionin e aplikuar në Republikën e Kosovës dhe në kuadrin rregullator në fuqi të BQK-së.

#### 4.1.2 Rrjeti i sistemit financiar

Në fund të vitit 2018, bankat e ushtruan veprimtarinë e tyre në gjithsej 47 degë dhe 165 zyra brenda territorit të vendit (figura 48). Gjatë këtij viti bankat me miratim të BQK-së, kanë hapur 2 degë dhe 3 nëndegë, kanë zhvendosur 15 degë dhe zyra si dhe kanë mbyllur 21 zyra. Ngushtimi i rrjetit fizik të degëve dhe zyrave është bërë kryesisht bazuar në vlerësim të performancës dhe efikasitetit të tyre, dhe si rrjedhojë e zgjerimit të shërbimeve të automatizuara si: e-banking, bankomatëve, terminaleve të shitjes, mobile banking etj.

Figura 48. Rrjeti bankar sipas numrit të degëve/zyrave



Burimi: BQK (2019)

Shpërndarja gjeografike e rrjetit bankar përfshin pothuajse të gjithë territorin e vendit përkundër ngushtimit të shënuar në raport me numrin e degëve dhe zyrave (tabela 8). Megjithatë, vazhdon të evidentohet përqendrim më i madh i degëve dhe zyrave në regjionin e Prishtinës (33.0 përqind), ku edhe përqendrimi i popullsisë është më i madh (28.0 përqind) siç edhe shihet në figurën 49.

Tabela 8. Shpërndarja gjeografike e degëve dhe zyrave të bankave

Përshkrimi	Regjioni i Prishtinës		Regjioni i Prizrenit		Regjioni i Pejës		Regjioni i Gjilanit		Regjioni i Mitrovicës		Gjithsej
	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	
2014	97	35.0%	45	16.2%	46	16.6%	55	19.9%	34	12.3%	277
2015	93	35.1%	40	15.1%	45	17.0%	52	19.6%	35	13.2%	265
2016	95	36.3%	38	14.5%	42	16.0%	52	19.8%	35	13.4%	262
2017	83	34.9%	37	15.5%	39	16.4%	47	19.7%	32	13.4%	238
2018	74	33.3%	35	15.8%	38	17.1%	44	19.8%	31	14.0%	222


Burimi: BQK (2019)

Trendi pesëvjeçar sugjeron strategji konsistente të bankave sa i përket fokusimit gjeografik të rrjetit bankar marrë parasysh që nuk kemi ndryshim të rëndësishëm gjatë kësaj periudhe në raport me përqindjen e degëve dhe zyrave bankare përkundër ndryshimeve në raport me numrat e degëve dhe zyrave, për arsye se ngushtimi i rrjetit është bërë në mënyrë proporcionale në të gjitha regjionet.

Siguruesit veprimtarinë e tyre e ushtrojnë përmes 74 degëve, 427 zyrave dhe 94 agjentëve të jashtëm brenda territorit të vendit (shih figurën 50). Gjatë vitit 2018, kemi ngushtim të rrjetit të përgjithshëm të siguruesve në vend, gjë që reflekton strategjinë e zvogëlimit të shpenzimeve të ndjekur nga siguruesit. Rënia e numrit të agjentëve ndër tjerash reflekton edhe faktin, që nga hyrja në fuqi e Rregullores për licencimin e ndërmjetësuesve në sigurime, agjentët e brendshëm të siguruesve më nuk janë subjekt i miratimit të BQK-së.


Shpërndarja gjeografike e rrjetit të siguruesve përfshin pothuajse të gjithë territorin e vendit, megjithatë nuk përputhet me shpërndarjen gjeografike të popullsisë. Përderisa përqendrimi më i madh i popullsisë është në regjionin e Prishtinës (28.0 përqind, shih figurën 49) përqendrimi i rrjetit të siguruesve është në regjionin e Pejës që është një nga regjionet më pak të populluara në vend (shih figurën 49), dhe kjo strukturë është konsistente gjatë pesë viteve të fundit (tabela 9).

Figura 49. Shpërndarja e popullsisë në Kosovë sipas regjioneve



Burimi: ASK (2019)

Figura 50. Rrjeti i siguruesve



Burimi: BQK (2019)

Tabela 9. Rrjeti i siguruesve sipas shpërndarjes gjeografike

Vitet	Rajoni i Prishtinës		Rajoni i Prizrenit		Rajoni i Pejës		Rajoni i Gjiçanit		Rajoni i Mitrovicës		Gjithsej
	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	
2014	10	15.9%	10	15.9%	16	25.4%	17	27.0%	10	15.9%	63
2015	15	17.4%	41	47.7%	14	16.3%	7	8.1%	9	10.5%	86
2016	11	15.3%	11	15.3%	21	29.2%	18	25.0%	11	15.3%	72
2017	13	17.8%	11	15.1%	20	27.4%	19	26.0%	10	13.7%	73
2018	14	18.9%	11	14.9%	20	27.0%	19	25.7%	10	13.5%	74

Burimi: BQK (2019)

Fondet pensionale aktivitetin e tyre e zhvillojnë vetëm përmes zyrave qendrore me lokacion në Prishtinë.

Institucionet mikrofinanciare në fund të vitit 2018, aktivitetin e tyre e ushtrojnë përmes 130 zyrave të shpërndara brenda territorit të vendit. Gjatë vitit 2018 është aprovuar hapja e 12 zyrave, si dhe zhvendosja e 13 zyrave të tjera të IMF-ve. Shpërndarja gjeografike e zyrave të institucioneve

mikrofinanciare është e përqendruar vetëm në dy regjione të territorit të vendit konkretisht në regjionin e Prishtinës dhe të Pejës (tabela 10).

**Tabela 10. Rrjeti i IMF-ve sipas shpërndarjes gjeografike**

Përshkrimi	Regjioni i Prishtinës		Regjioni i Prizrenit		Regjioni i Pejës		Gjithsej
	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	
2014	7	57.1%	2	14.3%	4	28.6%	13
2015	7	53.8%	2	15.4%	4	30.8%	13
2016	7	53.8%	1	15.4%	3	30.8%	11
2017	8	63.6%	0	9.1%	3	27.3%	11
2018	8	72.7%	0	0.0%	3	27.3%	11

Burimi: BQK (2019)

Institucionet financiare jobankare në fund të vitit 2018, aktivitetin e tyre e ushtruan në gjithsej 700 zyra dhe agjentë të shpërndarë brenda territorit të vendit. Shpërndarja gjeografike e degëve dhe zyrave të institucioneve financiare jobankare është i përqendruar në pothuajse në gjithë territorin e vendit me përjashtim të regjionit të Mitrovicës (tabela 11).

**Tabela 11. Rrjeti i IFJB-ve sipas shpërndarjes gjeografike**

Përshkrimi	Regjioni i Prishtinës		Regjioni i Prizrenit		Regjioni i Pejës		Regjioni i Gjiçanit		Gjithsej
	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	
2014	17	36.2%	6	12.8%	12	25.5%	12	25.5%	47
2015	17	34.7%	7	14.3%	12	24.5%	13	26.5%	49
2016	18	34.6%	8	15.4%	12	23.1%	14	26.9%	52
2017	22	39.3%	10	17.9%	12	21.4%	12	21.4%	56
2018	26	42.6%	9	14.8%	13	21.3%	13	21.3%	61

Burimi: BQK (2019)

#### 4.1.3 Aktiviteti i licencimit

Në kuadër të përmbushjes së funksionit të licencimit dhe funksionimit normal të veprimtarive financiare, BQK-ja gjatë vitit 2018 ka shqyrtuar gjithsej 632 kërkesa nga të cilat 12 aplikacione për licencim/regjistrim dhe 620 kërkesa të institucioneve financiare për miratim të transaksioneve, të cilat sipas legjislacionit në fuqi kërkojnë miratim paraprak të BQK-së (tabela 12). Këtu nuk përfshihen: i) kërkesat e shqyrtuara të bartura për vendimmarrje në vitin 2019; ii) shprehjet e interesimit për licencim/regjistrim, iii) kërkesat të cilat vlerësohen mirëpo nuk janë subjekt i miratimit të BQK-së dhe iv) pyetjet, njoftimet dhe vlerësimet tjera të shqyrtuara nga BQK-ja.

Gjatë vitit 2018 ngjashëm me vitin e kaluar, BQK-ja ka pranuar kryesisht kërkesa për regjistrim të IMF-ve, IFJB-ve dhe ndërmjetësuesve në sigurime.

Në përgjithësi struktura e kërkesave për licencim mbetet e ngjashme, rritja e lehtë e shënuar në krahasim me vitet paraprake reflekton kërkesën më të lartë për regjistrim të IFJB-ve.



Tabela 12. Struktura e kërkesave të sistemit financiar të miratuara/refuzuara nga BQK

Transaksionet	2017						2018					
	Bankë	Fonde pensioanle	IMF & IFJB	Sigurues	Ndërmjet. në sigurime	Gjithsej	Bankë	Fonde pensioanle	IMF & IFJB	Sigurues	Ndërmjet. në sigurime	Gjithsej
Aplikacionet	0	0	6	0	11	17	1	0	8	1	2	12
Aksionarët kryesor dhe ndryshime në kapital	1	0	1	3	1	6	1	0	0	1	0	2
Drejtorë dhe menaxherë të lartë	40	0	22	30	3	95	29	0	28	22	2	81
Auditori i jashtëm	10	1	24	16	7	58	10	3	28	18	10	69
Ndryshimet në aktin e themelimit dhe/apo statutit	4	0	4	4	2	14	5	0	5	1	2	13
Përvetësimet e interesit të kapitalit dhe transferimi i portofolit	0	0	0	1	0	1	0	0	0	0	0	0
Zgjerim i veprimtarive financiare	0	0	0	3	0	3	1	0	2	5	0	8
Hapja, zhvendosja dhe mbyllja e degëve dhe zyrave brenda dhe jashtë	44	0	46	86	6	182	46	0	109	60	9	224
Licencimi dhe regjistrimi i agjentëve/brokerëve	0	0	70	61	91	222	0	0	69	21	26	116
Tërheqja e licencimit/regjistrimit	0	0	96	0	1	97	0	0	76	16	13	105
Tjetër	40	0	9	1	0	50	0	0	0	1	1	2
<b>Gjithsej</b>	<b>139</b>	<b>1</b>	<b>278</b>	<b>205</b>	<b>122</b>	<b>745</b>	<b>93</b>	<b>3</b>	<b>325</b>	<b>146</b>	<b>65</b>	<b>632</b>

Burimi: BQK (2019)

Në kuadër të këtyre 12 aplikacioneve për licencim/regjistrim, BQK-ja gjatë vitit 2018 ka marrë vendime për miratimin e transformimit të Bankës Kombëtare Tregtare – Dega Kosovë në subjekt të varur, regjistrimit të Leasing Alberti (me veprimtari të lizingut), Pro Finance Home (me veprimtari të kredidhënies), Hyseni SH.P.K., Këmbimore Lisi SH.P.K., dhe Naimi SH.P.K. (me veprimtari të këmbimit valutor), si institucione financiare jobankare. Tri aplikacione për institucione financiare jobankare dhe një aplikacion për regjistrim si kompani e agjentëve janë tërhequr nga procesi i licencimit/regjistrimit para vendimmarrjes finale të BQK-së. Në kuadër të aplikacioneve të shqyrtuara gjatë vitit 2018 hyjnë edhe kërkesat e Kompanisë së Sigurimeve Grawe dhe e Ndërmjetësuesit në Sigurime L.I.F.E Kosova për likuidim vullnetar.

Në procesin licencues, BQK-ja i ka kushtuar vëmendje të veçantë zbatimit të parimeve dhe rregullave bazë për qeverisje të përgjegjshme dhe efektive të bankave, duke vlerësuar strukturat e tyre organizative, menaxhimin, si dhe ndarjen e përgjegjësisë. Bazuar në rregullativën në fuqi, BQK-ja ka shqyrtuar (miratuar/refuzuar) kërkesat e bankave për 29 anëtarë të rinj të bordeve të drejtorëve, anëtarë (ekspertë) të jashtëm të Komitetit të auditimit, si dhe menaxherë të lartë. Në radhët e siguruesve, BQK-ja ka (miratuar/refuzuar) 22 anëtarë të bordit të drejtorëve dhe menaxherëve të lartë të siguruesve. Në të njëjtën kohë, BQK-ja ka shqyrtuar (miratuar/refuzuar) kërkesa të ngjashme edhe për institucionet mikrofinanciare, institucionet financiare jobankare dhe ndërmjetësuesit në sigurime. Gjatë kësaj periudhe janë miratuar 30 anëtarë të Bordit të drejtorëve dhe menaxherë të lartë të institucioneve mikrofinanciare, institucioneve financiare jobankare si dhe kompanive ndërmjetësuese në sigurime.

Në vitin 2018 janë miratuar edhe 2 kërkesa të ndryshimit të aksionarëve, si dhe 13 kërkesa për ndryshimin e statutit, 5 nga të cilat kanë qenë në radhët e bankave, 1 nga siguruesit si dhe 5 nga institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare, si dhe 2 nga kompanitë ndërmjetësuese në sigurime.

Shqyrtimi i kërkesave për licencim/regjistrim të agjentëve individual si ndërmjetësues në sigurime, si dhe agjentëve të IFJB-ve është paraqitur në transaksion individual për të evituar hutime të mundshme marrë parasysh numrin shumë të lartë të tyre. Siç edhe shihet në tabelën 12, gjatë vitit 2018 BQK-ja ka miratuar/refuzuar 116 kërkesa të tilla. Megjithatë, në krahasim me vitin paraprak kemi një rënie të theksuar të këtij lloji të kërkesës, kryesisht marrë parasysh faktin që nga gushti 2017, agjentët e brendshëm të siguruesve më nuk janë subjekt miratimi i BQK-së. Ngjashëm me licencimin dhe regjistrimin e agjentëve edhe tërheqja e licencimit regjistrimit të agjentëve është një kërkesë për miratim me frekuencë të lartë, që tregon për një volatilitet të rrjetit të sistemit financiar në raport me agjentët. Në këtë drejtim, ngjashëm sugjerojnë edhe të dhënat për miratim të hapjeve, zhvendosjeve dhe mbylljeve të degëve dhe zyrave të institucioneve



financiare në vend. Gjatë vitit 2018, janë shqyrtuar 224 kërkesa të tilla, kryesisht të bankave, IMF-ve dhe IFJB-ve që në tërësi paraqet një rënie të lehtë nga viti paraprak.

BQK-ja edhe gjatë vitit 2018, ka shqyrtuar kërkesat për miratimin e transaksioneve periodike që kërkojnë miratimin e BQK-së sipas kornizës ligjore dhe rregullore në fuqi si, miratimet e auditorëve të jashtëm për të gjitha llojet e institucioneve financiare.

## **4.2. Rregullimi**

### **4.2.1 Korniza rregullative e sistemit financiar**

BQK-ja ka ndërtuar një kornizë rregullative për licencimin, rregullimin dhe mbikëqyrjen e institucioneve financiare të bazuar në praktikat më të mira ndërkombëtare e mbështetur në vazhdimësi nga institucione të njohura ndërkombëtare, si Banka Botërore, Fondi Monetar Ndërkombëtar, USAID, Thesari Amerikan, KfW, GIZ, Banka Qendrore Evropiane, Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim dhe institucione të tjera ndërkombëtare. Korniza rregullative është hartuar në pajtueshmëri me direktivat evropiane që adresojnë rregullimin e institucioneve financiare, si standardet dhe praktikat më të mira ndërkombëtare për rregullimin dhe mbikëqyrjen e institucioneve financiare. Gjithashtu, BQK-ja ka filluar një proces gradual drejt përafrimit me parimet bazë për mbikëqyrjen e bankave të nxjerra nga BIS – Bank for International Settlements dhe parimet bazë për mbikëqyrjen e siguruesve të nxjerra nga IAIS – International Association for Insurance Supervision. Meqenëse direktivat, standardet ndërkombëtare dhe parimet e lartcekura lidhur me rregullimin e institucioneve financiare dhe fushën e veprimtarisë së tyre janë të karakterit dinamik, kjo ndikon që hartimi i kornizës juridike të jetë një proces i vazhdueshëm dhe kompleks pasi që kërkon plotësimin dhe ndryshimin e kornizës ekzistuese ligjore dhe rregullative, si dhe kërkon një qasje adekuate në mënyrë, që të studiohen me kujdes rrethanat specifike të Kosovës, për një adaptim adekuat të këtyre instrumenteve juridike ndërkombëtare për nevojat e sektorit financiar në Kosovë.

Gjatë përgatitjes së rregulloreve dhe çdo instrumenti rregullativ, BQK-ja bashkëpunon ngushtë me institucionet tjera dhe industrinë, përmes takimeve dhe komunikimit të vazhdueshëm me subjektet e rregulluara, kryesisht përmes shoqatave përkatëse, si Shoqatën e Bankave të Kosovës, Shoqatën e Sigurimeve, Shoqatën e Institucioneve Mikrofinanciare, por dhe me institucione tjera vendore në trajtimin e çështjeve që prekin edhe fusha tjera të ndërlidhura me sektorin financiar. Ky proces ka ndihmuar vazhdimisht në qartësimin e çështjeve specifike që adresohen me rregullore dhe rregullimin e drejtë të tyre, duke marrë parasysh ndikimin e tyre në stabilitetin e sistemit financiar në Kosovë dhe në zhvillimin ekonomik të vendit.

### **4.2.2 Korniza rregullative për banka**

Në funksion të zhvillimit të mëtejshëm të kornizës rregullative për rregullimin e bankave, gjatë vitit 2018 janë realizuar aktivitetet si në vijim.

#### **4.2.2.1 Ligji i ri për Banka**

Gjatë vitit 2018 BQK-ja ka hartuar draftin e Ligjit të ri për banka, i cili përfshin edhe komentet e pranuar nga Shoqata e Bankave mbi bazën e ligjit aktual. Ligji i ri është ristrukturuar në harmoni me Direktivat Evropiane, kornizën ligjore regionale si dhe standardet ndërkombëtare bankare. Draftimi i tij është përkrahur nga ekspertë ndërkombëtarë të fushës bankare të angazhuar në kuadër të Thesarit Amerikan si dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH). Ligji i ri pas shqyrtimit nga Bordi Ekzekutiv i BQK-së pritet që gjatë vitit 2019 të procedohet në Qeverinë e Republikës së Kosovës që më pas të procedohet në Kuvend të Republikës së Kosovës për shqyrtim dhe miratim.

#### 4.2.2.2 Rimëkëmbja, përmbyllja dhe likuidimi bankar

BQK-ja gjatë vitit 2018 gjithashtu ka hartuar kornizën ligjore dhe rregullative të procesit të rimëkëmbjes dhe përmbylljes (recovery and resolution) së bankave, i cili është bërë në tri nivelet legislative me mbështetjen e asistencës teknike të BERZH-it. Fillimisht, rregullimi është bërë në kuadër të Ligji të ri për banka përmes një kapitulli të veçantë që adreson pjesën e rimëkëmbjes, përmbylljes dhe likuidimit bankar. Me miratimin e Ligjit të ri për banka, gjatë vitit 2019 planifikohet të miratohen rregulloret në vijim të cilat janë duke u draftuar dhe që rrjedhin nga pjesa e re e draftuar në ligj, që rregullon procesin e rimëkëmbjes dhe likuidimit bankar të bazuar në Direktivën Evropiane. Këto rregullore do të definojnë se si do të zhvillohet ky proces, akterët kryesorë gjatë këtij procesi, kualifikimet e personave të caktuar si administratorë zyrtarë apo likuidatorëve dhe çdo proces tjetër të nevojshëm dhe të kërkuar në zbatim të Ligjit të ri të bankave. Janë gjithsej 12 rregullore të cilat janë paraparë si të nevojshme për të plotësuar kërkesat e reja të procesit të rimëkëmbjes dhe likuidimit bankar:

- Rregullore për kualifikimet e administratorëve zyrtarë;
- Rregullorja për metodat dhe kushtet e vlerësimit të mjeteve dhe detyrimeve të bankës (për qëllime të zbatimit të pjesës për rimëkëmbje dhe likuidim bankar të Ligjit të ri të bankave);
- Rregullore për planet e rimëkëmbjes;
- Rregullore për marrëveshjet e financimit brenda-grupit;
- Rregullorja për kushtet e emërimit, funksionet dhe përgjegjësitë e menaxherëve special (likuidatorëve);
- Rregullore për planet e përmbylljes (resolution) dhe procedurën e njoftimit;
- Rregullore për instrumentet e përmbylljes (resolution tools);
- Rregullore për shlyerjen dhe konvertimin e instrumenteve të kapitalit të bankave;
- Rregullore për masat mbrojtëse të marrëveshjeve gjatë përmbylljes (resolution);
- Rregullore për kërkesën minimale për kapital dhe detyrimeve të pranueshme (MREL),
- Rregullore për Fondin Nacional të Përmbylljes (Resolution);
- Rregullore për përmbylljen dhe mundësisë së zgjidhjes së përmbylljes dhe përmbyllshmërisë (resolution and resolvability) të grupeve dhe kompanive holding.

Me miratimin e kornizës ligjore sekondare do të miratohet edhe legjislacioni terciar, të cilin BQK-ja e ka në proces të zhvillimit me mbështetje të BERZH-it, e që ngërthen në vete manualin operacional të rimëkëmbjes, përmbylljes dhe likuidimit bankar, i cili rregullon procesin në nivel teknik dhe operacional duke transpozuar Direktivën e Bashkimit Evropian dhe rregulloret përkatëse, duke avancuar rregullimin bankar paralelisht me vendet e regjionit dhe vendet e zhvilluara evropiane.

#### 4.2.2.3 Përafrimi me Standardet e Bazelit

Me qëllim të përafrimit me Qasjen e Standardizuar të Shtyllës së parë dhe të dytë të Kornizës së Bazelit për Kapital dhe kërkesave rregullative të BE-së (Rregullores së BE-së nr. 575/2013 mbi kërkesat prudenciale për institucionet kredidhënëse dhe shoqëritë investuese dhe Direktivës së BE-së nr. 2013/36/EU mbi qasjen në aktivitetin e institucioneve kredidhënëse dhe mbikëqyrjes prudenciale të institucioneve kredidhënëse dhe shoqërive investuese), më 29 nëntor 2018 janë miratuar nga Bordi i BQK-së, kurse do të hyjnë në fuqi nga data 1 janar 2020, rregulloret si në vijim:

- Rregullore për adekuatshmërinë e kapitalit të bankave;
- Rregullore për treguesit e leverazhit; dhe
- Rregullore mbi procesin e vlerësimit të brendshëm të mjaftueshmërisë së kapitalit.

Në zbatim të rregulloreve të lartpërmendura janë hartuar draftet e udhëzimeve dhe formave të raportimit, të cilat pritet të finalizohen dhe miratohen gjatë vitit 2019. Me qëllim të sqarimeve dhe bartjes së njohurive lidhur me këto rregullore është organizuar punëtori për stafin e BQK-së.

#### **4.2.2.4 Përafrimi me Standardin Ndërkombëtar të Raportimit Financiar (SNRF) 9 Instrumentet Financiare**

BQK-ja gjatë vitit 2018 ka hartuar kornizën rregullative, që përafuron kornizën e vendit me Standardin Ndërkombëtar të Raportimit Financiar (SNRF) 9 Instrumentet Financiare. E njëjta është në proces të miratimit dhe parashihet të hyjë në fuqi nga 1 janari i vitit 2020.

#### **4.2.2.5 Korniza rregullative për vlerësimin e pronave të paluajtshme**

BQK-ja edhe gjatë vitit 2018 ka vazhduar me projektin e rishikimit të kornizës rregullative për vlerësimin e pronave të paluajtshme, në funksion të përditësimit të kërkesave për të përmirësuar praktikën e vlerësimit të pronave të paluajtshme nga ana e institucioneve financiare në përputhje me standardet e reja të Evropës (European Valuation Standards - EVS 2016). Ky projekt është duke u zhvilluar me mbështetjen e këshilltarit nga Thesari Amerikan, ekspert me përvojë të gjatë në fushën e vlerësimit të pronave të paluajtshme për nevojat e bankave. Në kuadër të këtij projekti, është duke u amandamentuar Rregullorja për vlerësimin e pronave të paluajtshme, e cila pritet të miratohet nga Bordi i BQK-së gjatë vitit 2019.

#### **4.2.2.6 Rregullorja për faktoring**

Me qëllim të rregullimit të aktivitetit financiar të faktoringut, grupi punues i BQK-së, me mbështetje të ekspertëve të angazhuar nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), ka hartuar Rregulloren për Faktoring, e cila është miratuar nga Bordi i BQK-së më datë 29 tetor 2018.

#### **4.2.2.7 Udhëzimi mbi formularin e informatave për kreditë konsumuese**

Në zbatim të obligimit që rrjedh nga nenet 85 dhe 86 të Ligjit për Mbrojtjen e Konsumatorit, është hartuar udhëzimi të cilit i janë bashkëngjitur shtojca dhe Formulari i Fakteve Kyçe dhe Informacioni për Garantuesin. Ky udhëzim bashkë me shtojcat janë proceduar për miratim te organet vendimmarrëse të BQK-së.

### **4.3. Korniza rregullative për institucione mikrofinanciare dhe institucione financiare jobankare**

Në funksion të zhvillimit të mëtejshëm të kornizës rregullative për rregullimin e institucioneve mikrofinanciare si dhe institucioneve financiare jo-bankare gjatë vitit 2018 janë realizuar plotësimet si në vijim.

#### **4.3.1 Ligji për IMF dhe IFJB**

Gjatë vitit 2018 BQK-ja gjithashtu ka hartuar draftin e Ligjit të ri për IMF dhe IFJB, i cili është punuar në kuadër të një grupi punues ndër-institucional dhe përfshin edhe komentet e pranuar nga industria. Ligji i ri është miratuar nga Qeveria gjatë vitit 2018 dhe më pas është proceduar në

Kuvendin e Republikës së Kosovës për miratim, ku edhe ka kaluar leximin e parë. I njëjti pritët të miratohet nga Kuvendi i Republikës së Kosovës gjatë vitit 2019.

#### **4.3.2 Rregulloret e miratuara për IMF dhe IFJB**

Në funksion të avancimit të kuadrit rregullativ të IMF-ve dhe IFJB-ve, janë hartuar dhe finalizuar/ miratuar Rregulloret për IFJB-të si në vijim:

- Rregullore për menaxhimin e rrezikut kreditor;
- Rregullore për auditimin e jashtëm;
- Rregullore për auditimin e brendshëm dhe kontrollet e brendshme;
- Rregullore për normën efektive të interesit dhe kërkesat për shpalosje.

#### **4.3.3 Rregullore për menaxhimin e rrezikut kreditor për IFJB**

BQK-ja gjatë vitit 2018 ka draftuar Rregulloren për menaxhimin e rrezikut kreditor për IFJB, e cila përcakton vendosjen dhe zbatimin e detyrueshëm të standardeve minimale dhe kërkesave për menaxhimin e rrezikut kreditor në institucionet financiare jobankare me aktivitet kredidhënës dhe/apo lizing financiar duke përfshirë vendosjen e standardeve minimale për vlerësimin e rrezikut kreditor dhe sistemin e klasifikimit për të gjitha ekspozimet kreditore, si dhe minimumin e kërkesave për provizionim. E njëjta pritët të miratohet nga Bordi i BQK-së brenda vitit 2019.

#### **4.3.4 Rregullore për normën efektive të interesit dhe kërkesat për shpalosje për IFJB**

Gjatë vitit 2018 është draftuar Rregullorja për normën efektive të interesit dhe kërkesat për shpalosje për IFJB, e cila përcakton metodologjinë e unifikuar për llogaritjen dhe shpalosjen e normës efektive të interesit për kreditë e dhëna dhe kërkesat minimale për shpalosjen e informatave të plota dhe të sakta, rreth produkteve dhe shërbimeve të institucioneve financiare jobankare. E njëjta pritët të miratohet nga Bordi i BQK-së brenda vitit 2019.

#### **4.3.5 Korniza rregullative për licencimin, rregullimin dhe mbikëqyrjen e institucioneve të parasë elektronike dhe operatorëve të sistemeve të pagesave**

Me qëllim të përafrimit të kornizës ligjore rregulluese të BQK-së me atë të Bashkimit Evropian, është rishikuar rregullorja aktuale për regjistrimin, mbikëqyrjen dhe veprimtaritë e institucioneve financiare jobankare, si dhe është hartuar rregullorja për licencimin e operatorëve të sistemeve të pagesave, rregullorja për veprimtarinë e lëshimit të parasë elektronike si dhe rregullorja për agjentë, të cilat janë vlerësuar si të nevojshme për të avancuar kornizën rregulluese për institucionet e parasë elektronike dhe operatorëve të sistemit të pagesave. Këto katër rregullore planifikohen të miratohen nga Bordi i BQK-së brenda vitit 2019.

- Rregullore për agjentët e ofruesve të shërbimit të pagesave dhe parasë elektronike;
- Rregullore për lëshimin dhe përdorimin e parasë elektronike;
- Rregullore për licencimin, rregullimin dhe mbikëqyrjen e operatorëve të sistemit të pagesave;
- Rregullore për regjistrimin e institucioneve financiare jobankare.

#### **4.4. Korniza rregullative për sigurues dhe ndërmjetësues në sigurime**

Në funksion të zhvillimit të mëtejshëm të kornizës rregullative për rregullimin e siguruesve dhe ndërmjetësuesve në sigurime gjatë vitit 2018 janë realizuar plotësimet si në vijim.

#### **4.4.1 Ligji për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia**

Gjatë vitit 2018 BQK-ja është angazhuar përmes grupeve punuese, lidhur me plotësimet dhe ndryshimet e Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia duke përfshirë edhe komentet e Shoqatës së Sigurimeve. Drafti i Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia i amendamentuar pas shqyrtimit nga Bordi Ekzekutiv i BQK-së gjatë vitit 2019, pritet të procedohet në Qeverinë e Republikës së Kosovës dhe Kuvend të Republikës së Kosovës për shqyrtim dhe miratim.

#### **4.4.2 Rregullore për licencimin e trajtuesve të dëmeve në sigurime**

BQK-ja gjatë vitit 2018 ka draftuar dhe miratuar Rregulloren për Licencimin e Trajtuesve të Dëmeve në Sigurime, e cila përcakton kushtet, kërkesat, procedurat dhe afatet që duhet ndjekur për aplikimin dhe dhënien e licencës trajtuesve të dëmeve në sigurime bazuar në Ligjin nr. 05/L-045 për Sigurimet.

#### **4.4.3 Rregullore për dënimet me gjobë për siguresit, ndërmjetësuesit në sigurime dhe trajtuesit e dëmeve në sigurime**

BQK-ja gjatë vitit 2018 ka draftuar Rregulloren për dënimet me gjobë për siguresit, ndërmjetësuesit në sigurime dhe trajtuesit e dëmeve në sigurime, e cila do ta zbatojë nenin 125 të Ligjit për Sigurimet me qëllim të përcaktimit të dënimeve me gjobë, që mund të shqiptohen nga BQK-ja, në rastet kur institucionet dhe/ose individët që i përfaqësojnë, nuk kanë respektuar kërkesat e Ligjit për Sigurimet dhe/ose aktet nënligjore në zbatim të tij. E njëjta rregullore planifikohet të miratohet nga Bordi i BQK-së brenda vitit 2019.

#### **4.4.4 Udhëzimi për shitjen e produkteve të sigurimeve**

BQK-ja ka draftuar Udhëzimin për Shitjen e Produkteve të Sigurimeve, i cili përcakton statusin e punonjësve të siguresve që merren me shitjen e produkteve të sigurimeve dhe kriteret minimale për angazhimin e tyre, si dhe është përcaktuar mënyra e shitjes së produkteve të sigurimeve. Nevoja për ta nxjerrë këtë udhëzim rrjedh për shkak të ndryshimeve të Rregullativës për licencimin e ndërmjetësuesve në sigurime; të zëvendësimit të Urdhëresës nr.016/2016 e datës 27 qershor 2006, të cilën e ka lëshuar Autoriteti Bankar dhe i Pagesave (paraardhëse e BQK-së) si dhe nevojës për rregullimin e mënyrës së shitjes së sigurimit të detyrueshëm nga autopërgjegjësia. I njëjti pritet të miratohet nga Bordi Ekzekutiv i BQK-së brenda vitit 2019.

#### **4.4.5 Udhëzimi për klasifikimin e llojeve të rrezikut në grupet dhe klasat e veprimtarive të sigurimit**

BQK-ja gjatë vitit 2018 ka filluar hartimin e Udhëzimit i cili rregullon klasifikimin e llojeve të rrezikut në grupet dhe klasat e veprimtarive të sigurimit duke përfshirë grupet e veprimtarive të sigurimit, nëngrupet e veprimtarive të sigurimit, klasat e sigurimit brenda grupeve të veprimtarive të sigurimit, si dhe llojet e rreziqeve brenda klasave të sigurimit. Nevoja për ta nxjerrë këtë udhëzim ka rrjedh për shkak të kërkesave të shumta nga siguresit për sqarime rreth produkteve të ndryshme dhe cilave klasa që i përkasin. I njëjti pritet të finalizohet gjatë vitit 2019.

#### **4.4.6 Rregullore për qeverisjen korporative të siguresve**

BQK-ja gjatë vitit 2018 ka filluar hartimin e Rregullores për qeverisje korporative të siguresve bazuar në parimet e përcaktuara në Principet Bazë të Sigurimeve, të cilat lëshohen nga Shoqata Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve të Sigurimeve me qëllim të përafrimit të kornizës rregulluese të

BQK-së me kornizën ligjore evropiane dhe praktikat e standardet më të mira ndërkombëtare. Kjo rregullore planifikohet të miratohet gjatë vitit 2019.

#### **4.5. Korniza rregullative për fonde pensionale**

Në funksion të zhvillimit të mëtejshëm të kornizës rregullative për rregullimin e fondeve pensionale gjatë vitit 2018 janë hartuar dhe miratuar nga BQK-ja rregulloret si në vijim:

- Rregullore për themelimin e pensionit plotësues individual nga ofruesit e pensioneve;
- Rregullore mbi financimin dhe vlerësimin aktuarial të pensioneve me shuma të caktuara;
- Rregullore për menaxhuesit e mjeteve të pensioneve;
- Rregullore për themelimin e Fondit Plotësues Pensional të Punëdhënësit;

## 5. Mbikëqyrja e sistemit financiar

Në funksion të pasqyrimin të aktivitetit të saj në fushën e mbikëqyrjes financiare, konform kërkesave që dalin nga legjislacioni primar dhe sekondar përkatës, në vazhdim është paraqitur aktiviteti i mbikëqyrjes financiare sipas natyrës së institucioneve financiare.

### Sektori bankar

Gjatë vitit 2018 BQK-ja ka zhvilluar aktivitetin e ekzaminimeve të fokusuar në vend të bankave, në veçanti lidhur me përcjelljen e përmbushjes së rekomandimeve nga ekzaminimet paraprake dhe menaxhimin e rreziqeve nga ana e bankave. Gjatë vitit 2018 është kryer edhe një ekzaminim i plotë, duke u bazuar në qasjen e aplikuar sipas Manualit të mbikëqyrjes së bazuar në rrezik për banka. Gjithsej janë kryer njëmbëdhjetë ekzaminime të bankave të cilat janë përcjellë me rekomandimet përkatëse të shpalosura në raportet e ekzaminimeve.

**Tabela 13. Numri i ekzaminimeve në banka**

Institucionet	Lloji i Ekzaminimit
Banka	1 ekzaminim i plotë 10 ekzaminime të fokusuar

Burimi: BQK (2019)

Raportet e ekzaminimeve të plota janë përgatitur sipas llojit të rreziqeve bankare si: rreziku i likuiditetit, rreziku kreditor, rreziku i tregut dhe rreziku operacional, ndërsa ekzaminimet e fokusuar kanë pasur për qëllim vlerësimin e përmbushjes së rekomandimeve nga ekzaminimet paraprake lidhur me verifikimin e arsyeshmërisë së përcaktimit të tarifave për produktet dhe shërbimet bankare të cilat sjellin të hyra jokamatore. Ekzaminimi i bankave nga ana e BQK-së bëhet konform Manualit të mbikëqyrjes së bazuar në rrezik për banka.

Sektori i institucioneve mikrofinanciare dhe institucioneve financiare jobankare është karakterizuar me një rritje të vazhdueshme përgjatë vitit 2018, me ç' rast kanë përfunduar tetë ekzaminime në këtë sektor, respektivisht janë ekzaminuar katër institucione mikrofinanciare dhe katër institucione financiare jobankare.

**Tabela 14. Numri i ekzaminimeve në IMF dhe IFJB**

Institucionet	Lloji i Ekzaminimit
IMF dhe IFJB	7 ekzaminime të plota 1 ekzaminim i fokusuar

Burimi: BQK (2019)

Në funksion të të qenit proaktiv në procesin mbikëqyrës edhe gjatë vitit 2018 nga bankat, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare me aktivitet të kredidhënies janë kërkuar planet strategjike dhe projeksionet financiare për periudhën 2019 – 2021, me qëllim të vlerësimit të këtyre planeve të biznesit, si dhe pritjet mbi zhvillimet në sektorin bankar, institucioneve mikrofinanciare dhe institucioneve financiare jobankare gjatë kësaj përdudhe. Strategjitë do të monitorohen dhe analizohen vazhdimisht me qëllim të identifikimit të devijimeve të mundshme dhe matjes së profilit të rrezikut.

Përveç ekzaminimeve dhe përgatitjes së raporteve periodike dhe analizave financiare, gjatë vitit 2018, në këtë fushë janë kryer edhe aktivitete të tjera për hartimin dhe amendamentimin e ligjeve



dhe rregulloreve, shqyrtimin e kërkesave për ekspozimet e mëdha, pagesës së dividendës dhe kërkesa tjera të bankave.

Bazuar në ekzaminimet e kryera dhe natyrën e rekomandimeve, gjatë vitit 2018 një pjesë e rekomandimeve të bankat është monitoruar nga BQK-ja përmes analizave, përderisa pjesa tjetër përmes ekzaminimeve të plota dhe të fokusuara.

Me qëllim të bashkëpunimit më të afërt me sektorin bankar, BQK-ja ka zhvilluar dialogun mbikëqyrës me banka. Ky aktivitet ka vazhduar edhe gjatë vitit 2018 përmes takimeve të mbajtura si për fusha specifike e po ashtu edhe për ato më të përgjithshme. Bankat janë rekomanduar dhe udhëzuar që për çdo paqartësi rregullative apo të ngjashme të njoftojnë rregullatorin në funksion të një qasje proaktive në drejtim të mbajtjes së stabilitetit të sektorit bankar.

Në funksion të avancimit të mëtutjeshëm të qasjes së mbikëqyrjes së bazuar në rrezik për bankat, BQK-ja është angazhuar edhe për hartimin/adoptimin e manualit për mbikëqyrjen e bankave nga jashtë. Qëllimi i këtij Manuali është që të sigurojë informacion dhe udhëzime për mbikëqyrësit nga jashtë të bankave dhe të detajojë rrjedhën e punës ndërmjet funksioneve të ekzaminimit në vend (anglisht: *On-site*) dhe ekzaminimit nga jashtë (anglisht: *Off-site*).

### Sektori i sigurimeve

Gjithashtu, BQK-ja ka vazhduar aktivitetin e saj në zbatim të realizimit të ekzaminimeve dhe detyrave dhe përgjegjësisve tjera në funksion të një mbikëqyrje prudente edhe për sektorin e sigurimeve. Rrjedhimisht janë realizuar ekzaminime të plota dhe të fokusuara, si dhe ekzaminime ad-hoc për siguresit dhe subjektet tjera të cilat operojnë në tregun e sigurimeve. Qëllim i ekzaminimeve është vlerësimi i gjendjes së përgjithshme të institucioneve përkatëse në raport me pajtueshmërinë me ligjet dhe rregulloret e BQK-së, në funksion të mbrojtjes së policëmbajtësve dhe ruajtjes së stabilitetit financiar të institucioneve.

Klasifikimi i siguresve për të qenë subjekt i ekzaminimeve është bazuar në disa faktorë, duke filluar nga analizat e treguesve financiarë nga raportimet e rregullta në BQK, opinionit të pasqyrave financiare nga auditori i jashtëm, periudhave paraprake të ekzaminimeve të realizuara, ankesave të policëmbajtësve në BQK, si dhe faktorë tjerë relevant. Kjo ka ndikuar në aplikimin e qasjes selektive në prioritizimin e institucioneve më me rrezik për të qenë subjekt i ekzaminimeve të radhës nga BQK-ja dhe si rrjedhojë në ngritjen e nivelit të mbikëqyrjes efektive.

**Tabela 15. Numri i ekzaminimeve të sektorit të sigurimeve**

Institucionet	Lloji i Ekzaminimit
Siguresit	9 ekzaminime të plota
	3 ekzaminime të fokusuara

Burimi: BQK (2019)

Në të njëjtë kohë përpos mbikëqyrjes në vend, BQK-ja kryen aktivitetin e mbikëqyrjes edhe përmes sistemit të monitorimit dhe analizimit të raporteve financiare, si dhe të dhënave tjera të raportuara nga siguresit dhe ndërmjetësuesit e sigurimeve.

Sistemi online i raportimit në BQK, mundëson pranimin e informacioneve të detajuara për tërë sektorin e sigurimeve. Të dhënat e pranuar nga siguresit mundësojnë avancimin e mbikëqyrjes efektive dhe në identifikimin e indikatorëve të paralajmërimit të hershëm për siguresit.



## Fondet pensionale

Sa i përket mbikëqyrjes së fondeve pensionale, gjatë vitit 2018 janë realizuar dy ekzaminime të plota, me qëllim të vlerësimit të gjendjes së përgjithshme të fondeve pensionale për vitin financiar 2017, duke vlerësuar pajtueshmërinë me ligjet relevante dhe rregulloret e BQK-së, efektshmërinë e funksionimit të kontrolleve të brendshme, zbatimin e rekomandimeve të ngritura në raportet e ekzaminimit të BQK-së, me qëllim të mbrojtjes së mjeteve pensionale të kursyera nga kontribuuesit dhe ruajtjes së stabilitetit financiar të fondeve.

Gjithashtu, gjatë këtij viti është hartuar edhe Manuali për mbikëqyrjen e pensioneve në vend, i cili shërben si udhërrëfyes/kornizë për monitorimin, vlerësimin e fondeve pensionale duke reflektuar në ngritjen e efektivitetit të mbikëqyrjes së fondeve pensionale. Ky Manual promovon aplikimin e qasjes së bazuar në rrezik nëpërmjet identifikimit, vlerësimit dhe shqyrtimit të rreziqeve potenciale me të cilat ballafaqohen fondet pensionale. Në të njëjtën kohë është hartuar dhe aprovuar edhe manuali për raportim të fondeve pensionale.

**Tabela 16. Numri i ekzaminimeve**

Institucionet	Lloji i Ekzaminimit
Fondet pensionale	2 ekzaminime të plota

Burimi: BQK (2019)

## Parandalimi i pastrimit të parasë

Sa i përket fushës së parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, pas aprovimit të ligjit dhe rregullores që kanë të bëjnë me këtë fushë, me qëllim të zbatimit sa më efektiv të tyre në praktikë, është vlerësuar e nevojshme nxjerrja e akteve udhëzuese. Në vazhden e kësaj, BQK-ja gjatë vitit 2018, ka hartuar plotësim ndryshimin e rregullores për parandalimin e pastrimit të parave dhe udhëzimin për formularin e prejardhjes së fondeve.

Me qëllim të fuqizimit të bashkëpunimit dhe rritjes së kujdesit për sektorin financiar janë zhvilluar takime të nevojshme me komitetin për pajtueshmëri brenda Shoqatës së Bankave, në të cilat takime janë shqyrtuar kërkesat lidhur me kornizën ligjore dhe operacionale të fushës.

Për shkak se janë shfaqur forma të reja të produkteve dhe shërbimeve të lidhura me avancimet e teknologjisë informative, si sfida në vitin 2018 ishte edhe adresimi i rreziqeve për pastrim të parave dhe financim të terrorizmit nga operimi i formave tjera të transaksioneve të lidhura me inovacionet tekniko-teknologjike. Në këtë kuptim, është intensifikuar komunikimi me sektorë brenda institucionit dhe rritja e monitorimeve në aktivitetet gjatë ekzaminimeve të bankave dhe institucioneve financiare dhe komunikimin me institucionet tjera të zbatimit të ligjit.

**Tabela 17. Numri i ekzaminimeve**

Institucionet	Lloji i Ekzaminimit
Banka, Sigurues, IMF dhe IFJB	3 ekzaminime të plota 10 ekzaminime të fokusuara

Burimi: BQK (2019)

## Ankesat e shfrytëzuesve të shërbimeve financiare

Gjatë vitit 2018 janë pranuar, sistemuar dhe shqyrtuar ankesat e shfrytëzuesve të shërbimeve financiare në pajtueshmëri me rregulloren përkatëse. Është raportuar lidhur me aktivitetet për

trajtimin e ankesave të shfrytëzuesve të shërbimeve financiare në baza tremujore. Po ashtu janë mbajtur takime me zyrtarët e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë (MTI), ku është punuar në Projektligjin për Mbrojtjen e Konsumatorit, pasi që edhe BQK-ja ka qenë pjesë e grupit punues.

Gjatë vitit 2018, BQK-ja ka shqyrtuar 927 ankesa të shfrytëzuesve të shërbimeve financiare (persona fizikë e juridikë).

Gjithsej ankesat për banka komerciale, institucione mikrofinanciare (IMF), institucione financiare jobankare (IFJB) dhe fonde pensionale të adresuara në BQK për vitin 2018 kanë qenë 532, ndërsa ankesat më të shpeshta kanë qenë për çështje të ndryshme që ndërlidhen me kredi (si p.sh. kategorizimi në regjistrin e kredive, parapagimi i kredive, etj.), çështje që ndërlidhen me llogari (si p.sh. bllokimi i llogarisë), si dhe një pjesë e ankesave kanë qenë mbi rritjen e tarifave/provizioneve bankare.

Gjithsej ankesat ndaj kompanive të sigurimeve të adresuara në BQK për vitin 2018 kanë qenë 395. Ankesat më të shpeshta kanë të bëjnë me moskompensim të dëmit material dhe jomaterial nga sigurimi i autopërgjegjësive TPL, mosrespektimi i afateve kohore për pagesë nga marrëveshjet jashtëgjyqësore si dhe moskompensimin e shpenzimeve mjekësore nga sigurimi shëndetësor.

**Tabela 18. Numri i ankesave sipas institucioneve**

Industria financiare	Numri i ankesave sipas viteve			
	2018	2017	2016	2015
Bankat komerciale/IMF, IFJB, fonde pensionale	532	335	252	221
Kompanitë e sigurimeve	395	267	283	221
Total	927	602	535	442

Burimi: BQK (2019)

Në tabelën e mësipërme është i paraqitur numri i ankesave të shqyrtuara nga Divizioni i ankesave të shfrytëzuesve të shërbimeve financiare nëpër vite.

Në vitin 2018 krahasuar me vitin 2017, kemi rritje të konsiderueshme të numrit të ankesave të trajtuara apo 54.0 përqind. Ankesat ndaj bankave komerciale, IMF-ve, IFJB-ve e fondeve pensionale kanë shënuar rritje prej 59.0 përqind në vitin 2018 krahasuar me vitin 2017, ndërsa ankesat ndaj kompanive të sigurimeve kanë shënuar rritje prej 48.0 përqind.

**Tabela 19. Numri i ankesave sipas institucioneve**

Industria financiare	Numri i ankesave	Të zgjidhura në favor të shfrytëzuesve të shërbimeve financiare	Të zgjidhura në favor të institucioneve financiare	Në proces
Bankat komerciale/IMF, IFJB, fonde pensionale	532	41.77%	69.13%	50.00%
Kompanitë e sigurimeve	395	58.23%	30.87%	50.00%
Totali i ankesave	927	42.61%	56.96%	0.43%

Burimi: BQK (2019)


## 6. Shërbimet e siguruar për autoritetet, komunitetin financiar dhe publikun

### 6.1. Operacionet dhe menaxhimi i parave të gatshme

Banka Qendrore e Kosovës (BQK) në kuadër të kompetencave të saj siguron një furnizim të rregullt dhe të duhur të ekonomisë vendore me kartëmonedha dhe monedha euro. Këtë funksion BQK-ja e kryen në mënyrë indirekte përmes sektorit bankar, i cili është drejtpërdrejt i lidhur me bizneset dhe qytetarët. Edhe gjatë vitit 2018 sikurse edhe në vitet paraprake përgjegjësitë e BQK-së lidhur me operacionet dhe menaxhimin e parave të gatshme kishin të bënin me valutën euro, e cila është valuta zyrtare në Republikën e Kosovës.


Funksioni i BQK-së për furnizimin e vendit me sasi dhe cilësi të duhur të kartëmonedhave dhe monedhave euro për shlyerjen e transaksioneve me para të gatshme, ashtu sikur në vitet e mëparshme edhe gjatë vitit 2018 është përbushur në mënyrë të suksesshme.

Figura 51. Furnizimi me para të gatshme (Mera)



Burimi: BQK (2019)

Figura 52. Pranimi i parave të gatshme (Mera)



Burimi: BQK (2019)


Vlera e përgjithshme e furnizimit me para të gatshme në vitin 2018, shënoi një rritje prej 27.6 përqind krahasuar me vitin 2017. Struktura e parave të gatshme të furnizuara sipas denominimeve, që në radhë të parë përcaktohet nga kërkesat e sektorit bankar, nuk patën ndonjë ndryshim të dukshëm nga viti 2017 në vitin 2018. Te kartëmonedhat euro vëllimet e kërkesave për furnizim gjatë vitit 2018 shënuan një rritje prej rreth 22.4 përqind krahasuar me vitin 2017 dhe vazhduan të dominojnë kërkesat për furnizime me denominimet – 5, 10, 20, 50 dhe 100 euro, ndërsa kërkesat për vëllimet e denominimeve prej 200 dhe 500 eurosh mbeten dukshëm më të ulëta. Gjatë vitit 2018 kërkesat për vëllimet e denominimeve në vlerë prej 50 eurosh patën rritje të konsiderueshme krahasuar me një vit më parë kurse kërkesa për vëllimet e denominimeve në vlerë prej 20 dhe 5 euro kishin një rënie të lehtë.

Siç është paraqitur në figurat e mëposhtme, gjatë vitit 2018, BQK-ja e furnizoi sektorin bankar me afër 13.17 milionë copë kartëmonedha euro (në vlerë prej afër 542.46 milionë euro) dhe me afër 6.79 milionë copë monedha euro (në vlerë prej mbi 1.6 milionë euro).

Vëllimet e kërkesave për furnizim me monedha gjatë vitit 2018 shënuan një rritje prej rreth 28.0 përqind krahasuar me vitin 2017. Kërkesa për furnizim me monedha euro, njëjtë sikurse gjatë vitit 2017, në vitin 2018 kryesisht u dominua nga monedhat me vlerë të vogël nga 1, 2 dhe 5 euro cent. Sa i përket strukturës, krahasuar me vitin paraprak kërkesat për denominimet prej 5, 2 dhe 1 euro cent kanë shënuar një rënie grupore prej 12.6 përqind, përderisa kërkesat për furnizim me denominimet prej 1 euro, 50, 20, 10 euro cent kanë shënuar rritje grupore prej 86.8 përqind që është një rritje e konsiderueshme në raport me vitin paraprak.


Vlera e përgjithshme e parave të gatshme të pranuar si depozita shënoi një rritje prej 19.7 përqind në vitin 2018 krahasuar me vitin paraprak. BQK-ja pranoi afër 22.26 milionë copë kartëmonedha (mesatarisht rreth 85,600 copë kartëmonedha në ditë) dhe afër 2.57 milionë copë monedha euro (mesatarisht rreth 9,900 copë monedha në ditë) si depozita në para të gatshme nga sektori bankar.

Figura 53. Furnizimi me kartëmonedha euro sipas denominimeve (numri i copëve)



Burimi: BQK (2019)

Figura 54. Furnizimi me monedha euro sipas denominimeve (numri i copëve)




Burimi: BQK (2019)

Të shprehura në vlerë, depozitat e parave të gatshme arritën përafërsisht shumat prej 1.19 miliardë kartëmonedha euro dhe 1.15 milionë monedha euro përkatësisht. Vëllimet e kartëmonedhave të pranuar gjatë vitit 2018 shënuan një rritje prej rreth 36.6 përqind krahasuar me vitin 2017 kurse vëllimet e depozitave të monedhave shënuan një rënie të lehtë prej rreth 0.6 përqind krahasuar me vitin 2017.


Struktura e kartëmonedhave euro të pranuar gjatë vitit 2018 siç shihet në grafikun e mëposhtëm nuk ka pasur ndonjë ndryshim të madh nga viti paraprak përderisa struktura e monedhave shënoi rritje te prerjet e monedhave prej 1 euro dhe 10 euro cent.

Figura 55. Pranimi i kartëmonedhave euro sipas denominimeve (numri i copëve)



Burimi: BQK (2019)

Figura 56. Pranimi i monedhave euro sipas denominimeve (numri i copëve)




Burimi: BQK (2019)

Ngjashëm me vitet e kaluara edhe gjatë vitit 2018, paratë e gatshme të pranuar ishin në një vlerë më të lartë sesa paratë e gatshme të furnizuara. Në fakt, duke arritur në rreth 645.43 milionë euro, ndryshimi i tillë neto<sup>13</sup> ishte në një masë më të lartë sesa në vitin e mëhershëm që ishte rreth 567.75 milionë euro. Kjo rritje ishte kryesisht si rezultat i rritjes së depozitimeve nga sektori bankar.

<sup>13</sup> Depozitat minus Tërheqjet e parave të gatshme


Meqë BQK-ja mban vetëm nivelin optimal të nevojshëm të parave të gatshme për kryerjen e operacioneve, tepriat dërgohen në Eurozonë, ku më pastaj përdoren për kryerjen e pagesave ndërkombëtare, si dhe përmes investimeve kthehen në mjete interes-prurëse. Neto dërgesat<sup>14</sup> jashtë vendit të parave të gatshme në vitin 2018 arritën shumën prej 547 milionë euro duke qenë më i lartë për 3.2 përqind se sa një vit më herët kur ishin 529.82 milionë euro. Kjo rritje neto e dërgesave në vitin 2018 erdhi si rrjedhojë e rritjes së depozitimeve nga sektori bankar. Ecuritë e eksporteve dhe importeve të parave të gatshme gjatë viteve të fundit janë të paraqitura në dy figurat në vijim.

Figura 57. Eksporti i parave të gatshme (vera)



Burimi: BQK (2019)

Figura 58. Importi i parave të gatshme (vera)




Burimi: BQK (2019)

Gjatë vitit 2018, të gjitha paratë e gatshme të pranuar nga bankat komerciale dhe institucionet e tjera u procesuan duke u kontrolluar për autenticitet dhe u klasifikuan sipas shkallës së përshtatshmërisë (afër 22.26 milionë copë kartëmonedha euro dhe 2.57 milionë copë monedha euro).


Rreth 8.25 milionë copë kartëmonedha euro (37.0 përqind e numrit të përgjithshëm kartëmonedhave euro të depozituara nga sektori bankar) gjatë vitit 2018 u klasifikuan si të papërshtatshme për riqarkullim (tejet të vjetërsuara/dëmtuara) dhe u hoqën nga qarkullimi duke u dërguar në bankat e Eurozonës. Një vëllim i këtillë i konsiderueshëm i kartëmonedhave euro të papërshtatshme të hequra nga qarkullimi kontribuoi në mënyrë të dukshme në përmirësimin e cilësisë së parave të gatshme në qarkullim në Republikën e Kosovës. Ngjashëm me vitet e kaluara, kartëmonedhat që më së shumti u klasifikuan si të papërshtatshme për riqarkullim, ishin ato të denominimeve 50, 20, 10 dhe 5 euro. Ato përbënin rreth 92.2 përqind të kartëmonedhave të papërshtatshme për riqarkullim për shkak të përdorimit më të shpeshtë nga qytetarët.

Figura 59. Kartëmonedha të papërshtatshme të tërhequra nga qarkullimi (numri i copëve)



Burimi: BQK (2019)

Figura 60. Kartëmonedha të papërshtatshme të tërhequra nga qarkullimi nga gjithsej të pranuar




Burimi: BQK (2019)

<sup>14</sup> Importet minus Eksportet e parave të gatshme


Cilësia e parave të gatshme në qarkullim u përmirësua gjithashtu përmes furnizimit të sektorit bankar me kartëmonedha euro plotësisht të reja, të cilat u sollën nga Eurozona. Gjatë vitit 2018, BQK-ja furnizoi sektorin bankar me më shumë se 3.70 milionë copë kartëmonedha të reja euro (28.12 për qind e të gjithë numrit të kartëmonedhave euro të furnizuara). Rreth 92.3 për qind e sasisë së kartëmonedhave të reja të furnizuara gjatë vitit 2018 ishin kartëmonedha të denominimeve me vlerë të ulët (20, 10 dhe 5 euro), me të cilat kryesisht u furnizuan bankat komerciale me qëllim të shlyerjes së transaksioneve me para të gatshme. Mandej edhe të gjitha kartëmonedhat e përshtatshme për riqarkullim euro me të cilat u furnizuan ishin të një cilësie të lartë (të përshtatshme për riqarkullim).

Figura 61. Kartëmonedha të reja të lëshuara në qarkullim (numri i copëve)



Burimi: BQK (2019)


Figura 62. Kartëmonedha të reja të lëshuara në qarkullim në raport me gjithsej të furnizuara



Burimi: BQK (2019)


Sikurse edhe në vitet paraprake edhe gjatë vitit 2018 BQK-ja vazhdoi të bashkëpunojë me autoritetet për avancimin e raportimit të parave të gatshme të dyshuara si false. BQK-ja së bashku me Laboratorin e Forenzikës publikuan në ueb<sup>15</sup> faqen e BQK-së statistikën mbi paratë e falsifikuara në nivel të Republikës së Kosovës. Më tutje, materiale edukative vazhduan të publikohen me qëllim të informimit të publikut të gjerë mbi tiparet e sigurisë së kartëmonedhave të serisë Europa.

Figura 63. Kartëmonedhat euro të falsifikuara të konfiskuara në qarkullim sipas viteve



Burimi: Agjencia e Kosovës për Forenzikë (2019)

Figura 64. Kartëmonedhat euro të falsifikuara të konfiskuara në qarkullim, sipas denominimeve



Burimi: Agjencia e Kosovës për Forenzikë (2019)

## 6.2. Mirëmbajtja dhe transaksionet e llogarive

BQK-ja ofron shërbime bankare për Qeverinë e Republikës së Kosovës, Agjencinë Kosovare të Privatizimit dhe institucione të tjera siç janë bankat dhe institucionet të tjera financiare, subjektet publike, bankat e huaja, bankat qendrore, institucionet financiare ndërkombëtare (Fondin Monetar Ndërkombëtar, Bankën Botërore), dhe organizatat ndërkombëtare, siç është specifikuar në nenin 9 të Ligjit nr. 03/L-209 të BQK-së.

<sup>15</sup> <http://bqk-kos.org/?id=31>

BQK-ja ka mbështetur avancimin e proceseve të kryerjes së transaksioneve. Edhe gjatë vitit 2018 sikurse në vitet paraprake, të gjitha pagesat ndërkombëtare u realizuan përmes rrjetit SWIFT kurse të gjitha pagesat vendore u realizuan përmes sistemit ATS, duke shkurtuar kështu kohën dhe duke rritur efektivitetin e procesimit.


**Tabela 20. Shuma e transaksioneve sipas llojeve kryesore të pagesave (në mijëra euro)**

Llojet e transaksioneve	2014	2015	2016	2017	2018
<b>Transaksionet me para te gatshme</b>	<b>+475,752</b>	<b>+476,310</b>	<b>+467,362</b>	<b>+563,570</b>	<b>+643,831</b>
Depozita ne para te gatshme	794,989	776,195	842,240	989,618	1,187,889
Terheqje te parave te gatshme	319,237	299,885	374,878	426,048	544,057
<b>Transferet vendor</b>	<b>+839,345</b>	<b>+942,520</b>	<b>+1,041,198</b>	<b>+1,131,645</b>	<b>+1,050,203</b>
Transferet vendor ardhesh	1,615,753	1,677,024	1,712,605	1,861,640	1,882,670
Transferet vendor dales	776,408	734,504	671,407	729,995	832,467
<b>Transferet nderkombetar</b>	<b>-714,099</b>	<b>-441,312</b>	<b>-580,656</b>	<b>-432,050</b>	<b>-642,864</b>
Transferet nderkombetar ardhesh	404,473	538,375	970,941	1,081,879	1,054,765
Transferet nderkombetar dales	1,118,572	979,687	1,551,597	1,513,929	1,697,629

Burimi: BQK (2019)


Përderisa pjesa më e madhe e operacioneve me para të gatshme të BQK-së në vitin 2018 u kryen në emër të dhe për llogari të bankave komerciale, pjesa më e madhe (798.44 milionë euro apo 97.14% e numrit) e pagesave vendore dalëse të BQK-së janë kryer në emër të dhe për llogari të Thesarit<sup>16</sup>.

**Figura 65. Vëllimi i transaksioneve vendore dalëse**



Burimi: BQK (2019)

**Figura 66. Vlera e transaksioneve vendore dalëse**




Burimi: BQK (2019)

BQK-ja gjatë vitit 2018 ka procesuar në emër të klientëve të saj mbi 321 mijë urdhërpagesa dalëse vendore (një zvogëlim prej 16.8 përqind krahasuar me vitin paraprak), dhe ka pranuar për llogari të tyre afër 84<sup>17</sup> mijë urdhërpagesa hyrëse (një zvogëlim prej 4.2 përqind krahasuar me vitin paraprak). Shprehur në vlerë, urdhërpagesat dalëse vendore arrinin shumën prej mbi 832.45 milionë euro (një rritje prej 14.0 përqind krahasuar me vitin paraprak) kurse urdhërpagesat hyrëse vendore arrinin shumën mbi 1.88 miliardë euro (një rritje e moderuar prej 1.1 përqind krahasuar me vitin paraprak). Numri dhe shuma më e madhe e transaksioneve vendore u krye nga BQK-ja me urdhër dhe për Thesarin.

<sup>16</sup> Thesari – Ministria e Financave


<sup>17</sup> Shumica e pagesave ardhese me implementimin e sistemit ATS pranohen nga BQK si të grupuara

Figura 67. Vëllimi i transaksioneve vendore hyrëse



Burimi: BQK (2019)


Figura 68. Vlera e transaksioneve vendore hyrëse



Burimi: BQK (2019)


Sa i përket pagesave vendore dalëse, duhet theksuar se të gjitha bankat komerciale i gjenerojnë vetë ato, kurse siguruesit numrin më të madh të pagesave të tyre e kryejnë nëpërmes bankave komerciale. Në të vërtetë të gjithë llogarimbajtësit e tjerë të BQK-së, i shfrytëzojnë shërbimet e pagesave të ofruara nga BQK-ja në mënyrë të kufizuar, pasi që të gjithë ata kanë llogari në banka komerciale. Sa u përket transaksioneve ndërkombëtare, numri më i madh i tyre u krye nga BQK-ja me urdhër të Thesarit. Në anën tjetër, duke marrë për bazë vlerën e tyre, pjesa më e madhe e transaksioneve ndërkombëtare të kryera nga BQK-ja kishte të bënte me transferet e fondeve të bankave komerciale. Të dhënat vjetore mbi transaksionet ndërkombëtare janë të paraqitura në katër figurat në vijim.

Figura 69. Vëllimi i transaksioneve nderkombëtare dalëse



Burimi: BQK (2019)

Figura 70. Vlera e transaksioneve nderkombëtare dalëse




Burimi: BQK (2019)

BQK-ja gjatë vitit 2018 ka procesuar në emër të klientëve të saj afër 2,800 urdhërpagesa dalëse ndërkombëtare (një rritje të moderuar prej 3.8 përqind krahasuar me vitin paraprak), dhe ka pranuar për llogari të tyre afër 852<sup>18</sup> urdhërpagesa hyrëse ndërkombëtare (një rritje prej 29.3 përqind krahasuar me vitin paraprak). Shprehur në vlerë, urdhërpagesat dalëse ndërkombëtare kapnin shumën prej mbi 1.70 miliardë euro (një rritje prej 12.4 përqind krahasuar me vitin paraprak) kurse urdhërpagesat hyrëse ndërkombëtare kapnin shumën mbi 1.05 miliardë euro (një rënie e moderuar prej 2.5 përqind krahasuar me vitin paraprak).

<sup>18</sup> Shumica e pagesave ardhese kanë të bëjnë me transferet e fondeve të bankave komerciale




Figura 71. Vëllimi i transaksioneve nderkombëtare hyrëse



Burimi: BQK (2019)

Figura 72. Vlera e transaksioneve nderkombëtare hyrëse



Burimi: BQK (2019)

Më 31 dhjetor 2018, depozitat e institucioneve të Qeverisë së Kosovës arritën shumë më prej 374.66 milionë euro ndërsa ato të AKP-së arritën shumë më prej 388.12 milionë euro. Së bashku, depozitat e institucioneve të Qeverisë së Kosovës dhe ato të AKP-së përbënin rreth 62.6 përqind të depozitave që u mbajtën në BQK në fund të vitit 2018.


Tabela 21. Niveli i depozitave të klientëve kryesor (në mijëra euro)

Gjendja e llogarive	2014	2015	2016	2017	2018
<b>Gjithsej gjendja</b>	<b>1,082,518</b>	<b>1,135,558</b>	<b>1,074,458</b>	<b>1,239,730</b>	<b>1,217,914</b>
Institucionet Qeveritare	155,481	248,780	257,393	339,906	374,663
Agjencia Kosovare e Privatizimit	557,801	486,819	460,961	471,299	388,116
Bankat Komerçiale + Kompanitë e Sigurimeve	321,670	320,934	301,051	336,732	347,931
Të tjera	47,566	79,025	55,053	91,793	107,205

Burimi: BQK (2019)

Në mesin e llogarimbajtësve të tjerë, bankat komerciale dhe siguruesit janë më të rëndësishmit sa i përket nivelit të depozitave në BQK. Depozitat e bankave komerciale dhe kompanive të sigurimeve që mbahen në BQK, kryesisht kanë të bëjnë me kërkesat dhe obligimet rregullatore dhe ligjore. Ato përbënin 28.57 përqind të depozitave që u mbajtën në BQK në fund të vitit 2018. Më 31 dhjetor 2018, depozitat e bankave komerciale dhe kompanive të sigurimit ishin në shumë më prej 347.93 milionë euro.

Figura 73. Evoluimi i depozitave të klientëve kryesorë të BQK-së



Burimi: BQK (2019)

### 6.3. Sistemi i Pagesave

Sistemi i pagesave gjatë vitit 2018 është karakterizuar me një dinamikë të zhvillimeve, si nga aspektet rregullative e po ashtu edhe në funksionet operacionale. Gjatë kësaj periudhe janë përmbushur synimet kryesore të vitit në përmirësimin e kuadrit rregullativ, duke u bazuar në standardet e aplikueshme ndërkombëtare. Në këtë drejtim në qershor të 2018, Bordi i BQK-së ka miratuar Rregulloren për sistemin e pagesave ndërbankare, e cila në masë të gjerë përcakton rregullat dhe procedurat për funksionimin e sistemit të Pagesave Ndërbankare. Rregullorja

përcakton organizimin, rregullimin, menaxhimin, operimin dhe mbikëqyrjen e sistemit të pagesave ndërbankare, si dhe në funksion të rritjes së transfereve elektronike kufizon aplikimin e tarifave për transferet hyrëse ndërbankare brenda vendit.

Zhvillime të rëndësishme gjatë kësaj periudhe janë shënuar edhe në infrastrukturën për raportimet mujore të statistikave të pagesave përmes avancimit të sistemit të raportimit elektronik.

Gjatë kësaj periudhe raportuese, sistemi i pagesave ndërbankare ka vazhduar të operojë me nivelin më të lartë të qëndrueshmërisë, sigurisë dhe efikasitetit, i cili ka mundësuar kliringun dhe shlyerjen me kohë të të gjitha transaksioneve të pagesave dhe letrave me vlerë. Gjithashtu, gjatë këtij viti janë kryer përgatitjet dhe është filluar me projektin për avancimin e ndërlidhjes së Ministrisë së Financave/Departamenti i Thesarit, si pjesëmarrës i drejtpërdrejtë në sistemin e pagesave ndërbankare.

Në kuadër të këtyre zhvillimeve bashkë me Ministrinë e Punëve të Brendshme/Policinë e Kosovës është punuar në përmirësimin e procesit lidhur me njoftimin automatik gjatë kryerjes së pagesave për gjobat e trafikut për shlyerjen me kohë dhe eliminimin e vështirësive në harmonizimin e të dhënave.

Viti 2018 është karakterizuar edhe me angazhimet për gjetjen e zgjidhjeve për përmirësimin e infrastrukturës së sistemeve të pagesave me vlera të vogla dhe sigurimin e instrumenteve të përshtatshme të këtyre llojeve të pagesave për qytetarët. Në këtë drejtim, me mbështetjen nga Banka Botërore është realizuar studimi i fizibilitetit financiar për krijimin e një qendre për procesimin e pagesave me kartela dhe formave tjera elektronike, brenda Kosovës. Në kuadër të këtij bashkëpunimi, janë realizuar takime të Këshillit Kombëtar të Pagesave dhe me kompani të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare, si dhe janë qartësuar qëndrimet e përbashkëta për nevojën e unifikimit të terminaleve të POS-ëve në mënyrë që të rritet efikasiteti i pagesave me anë të kartelave. Gjithashtu me mbështetje nga Banka Botërore është filluar projekti për studimin e kostos së pagesave me vlerë të vogël nga ana e ofertës dhe kërkesës, për të identifikuar faktorët kryesorë që ndikojnë në koston e pagesave me vlerë të vogël, me qëllim ndërtimin e një strategjie kombëtare për adresimin e këtyre faktorëve.


Gjatë vitit 2018 është vazhduar me avancimin e Regjistrit të Llogarive Bankare për të adaptuar kërkesat e reja që kanë dalë nga amandamentimi i Ligjit për Procedurën Përmbartimore. Bazuar në këto kërkesa, janë zgjeruar edhe funksionet e këtij regjistri ku aktualisht i gjithë procesi i zbatimit të vendimeve përmbartimore mundësohet të kryhet në mënyrë automatike përmes shkëmbimit të vendimeve përmbartimore ndërmjet organeve të përmbartimit dhe bankave në formë elektronike. Këto ndryshime kanë ngritur nevojën për rishikimin e Rregullores për Regjistrin e Llogarive Bankare për të adaptuar këto kërkesa të Ligjit për procedurën përmbartimore, si dhe nevojat nga institucionet e procedurës përmbartimore, e cila është në proces të rishikimit dhe pritet të finalizohet gjatë vitit 2019.

### **6.3.1 Operimi i Sistemit të Pagesave Ndërbankare**

Sistemi i pagesave ndërbankare (SPN) mundëson procesimin e një sërë instrumentesh të pagesave, kliringun ndërbankar, si dhe shlyerjen e letrave me vlerë. Figurat në vijim, paraqesin numrin dhe vlerën e transaksioneve të kryera përmes SPN-së për periudhat përkatëse.


Treguesit statistikorë të aktivitetit të SPN-së kanë reflektuar me një rënie të lehtë në vëllim dhe rritje në vlerë të transaksioneve të paraqitur si në vijim:

Figura 74. Numri i transaksioneve në SPN



Burimi: BQK (2019)


Figura 75. Vlera e transaksioneve në SPN



Burimi: BQK (2019)


Nga figurat 74 dhe 75 vërehet se gjatë vitit 2018 janë procesuar rreth 11.5 milionë transaksione me vlerë totale prej rreth 13 miliardë euro. Krahasuar me transaksionet e SPN-së në vitin paraprak, vëllimi i transaksioneve është zvogëluar për 2.0 përqind dhe vlera e transaksioneve është rritur për 11.3 përqind.

Figura 76. Mesatarja ditore e numrit të transaksioneve në SPN



Burimi: BQK (2019)


Figura 77. Mesatarja ditore e vlerës së transaksioneve në SPN



Burimi: BQK (2019)


Në kuadër të SPN-së realizohen pagesat përmes dy komponentëve RTGS (Real-Time Gross Settlement) dhe ACH (Automated Clearing House). Në komponentën RTGS realizohen në kohë reale të gjitha pagesat me vlerë mbi 10,000 €, si dhe të gjitha pagesat të urdhëruara me prioritet nga ana e klientëve, ndërsa në komponentin ACH realizohen të gjitha pagesat me vlerë nën 10 mijë euro dhe përfshijnë këto lloje të pagesave: pagesat e rregullta (individuale dhe masive), pagat dhe pensionet, pagesat Kos-Giro dhe Debitimi Direkt.

Figura 78. Vëllimi vjetor i transaksioneve të SPN-së sipas llojeve të tyre



Burimi: BQK (2019)

Figura 79. Vlera vjetore e transaksioneve të SPN-së sipas llojeve të tyre (në mijëra)



Burimi: BQK (2019)

Niveli i rritjes apo zvogëlimit si për nga vëllimi ashtu edhe vlera e këtyre kategorive të pagesave për vitet 2017 dhe 2018 është paraqitur në figurat si në vijim:

Pagesat e rregullta (individuale dhe masive) përbëjnë rreth 53.6 përqind të vëllimit dhe 17.0 përqind të vlerës së transaksioneve të SPN-së.


Transaksionet Kos-Giro përfaqësojnë një lloj të veçantë të transaksioneve të rregullta që po ashtu procesohen përmes sesioneve të kliringut dhe shlyhen në baza neto. Gjatë vitit 2018 numri i pagesave Kos-Giro është zvogëluar për 37.0 përqind, ndërsa vlera e tyre për 0.8 përqind.

Transaksionet RTGS, procesohen dhe shlyhen gjatë orarit të punës në kohë reale dhe në baza bruto. Gjatë vitit 2018 numri i tyre përbënte rreth 1.0 përqind të numrit të përgjithshëm të transaksioneve në SPN, ndërsa vlera e tyre rreth 36.6 përqind të vlerës së transaksioneve përmes SPN-së.

Debitimi Direkt si instrument i pagesës ende nuk është duke u përdorur në atë masë sa instrumentet tjera të pagesave. Derisa gjatë vitit 2017, ky lloj i transaksioneve përfaqësonte në total më pak se 1.0 përqind të vëllimit dhe vlerës së transaksioneve të SPN-së, në vitin 2018 ka një rënie më të theksuar ku përfaqëson vetëm 0.02 përqind të vëllimit dhe vlerës së transaksioneve të SPN-së.


Pasqyrimi i pagesave të procesuara përmes sistemit ACH gjatë vitit 2018 sipas sesioneve, tregon një përqendrim më të theksuar në sesionin e parë të kliringut, krahasuar me dy sesionet tjera. Shmangia e mbingarkesave në flukset e pagesave përgjatë sesionit të fundit të kliringut minimizon rreziqet shtesë në kuadër të funksionimit të sistemit të pagesave.

Figura 80. Numri i transaksioneve sipas sesioneve në SPN



Burimi: BQK (2019)

Figura 81. Vlera e transaksioneve sipas sesioneve në SPN



Burimi: BQK (2019)

Vlera e përgjithshme e transaksioneve të shlyera në SPN gjatë vitit 2018 ka qenë 13 miliardë euro, ku tri institucionet e para me vlerë më të madhe të transfereve të iniciuara zënë 62.5 përqind të vlerës së përgjithshme, ndërsa të gjitha institucionet tjera zënë 37.5 përqind. Sa i përket numrit të transfereve të iniciuara, nga numri i përgjithshëm i tyre prej 11 miliona euro, tri institucionet e para me numër më të madh të transfereve të iniciuara zënë 74.3 përqind të numrit të përgjithshëm, ndërsa të gjitha institucionet tjera zënë 25.8 përqind.

Një pasqyrë e detajuar e treguesve të përqendrimit të tri bankave më aktive në SPN gjatë vitit 2018, kundrejt totalit të aktivitetit në këtë sistem është paraqitur në tabelën si më poshtë (sipas indeksit HHI<sup>19</sup>):

<sup>19</sup> Klasifikimi i nivelit të përqendrimit përmes indeksit HHI duke iu referuar Departamentit të Drejtësisë të SHBA-së (1992) tregon një përqendrim të ulët për  $HHI < 0.10$ , një përqendrim të moderuar për  $0.10 \leq HHI \leq 0.18$  dhe një nivel të lartë përqendrimi për  $HHI > 0.18$ .

**Tabela 22. Treguesit e përqendrimit për transaksionet e iniciuara/dërguara në SPN**

Sistemi SPN	Vëllimi i transaksioneve	Vlera e transaksioneve
3 bankat më aktive (HII)	0.21	0.13
Gjithsej	11,449,552	12,946,178,685 €

Burimi: BQK (2019)

Niveli i lartë i përqendrimit sa i përket numrit të transaksioneve të dërguara në SPN ka të bëjë me dërgimin e transaksioneve të institucioneve financiare jobankare përmes bankave komerciale, e që kryesisht janë pagesa me vlerë të vogël andaj nuk kanë ndikuar në nivelin e përqendrimit të vlerës së transaksioneve sikurse te vëllimi i transaksioneve.

Në kuadër të funksioneve operacionale të BQK-së, rol të rëndësishëm zë edhe Regjistri i Llogarive Bankare. Regjistri i Llogarive bankare përfaqëson një infrastrukturë të bazës së të dhënave, e cila mundëson raportimin e të dhënave për llogaritë bankare nga ofruesit e të dhënave të llogarive (bankat komerciale); si dhe shfrytëzimin e këtyre të dhënave në funksion të zbatimit të vendimeve të prera të përmbartimit nga organet e përmbartimit dhe institucionet e tjera kompetente sipas dispozitave të Ligjit për procedurën përmbartimore.

Në Regjistrin e Llogarive Bankare gjatë vitit 2018 kanë pasur qasje 43 përmbartues privatë, 91 zyrtarë nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, si dhe 18 zyrtarë nga Administrata Tatimore e Kosovës, përmes të cilit i kanë shkëmbyer me bankat komerciale rreth 22 mijë vendime të procedurës përmbartimore. Në këtë regjistër janë raportuar të dhënat e mbi 1,590,000 subjekteve (personave fizikë dhe juridikë) rezidente dhe jorezidente.

### 6.3.2 Mbikëqyrja dhe analizat e sistemeve të pagesave

Në fushën e mbikëqyrjes dhe analizave të sistemeve të pagesave gjatë vitit 2018, janë zhvilluar procese që kanë ndikuar në përmirësimin e infrastrukturës teknike dhe të kuadrit rregullativ. Në tremujorin e parë është finalizuar dhe është vënë në funksion projekti për automatizimin e raportimeve të raporteve mujore për instrumentet e pagesave nga bankat komerciale. Sistemi i ri i raportimit mujor është i dizajnuar me një shkallë të lartë sigurie dhe mundëson procesimin e raporteve nga secila bankë komerciale në format të konsoliduar dhe sipas periudhave kohore për statistikat e pagesave, duke lehtësuar punën dhe njëkohësisht duke rritur efikasitetin dhe duke eliminuar gabimet e mundshme gjatë procesimit të të dhënave. Funksionalizimi i procesit për raportimet përmes platformës elektronike ka nxitur edhe zhvillime të tjera në fushën e raporteve dhe analizave, që ka rezultuar me rishikimin dhe standardizimin e raporteve mujore të destinuara për publikim.

Në dhjetor të vitit 2018 është miratuar Metodologjia për vlerësimin e sistemeve të pagesave me rëndësi sistemike, e cila është gjerësisht në pajtim me Metodologjinë e BQE-së për vlerësimin e sistemeve të pagesave të rëndësisë sistemike, si dhe me Parimet për Infrastrukturat e Tregut Financiar të hartuara nga Banka për Rregullimet Ndërkombëtare (BIS).

Bazuar në këtë metodologji do të përcaktohen sistemet e pagesave të rëndësisë sistemike dhe do të kryhet vlerësimi i tyre lidhur me pajtueshmërinë me parimet e përcaktuara sipas standardeve ndërkombëtare.

Gjatë vitit 2018 është rishikuar edhe analiza vjetore mbi përdorimin e kartelave në Kosovë, e cila është zgjeruar me tregues tjerë analitikë duke u standardizuar në një dokument më gjithëpërfshirës. Përveç informacioneve që kanë të bëjnë me shpërndarjen socio-demografike të kartelave të cilat përdoren nga qytetarët e Kosovës dhe faktorëve relevantë të cilët kanë ndikuar

në shpërndarjen e tillë të kartelave, dokumenti në masë të gjerë përfshin edhe informacionet lidhur me llojet e kartelave, përdorimin e kartelave “contact” dhe “contactless”, përdorimin e kartelave online, etj. Analiza vjetore mbi përdorimin e kartelave në Kosovë është publikuar në ueb-faqen zyrtare të BQK-së gjatë tremujorit të katërt.

Gjithashtu, në kuadër të zhvillimit të analizave tremujore mbi përdorimin e instrumenteve të pagesave në Kosovë është publikuar analiza për tremujorin e parë që pasqyron statistikën lidhur me procesin e SPN-së me theks të veçantë, numrin dhe vlerën e transaksioneve ndërbankare, numrin e llogarive bankare, numrin dhe funksionin e terminaleve ATM dhe POS, numrin e kartelave sipas funksionit dhe transaksionet me kartela.


Në baza të rregullta janë përgatitur dhe publikuar në ueb-faqen zyrtare të BQK-së raportet periodike:

- Raporti mujor mbi numrin dhe vlerën e pagesave të SPN-së;
- Raporti mujor mbi depozitat e bankave komerciale dhe rezervat;
- Raporti mujor mbi instrumentet me para të gatshme dhe jo me para të gatshme;
- Raporti vjetor mbi depozitat e bankave komerciale dhe rezervat;
- Raporti vjetor krahasues mbi instrumentet elektronike.

### 6.3.3 Instrumentet e pagesave dhe infrastruktura bankare për shërbime të pagesave


Raportimet e bankave për instrumente të pagesave tregojnë se deri në fund të dhjetorit të vitit 2018 numri i kartelave të debitit arriti në 1,011 mijëra ndërsa numri i kartelave të kreditit arriti në 173 mijë. Krahasuar me një vit më parë, konstatohet se numri i kartelave të debitit është rritur për 9.2 përqind, ndërsa numri i kartelave të kreditit është rritur për 5.3 përqind.

Figura 82. Numri i kartelave të debitit sipas llojit



Burimi: BQK (2019)

Figura 83. Numri i kartelave të kreditit sipas llojit




Burimi: BQK (2019)

Sa i përket infrastrukturës së terminaleve ATM (bankomate) dhe POS (pika të shitjes) të ofruara nga ana e bankave komerciale në Kosovë, shihet se ka pasur rritje të vazhdueshme të numrit të terminaleve POS (13,183), kurse terminalet ATM janë karakterizuar me një ulje të lehtë edhe gjatë këtij viti (491).


Krahas rritjes së numrit të terminaleve dhe instrumenteve të pagesave, nga të dhënat statistikore shihet se viti 2018 është karakterizuar edhe me rritje të përdorimit të instrumenteve elektronike të pagesave.

Figura 84. Numri i terminaleve ATM



Burimi: BQK (2019)


Figura 85. Numri i terminaleve POS



Burimi: BQK (2019)


Numri i pagesave të kryera përmes shërbimit e-banking arriti në 4.4 milionë transaksione që krahasuar me vitin paraprak paraqet rritje për 28.8 përqind, ndërsa vlera e tyre arriti në 9 miliardë euro, me rritje vjetore prej 6.5 përqind.

Figura 86. Vëllimi vjetor i transaksioneve të instrumenteve elektronike të pagesave



Burimi: BQK (2019)

Figura 87. Vlera vjetore e transaksioneve të instrumenteve elektronike të pagesave



Burimi: BQK (2019)

Viti 2018 po ashtu u karakterizua me një tendencë në rritje të përdorimit të instrumenteve elektronike të pagesave. Numri i pagesave në POS terminale është rritur për 43.2 përqind, ndërsa vlera e tyre është rritur për 51.0 përqind. Po ashtu edhe tërheqjet në ATM terminale janë karakterizuar me rritje. Numri i tërheqjeve në ATM gjatë vitit 2018 është rritur për rreth 10.0 përqind, ndërsa vlera e tërheqjeve është rritur për 23.8 përqind.

Nga raportimet e bankave rezulton se në fund të vitit 2018, numri i përgjithshëm i llogarive bankare të klientëve ishte rreth 2.05 milionë, që paraqet një rritje prej 4.4 përqind krahasuar me fundin e vitit 2017. Rreth 98.4 përqind e llogarive janë të rezidentëve, ndërsa rreth 1.6 përqind janë të jorezidentëve.

Nga totali i llogarive në fund të vitit 2018, rreth 250.7 mijë llogari kishin qasje “online” nga interneti për të kryer pagesa apo për të kontrolluar gjendjen e llogarisë, në përqindje rreth 15.0 përqind të llogarive.

Me hyrjen në fuqi të ‘Rregullores për raportimin e statistikave të instrumenteve të pagesave’ nga viti 2018 ka ndryshuar edhe metodologjia e raportimit të numrit të llogarive të qasshme (aksesueshme) nga interneti. Ky numër paraqet numrin e llogarive rrjedhëse që kanë qasje në e-banking, kurse sipas metodologjisë së mëhershme kanë qenë të raportuara të gjitha llogaritë, duke përfshirë llogaritë rrjedhëse, të kursimit dhe të afatizimit. Bazuar në të dhënat statistikore zhvillimi i infrastrukturës ka rezultuar me një ritëm më të shpejtë. Inkurajues mbetet trendi i shpejt i rritjes së përdorimit të instrumenteve elektronike të pagesave.



**Tabela 23. Numri i llogarive**

Përshkrimi i llogarisë	Totali i llogarive të klientëve			Të aksesueshme nga interneti		
	2016	2017	2018	2016	2017	2018
Llogaritë e klientëve (1+2)	1,875,091	1,967,755	2,054,799	230,905	301,841	250,733
1-Llogari të rezidentëve (a+b)(%)	98.5%	98.4%	98.4%	97.9%	98.2%	98.0%
a-Individuale (%)	92.9%	93.1%	93.0%	79.7%	82.5%	83.0%
b-afariste (%)	7.2%	6.9%	7.0%	20.3%	17.5%	17.1%
2-Llogari të jo-rezidentëve (c+d) (%)	1.6%	1.6%	1.6%	2.1%	1.8%	2.0%
c-Individuale (%)	97.0%	97.5%	98.7%	91.5%	91.8%	91.4%
d-afariste (%)	3.0%	2.5%	1.3%	8.5%	8.3%	8.6%

Burimi: BQK, Raportimet e bankave sipas "Rregullores për raportimin e statistikave të instrumenteve të pagesave"

Sa i përket krahasimit të Kosovës me vendet në rajon, shihet se trendi i shpejtë i zhvillimit gjatë viteve të fundit ka ndikuar, që sot Kosova të ketë përmirësuar pozitën e saj krahasuar me vendet fqinje.

**Tabela 24. Tabela krahasuese e instrumenteve dhe terminaleve të pagesave<sup>20</sup>**

Përshkrimi	Banorë	ATM për milion banorë	POS për milion banorë	Kredit Kartelat për milion banorë	Debit Kartelat për milion banorë	E-Banking për milion banorë
Kosova	1.79	286	6,425	92,034	517,435	168,626
Shqipëria	2.91	257	2,507	33,097	314,130	110,803
Republika Çeke	10.55	473	15,119	138,098	970,965	-
Turqia	80.42	620	20,604	776,593	1,636,327	-
Slovenia	2.07	795	16,747	60,134	1,255,930	-
Bullgaria	7.05	813	18,016	163,078	908,640	-
Hungaria	9.79	473	15,065	143,047	787,745	-
Bosnja	3.79	406	7,038	-	-	129,514
Mali i Zi	0.63	638	19,389	61,379	718,827	112,954
Kroacia	4.21	1,174	28,176	31,719	1,646,620	-
Maqedonia e Veriut	20.8	496	15,407	180,083	695,877	37,041

Burimi: BQK (2019) dhe bankat qendrore apo autoritetet mbikëqyrëse të shteteve përkatëse

#### 6.3.4. Projekti për studimin e koston së pagesave me vlerë të vogël

Në vitin 2018 BQK-ja me mbështetje të Bankës Botërore (nën financimin e SECO - State Secretariat for Economic Affairs) ka filluar Programin për Remitencat dhe Pagesat që synon rritjen e qasjes në dhe përdorimit të llogarive bankare, duke mundësuar edhe llogaritë për transaksione dhe zhvillimin e mëtejshëm të instrumenteve për pagesat elektronike, përmes përmirësimit të kushteve dhe rritjes së efikasitetit të pagesave lokale me vlerë të vogël, si dhe remitencave ndërkombëtare. Gjithashtu, përmes këtij programi synohet edhe fuqizimi i rolit të mbikëqyrjes së sistemeve të pagesave në vend, si dhe përgatitja e një strategjie kombëtare për avancimin e pagesave me vlerë të vogël në bashkëpunim me të gjithë pjesëmarrësit e ekosistemit të pagesave në Kosovë.

Gjatë vitit 2018 në kuadër të këtij programi, BQK-ja me mbështetjen e Bankës Botërore, ka filluar kryerjen e një studimi për vlerësimin e kostove të shërbimeve të pagesave me vlerë të vogël. Ky studim do të vlerësoj kostot nga ana e ofertës, që nënkupton kostot për ofruesit e infrastrukturës dhe shërbimeve të pagesave, gjithashtu edhe nga ana e kërkesës që nënkupton kostot për shfrytëzuesit e shërbimeve të pagesave, në këtë rast institucionet qeveritare, bizneset dhe ekonomitë familjare. Ky projekt pritet të finalizohet gjatë vitit 2019-2020 dhe synon të paraqes koston e instrumenteve të ndryshme të pagesave (parasë së gatshme, debit dhe kredit kartelave,

<sup>20</sup> Të dhënat në tabelë janë nga viti 2017 pasi që shumica e vendeve në rajon të dhënat për vitin 2018 nuk i kanë publikuar ende.



transfereve të kredit dhe debitimit direkt) për ekonominë e vendit, si dhe të identifikojë faktorët që kanë ndikim më të madh në nivelin e këtyre kostove. Të dhënat e nxjerra nga ky studim mundësojnë orientimin e veprimeve të përbashkëta të BQK-së, bankave dhe institucioneve tjera me qëllim reduktimin e kostove për pagesat me vlera të vogla dhe rritjen e efikasitetit dhe sigurisë për instrumentet e pagesave elektronike në funksion të zvogëlimit të përdorimit dhe kostove që rrjedhin nga përdorimi i parave të gatshme për shoqërinë.

#### 6.4. Menaxhimi i Mjeteve

Banka Qendrore e Kosovës realizon investimin e rezervave, si dhe operimin e sistemit depozitar për tregtimin e Letrave me Vlerë të Qeverisë së Republikës së Kosovës. Detyrat e menaxhimit të rezervave ndërkombëtare janë specifikuar në Ligjin për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës.

##### 6.4.1. Menaxhimi i Investimeve

Banka Qendrore menaxhon rezervat e saj për të arritur objektivat e Politikës së Investimeve të aprovuar nga Bordi Ekzekutiv, ku prioritet kanë siguria dhe likuiditeti i mjeteve, para kthimit nga investimet.

#### Instrumentet


Portofoli i përgjithshëm i rezervave përbëhet nga instrumentet e portofolit likuid dhe ato të portofolit investues. Pjesa likuide e rezervave mirëmbahet për të siguruar mjete të mjaftueshme për kryerjen e pagesave dhe transfereve sipas nevojave të BQK-së dhe depozitorëve të saj. Ndërsa pjesa investuese përbëhet nga instrumentet financiare të sigurta me vlerësim kreditor investiv.

Përbërja e portofolit të rezervave të BQK-së është pasqyruar në figurën 88 sipas gjendjes më 31 dhjetor 2018, ku shohim një përqendrim të lartë në mirëmbajtjen e mjeteve likuide prej 3.5 përqind të portfolios dhe investime në letra me vlerë kombëtare e ndërkombëtare të cilat lehtësisht mund të konvertohen në likuiditet.

Rezervën e BQK-së e përbëjnë këto instrumente financiare:

- depozitat e afatizuara bankare me afat maturimi deri në një vit, përkatësisht depozita në euro dhe dollar amerikan të afatizuara me banka të shteteve të EU-së me vlerësim kreditor investiv apo me Rezervën Federale të SHBA-së;
- letrat me vlerë ndërkombëtare, respektivisht obligacione qeveritare, supranacionale apo të agjencive shtetërore në euro me afat maturimi deri në pesë vite;
- obligacionet shtetërore të emetuara nga Qeveria e Kosovës të tregtuara në tregun sekondar të letrave me vlerë me afat maturimi deri në pesë vite.

Figura 88. Portfolio e rezervave të BQK-së, sipas gjendjes 31 dhjetor 2018



## Valutat

Valuta euro përbën valutën kryesore në portofolin investues të BQK-së me mbi 99.0 përqind të aseteve të denominuara dhe paguara në valutën euro. Më pak se 1 për qind e portofolit të rezervave mbahet në dollar amerikan të investuara në plasmane njëditore me normën e interesit të kuotuar nga marrëveshjet e riblerjes me Rezervën Federale të SHBA-ve. Shpërndarja e aseteve në dy valutat përkatëse bëhet në bazë të përmbajtjes së rezervave të BQK-së nga depozitarët e saj, të cilat kryesisht vijnë dhe mbahen në valutën euro.

## Shpërndarja

Vazhdimi i politikës së normës negative depozitare (deposit facility rate) nga Banka Qendrore Evropiane që ka rezultuar me çmime të larta të instrumenteve të borxhit në Eurosistem, ka diktuar shpërndarjen e portofolit të investimeve. Karakteristika kryesore e vitit 2018 është plasmani i mjeteve në instrumente borxhi me normë fikse të interesit me afat më të gjatë kohor, respektivisht në periudha deri në pesë vite, si rrjedhojë e pamundësisë për të investuar me kthime pozitive në periudha më të shkurtra.


Siç është pasqyruar në figurën 89 depozitat bankare përbëjnë instrumentin financiar me pjesëmarrje të ulët në portofolin e BQK-së gjë që ka ndihmuar në uljen e rrezikut kreditor. Si rezultat i normave të pafavorshme të investimeve në këtë kategori të instrumenteve financiare, BQK-ka ka vendosur ta mbajë këtë nivel të ekspozimit. Gjysma e dytë e vitit 2018 është karakterizuar me përmirësim të kthimeve nga investimet në depozitat bankare dhe si rrjedhojë BQK ka shfrytëzuar rastin të rrisë ekspozimin në depozita bankare nga 2.53 për qind në muajin janar deri në 18.5 për qind në muajin dhjetor. Paralelisht, kemi rënie në nivelin e lartë të likuiditetit (parasë së gatshme) që është mbajtur prej 43.9 për qind në muajin janar deri në 3.6 për qind në muajin dhjetor në mënyrë që të evitohen normat negative në llogari rrjedhëse. Njëkohësisht është mbajtur nivel i mjaftueshëm i likuiditetit.

Letrat me vlerë, kombëtare dhe ndërkombëtare, janë instrumenti më i favorshëm në portofolin e BQK-së dhe rrjedhimisht ekspozimi në këtë kategori të instrumentit financiar sipas figurës 89 është ngritur nga 53.5 për qind në fillim të vitit deri në 78.0 për qind të portofolit në fund të vitit.

Në veçanti, Letrat me Vlerë të emetuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës përbëjnë instrumentin me kthim më të lartë në portofolin investues. Sidoqoftë, letrat me vlerë ndërkombëtare ende paraqesin instrumentin financiar me pjesëmarrje më të lartë në portofolin e BQK-së, respektivisht me 58.80 për qind të portofolit siç mund të shihet në figura 88.

Efekti i normës negative depozitare (-0.40%) të vendosur nga BQK-ja ka ndikuar në mbajtjen e më pak rezervave në total të depozitorëve në BQK, ku vërehet rënie në totalin e tyre që nga viti 2016 e tutje bazuar në figurën 90.

Figura 89. Raporti i shpërndarjes së investimeve të portofolit të BQK-së (në përqindje)



Burimi: BQK (2019)

Në figurën 90 niveli më i ulët i rezervave në dispozicion për investime në vitin 2018 krahasuar me atë paraprak është vendosur qëllimisht duke rregulluar mbajtjen e parasë së gatshme në trezor për të evituar pagesat e normave negative të imponuara nga bankat komerciale dhe qendrore të Eurosistemit ndaj llogarive të jashtme të BQK-së. Në këtë mënyrë BQK-ja ka evituar humbjet nga normat negative.

Paralelisht me mbajtjen e një niveli më të ulët të rezervave të përgjithshme për investime në vitin 2018 sipas figurës 91 shohim përqendrim më të lartë në letra me vlerë për vitin aktual krahasuar me vitet paraprake. Rritja e ekspozimit në letra me vlerë si instrumenti më i favorshëm dhe më i sigurt në portofol ka mundësuar uljen e rrezikut kreditor në nivel të portofolit të investimeve, i cili para vitit 2016 ishte relativisht më i lartë për shkak të pjesëmarrjes së lartë të depozitave bankare në totalin e portofolios. Ulja e rrezikut kreditor në portofol është një nga performancat kryesore të ndryshimeve në strukturën e portofolit sipas kategorive të aseteve, me ç'rast përqendrimi në letra me vlerë të borxhit të qeverive qendrore dhe supranacionale e ka përmirësuar edhe likuiditetin duke konsideruar që këto letra janë lehtësisht të tregtueshme dhe të konvertueshme në para të gatshme.

#### 6.4.2. Performanca e portofolit për vitin 2018

Banka Qendrore Evropiane ka vazhduar politikën e saj monetare gjatë vitit 2018 duke i mbajtur normat e pandryshuara. Krahas kësaj ajo ka vazhduar me intensitet më të ulët programin e blerjes së aseteve për të injektuar likuiditet në treg. Ky likuiditet dhe kërkesa e lartë për instrumente borxhi të Euro sistemit ka bërë që normat e kthimit në këto instrumente të jenë jashtëzakonisht të ulëta dhe negative për emetuesit me vlerësim më të lartë kreditor dhe për maturitetet deri në 7 vite.


Në vitin 2018 janë realizuar 2.2 milionë euro të hyra bruto nga të gjitha kategoritë e investimeve, prej të cilave të hyra nga plasmanët në dollar amerikan janë 189 mijë euro.

#### 6.4.3. Menaxhimi i rrezikut

Investimi i mjeteve bëhet në letrat me vlerë të emetuara nga shtetet, agjencitë më kredibile të Eurozonës, dhe institucionet supranacionale me vlerësim kreditor investiv sipas vlerësimeve nga Agjencitë Kreditore ndërkombëtare: Standard & Poor's dhe Moody's.


Rreziqet financiare gjatë investimit të mjeteve nga ana e BQK-së janë: rreziku kreditor, rreziku i normës së interesit, rreziku likuiditetit, rreziku valutator dhe rreziku operacional.

Figura 90. Saldo përfundimtare e mjeteve të investuara sipas gjendjes së tyre me 31 dhjetor të viteve përkatëse



Burimi: BQK (2019)

Figura 91. Shpërndarja e portfolios investuese në çdo fundvit



Burimi: BQK (2019)

**Rreziku kreditor** - Portfolio e investimeve është shpërndarë në mënyrë që të mbahet rreziku kreditor në nivel të ulët. Të gjitha investimet janë realizuar në raport me kriteret e rangimit afatshkurtër dhe afatgjatë kreditor të përcaktuar në Politikën e Investimeve P-2/A-2 (Moody's/S&P) për afat të shkurtër dhe Baa2/BBB (Moody's/S&P) për afat të gjatë, si dhe në rastet e jashtëzakonshme në treg, me P-3/A-3 për afat të shkurtër dhe Baa3/BBB- (Moody's/S&P) për afat të gjatë.

**Rreziku i normës së interesit** - menaxhimi i rrezikut të normave të interesit nga BQK-ja kundrejt limitit të ndryshimit të normave të interesit, plotësohet duke monitoruar ndjeshmërinë e mjeteve dhe detyrimeve të BQK-së ndaj skenarëve të ndryshëm standard dhe jo-standard të normave të interesit.

**Rreziku i likuiditetit** - është rreziku në përmbushjen në kohë të duhur të obligimeve nga detyrimet e saj financiare. Qëndrimi i BQK-së në menaxhimin e likuiditetit është të sigurojë, që vazhdimisht të ketë likuiditet të mjaftueshëm për të përmbushur me kohë detyrimet, si në kushte normale ashtu edhe në ato të pafavorshme, pa pësuar humbje të papranueshme apo duke rrezikuar dëmtimin e reputacionit të BQK-së.

**Rreziku valutor** - paraqitet si pasojë e lëvizjeve të kursit këmbimor që implikojnë vlerën e valutave në tregun financiar ku mund të paraqitet kthimi apo humbja si rezultat i ndryshimeve të kursit këmbimor;

**Rreziku operacional** - është rreziku i përmbushjes që ka të bëjë me plasmanin e depozitave, tregtimin e letrave me vlerë dhe pagesën me kohë të tyre.

#### 6.4.4. Letrat me Vlerë të Qeverisë së Kosovës

Në pajtim me Ligjin për Borxhet Publike BQK-ja vepron si agjent fiskal për Ministrinë e Financave në procesin e emetimit të Letrave me Vlerë të Qeverisë.

Sipas kalendarit të emetimeve të letrave me vlerë të publikuar nga Ministria e Financave, në vitin 2018 janë mbajtur gjithsej 20 ankande përmes platformës elektronike: 2 ankande për bono thesari me afat maturimi 6 muaj, 5 ankande për bono thesari me afat maturimi 12 muaj, 3 ankande për obligacione qeveritare me afat maturimi dy vite, 2 ankande për obligacione qeveritare me afat maturimi tre vite, 5 ankande për obligacione qeveritare me afat maturimi pesë vite dhe 2 ankande për obligacione qeveritare me afat maturimi shtatë vite.

Më 30 korrik 2018 për herë të parë është realizuar ankandi për emetim të obligacioneve qeveritare me afat maturimi dhjetë vite.

Në figurën 92 paraqitet struktura e letrave me vlerë të Qeverisë së Kosovës e shprehur në përqindje sipas afatit të maturimit origjinal.

Figura 92. Struktura e Letrave me Vlerë të Qeverisë sipas afatit të maturimit





Figura 93 paraqet pjesëmarrjen sipas kategorisë së investitorit në ankandet e Letrave me Vlerë të Qeverisë së Kosovës.<sup>21</sup>


Krahasuar me vitin paraprak, norma mesatare vjetore e kthimit për bonot e thesarit me afat maturimi 6 muaj ka shënuar rritje prej 18 pika bazë, ndërsa për bonot e thesarit me afat maturimi 12 muaj është shënuar rritje prej apo 24 pika bazë. Norma mesatare vjetore e kthimit për obligacionet qeveritare me afat maturimi 2 vite në vitin 2018 ka shënuar rritje prej 86 pika bazë, për obligacionet qeveritare 3 vite është shënuar rritje prej 67 pika bazë për obligacionet qeveritare 5 vite është shënuar rritje prej 142 pika bazë, ndërsa për obligacionet qeveritare 7 vite është shënuar rritje prej 53 pika bazë. Norma mesatare e kthimit për obligacionin qeveritar me afat prej 10 vitesh për vitin 2018 rezultoi me normë vjetore të kthimit prej 5.3 përqind (figura 94).

Figura 93. Struktura e pjesëmarrësve në ankande




Burimi: BQK (2019)

Figura 94. Normat mesatare vjetore të kthimit për vitin 2017 dhe 2018, në përqindje



Burimi: BQK (2019)

Figura 95. Ankandet e letrave me vlerë të qeverisë në vitin 2018



Burimi: BQK (2019)

Në figurën 95 janë paraqitur të gjitha ankandet ku shihet se kërkesa më e lartë nga tregu ishte për bono thesari me afat maturimi 6 muaj dhe 12 muaj dhe për obligacione qeveritare me afat maturimi dy vite.

Aktivitetet e tregtimit në tregun sekondar marrë në konsideratë numrin e transaksioneve të Letrave me Vlerë të Qeverisë së Kosovës krahasuar me vitin paraprak, kanë vazhduar me intensitet më të lartë. Pjesëmarrës në tregtime kanë qenë investitorët, sikurse bankat komerciale, siguruesit, personat fizik dhe institucionet publike. Vëllimi vjetor i tregtimeve në tregun sekondar të Letrave me Vlerë të Qeverisë gjatë vitit 2018 ka qenë 78.6 milion euro, ndërsa në vitin 2017 prej 143.7 milion me rënie prej 45.2 përqind. Numri vjetor i transaksioneve për vitin 2018 ka qenë 81 që është 30.6 përqind më i lartë krahasuar me vitin 2017, ku janë realizuar 62 transaksione. Gjatë muajit dhjetor 2018, janë realizuar për herë të parë transaksionet për nevoja të likuiditetit afatshkurtër ndërmjet bankave komerciale, përmes marrëveshjeve për riblerje të Letrave me Vlerë të Qeverisë.

<sup>21</sup> Pjesëmarrës në tregun e Letrave me Vlerë të Qeverisë janë bankat komerciale, fondet pensionale, siguruesit dhe pjesëmarrësit tjerë përmes bankave komerciale (Akteve Primarë).

## 6.5. Teknologjia Informativë

BQK-ja ka vazhduar me ngritjen e nivelit të shërbimeve, avancimit në teknologji si dhe ngritjen e sigurisë së sistemeve të informacionit. Një nga projektet më të rëndësishme të implementuara këtë vit është ai i vlerësimit dhe testimit të sigurisë së sistemeve. Me këtë projekt, BQK-ja tregon përkushtimin maksimal që sistemet e Teknologjisë Informativë të jenë sa më të sigurta dhe të avancuara, në mënyrë që sa më shumë të garantojë sigurinë, integritetin e të dhënave dhe komunikimin me sektorin financiar. Po ashtu, në vazhden e avancimeve të përgjithshme në sistemet e pagesave, BQK-ja ka avancuar edhe sistemin e pagesave ndërkombëtare, i cili është në pajtueshmëri të plotë me kërkesat e SWIFT-it.

Gjatë vitit 2018, kanë vazhduar edhe investimet në staf dhe pajisje të sigurisë dhe monitorimit, me qëllim të ngritjes së mëtutjeshme të kapaciteteve të brendshme.

## 6.6. Regjistri i Kredive të Kosovës

Bazuar në Ligjin për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, BQK-ja mund të operojë, të rregullojë, të licencojë, të regjistrojë dhe të mbikëqyrë sistemet e informacionit të kredive me qëllim të mbledhjes dhe shpërndarjes së informacionit të kredive mes institucioneve financiare si dhe mund të nxjerrë rregullore për zbatimin përkatës.

Bazuar në këtë objektiv që nga viti 2006, BQK-ja ka nën menaxhim të saj sistemin e Regjistrimit të Kredive (RKK), i cili funksionon si një aplikacion i bazuar në internet dhe ka për qëllim mbledhjen dhe shpërndarjen e informatave të personave fizikë dhe juridikë, me qëllim të përmirësimit të procesit vlerësues të klientëve kreditorë, si dhe realizimin e funksionit mbikëqyrës të BQK-së.


Nga një perspektivë e përgjithshme ekonomike, Regjistri i Kredive lehtëson kredidhënien sa i përket vëllimit dhe kostove, si dhe kontribuon në stabilitetin financiar në përgjithësi duke ndihmuar kredidhënësit për një vendimmarrje të drejtë, brenda një kohe më të shkurtër në mënyrë më të saktë dhe më objektive.

Në bazë të rregullores së Regjistrimit të Kredive, anëtar në sistemin e RKK-së janë të gjitha institucionet financiare të përcaktuara nga BQK-ja për të qenë ofrues të kredive, duke përfshirë; të gjitha bankat komerciale, institucionet mikrofinanciare, institucionet financiare jobankare si dhe siguruesit, të licencuar për t'u marrë me aktivitete të veçanta kreditorë.

Në sistemin e RKK-së aktualisht janë të regjistruar 1689 përdorues aktivë të institucioneve kredidhënëse, ku dominon numri i përdoruesve nga institucionet bankare me 1303 përdorues aktivë, institucionet mikrofinanciare dhe ato jobankare vijojnë me 355 përdorues dhe në fund siguruesit me 31 përdorues aktivë të sistemit të RKK-së. Gjatë vitit 2018, Regjistri i Kredive ka regjistruar 463 përdorues të ri.

Regjistri Kredive ofron infrastrukturë të avancuar për funksionimin e tregut të kredive duke paraqitur një mjet të rëndësishëm për institucionet kredi-dhënëse në vlerësimin e riskut kreditor.

Figura 96. Numri i hulumtimeve në sistemin e RKK-së



Burimi: BQK (2019)

Sistemi i RKK-së është një aplikacion i bazuar në internet dhe mund të qaset drejtpërdrejt dhe në kohë reale nga stafi i institucioneve kredidhënëse.

Institucionet kredidhënëse në sistemin e RKK-së hulumtojnë mbi historitë kreditore të aplikantëve kreditorë ku sipas statistikave që dalin nga sistemi i RKK-së, numri i hulumtimeve gjatë vitit 2018 kap shifrën prej 938,682 hulumtime.

Një pasqyrë mbi këtë aktivitet, në baza vjetore për vitet 2014, 2015, 2016, 2017 dhe 2018 është paraqitur në vijim në figurën 97.

Të gjithë ofruesit e kredive janë të obliguar të raportojnë në RKK, të gjitha aplikacionet për kredi dhe kreditë e lëshuara për klientët e tyre në përputhje me kushtet e udhëzimit përkatës të lëshuar nga BQK-ja.

Gjatë vitit 2018 bazuar në të dhënat e sistemit të RKK-së, janë raportuar 297,482 kredi të aprovuara ku përfshihen huat, kredit kartelat, mbitërheqjet, kreditë hipotekare rezidenciale, linjat kreditore, garancionet, lizingu, faktoringu dhe asetet tjera kreditore.

Raporti i numrit të kredive të aprovuara sipas llojit të institucionit kredidhënës për vitet 2014, 2015, 2016, 2017 dhe 2018 është paraqitur në vijim përmes figurës 98.


Figura 98 paraqet numrin e kërkesave për raportin individual kreditor të kredimarrësve (fizik / juridik) bazuar nga të dhënat e sistemit të Regjistrimit të Kredive për vitet 2014, 2015, 2016, 2017, dhe 2018.

Regjistri i Kredive gjatë vitit 2018 ka kontribuar drejtpërdrejt në të dhënat e mbledhura nga Banka Botërore (BB) për vlerësimin e të Bërit Biznes.

Raporti i Bankës Botërore i të Bërit Biznes 2019 i publikuar më 31 tetor 2018, vlerëson Kosovën për treguesin “Marrja e Kredive” me pozitën e 12-të për vitin e dytë me radhë.


Nëse bëhet një krahasim me vendet e rajonit, Kosova qëndron në të njëjtin nivel me Malin e Zi dhe Maqedoninë e Veriut, si vendet me vlerësimin më të mirë në rajon për treguesin “Marrja e Kredive”.

Figura 97. Numri i kredive të aprovuara në sistemin e RKK-së




Burimi: BQK (2019)

Figura 98. Numri i kërkesave për raporte kreditore



Burimi BQK (2019)

Figura 99. Rangimi i Kosovës në raportin Doing Business 2019



Burimi: Doing Business (2019)



Në figurën 99 paraqitet pozita e Republikës së Kosovës për treguesin “Marrja e Kredive” në krahasim me vendet e rajonit.

### 6.7. Aktivitetet në fushën e analizave ekonomike dhe stabilitetit financiar

Në funksion të realizimit të objektivit primar të saj, ruajtjes së stabilitetit financiar përmes monitorimit të rregullt të rrezikut sistemik, BQK-ja ndër të tjera, në mënyrë të vazhdueshme bën identifikimin, monitorimin dhe analizimin e rrezikut sistemik. Në këtë kontekst, identifikimi i rreziqeve potenciale bëhet përmes monitorimit të vazhdueshëm të zhvillimeve ciklike dhe strukturore makroekonomike si dhe sistemit financiar. Ndërsa, vlerësimi i rreziqeve dhe ndikimi i tyre potencial në stabilitetin financiar dhe për pasojë stabilitetin e përgjithshëm makroekonomik, bëhet përmes analizave të rregullta kualitative dhe kuantitative përfshirë analizimin e ecurisë së treguesve ekonomikë dhe financiarë me frekuencë të lartë, parashikimet mbi treguesit kryesorë makroekonomikë dhe aplikimin e modeleve, që adresojnë dimensionin ciklik, strukturor dhe ndërsektoral të rrezikut sistemik.

BQK-ja ka vazhduar të jetë e fokusuar në rritjen e vëllimit dhe cilësisë së analizave që shqyrtojnë zhvillimet kryesore makroekonomike në vend dhe atyre me fokus në vlerësimin e stabilitetit financiar. Përmes identifikimit dhe vlerësimit të rreziqeve që kanosin sistemin financiar dhe infrastrukturën e tij, me një perspektivë të analizave të bazuar në rrezik, BQK-ja synon jo vetëm të informojë publikun mbi gjendjen e sistemit financiar, por edhe të ngrisë transparencën dhe nxitë debatin profesional mbi zhvillimet dhe sfidat e sistemit financiar të vendit dhe infrastrukturës së tij.

Përveç analizave të ndryshme periodike dhe monitorimit të rregullt të treguesve kryesorë të zhvillimeve në sektorët përkatës të ekonomisë, BQK-ja ka zhvilluar dhe adaptuar disa modele për vlerësimin e rreziqeve, si modeli i Hartës së Stabilitetit Financiar (që analizon zhvillimet në tetë dimensione të rrezikut ndaj stabilitetit financiar), modelin e stres-testit (një nga veglat kyçe për identifikimin e brishtësive aktuale në sektorin bankar dhe rreziqeve potenciale sistematike në vitin vijues), modelin e Identifikimit të Bankave me Rëndësi Sistematike (instrument tipik i politikës makroprudenciale i cili vlerëson rrezikun e shpërndarjes së efekteve negative të një institucioni sistemik në tërë sistemin), si dhe modeli i Kapitalit Shtesë Kundërciklik (model tipik i politikës makroprudenciale).<sup>22</sup>

Në vitin 2018 për herë të parë pas 12 vëllimeve është rishikuar tërësisht në përmbajtje dhe në cilësi të analizës një ndër publikimet më të rëndësishme periodike, Raporti i Stabilitetit Financiar (RSF). Raporti është ristrukturuar në tërësi, me qëllim që të ofrojë një perspektivë më tematike dhe gjithëpërfshirëse të rreziqeve dhe sfidave kryesore ndaj stabilitetit financiar, gjithnjë në funksion të sigurimit të objektivit parësor të BQK-së, ruajtjes së stabilitetit financiar përmes identifikimit dhe vlerësimit të rreziqeve që kanosin sistemin financiar dhe infrastrukturën e tij. Ky edicion i RSF-së është plotësuar me modelet e rishikuara për vlerësim të rrezikut sistemik si analiza e stres-testit dhe modeli për vlerësimin e kërkesës për kapital kundërciklik për sektorin bankar të Kosovës.

Gjithashtu, për herë të parë në vitin 2018, BQK-ja publikoi edhe materialin studimor të emërtuar Modeli MakroEkonometrik i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës (KMM). Ky material prezanton Modelin Makroekonometrik të Ekonomisë së Kosovës (KMM), model që u ndërtua gjatë periudhës 2016-2017 nga Departamenti i Analizave Ekonomike dhe Stabilitetit Financiar. Duke qenë edhe model që është ende në proces të operacionalizimit të plotë gjatë vitit 2019, rezultatet e gjeneruara nga modeli në procesin e parashikimit dhe simulimit për vlerësimet tremujore, në

<sup>22</sup> Informata më të detajuara rreth metodologjisë dhe analizës së modeleve paraqiten në Raportin e Stabilitetit Financiar Nr.13



kombinim me mjetet e tjera analitike dhe indikatorët me frekuencë të lartë që monitorohen, kanë mundësuar rritjen e cilësisë së analizave të rregullta kualitative dhe kuantitative në BQK.

Për t'i siguruar publikut qasje sa më të shpejtë në informacionet rreth zhvillimeve në ekonominë e vendit, BQK-ja ka vazhduar të publikojë në baza të rregullta Vlerësimet Tremujore, raporte që ofrojnë një pasqyrë mbi zhvillimet kryesore makroekonomike dhe zhvillimet në të gjithë komponentët e sistemit financiar të ekonomisë në baza tremujore. Për më tepër, BQK-ja vazhdon të publikojë edhe Raportin e Informatave Mujore të Sistemit Financiar, i cili paraqet një përmbledhje të indikatorëve kyçë për të gjithë komponentët e sistemit financiar të Kosovës dhe publikohet çdo muaj.

BQK-ja ka vazhduar të realizojë Anketën e Kreditimit Bankar me bankat komerciale, duke mbledhur kështu informacion të rëndësishëm për faktorët me ndikim në aktivitetin kredidhënës të bankave në Kosovë, si dhe për pritjet për aktivitetin kredidhënës në periudhën e ardhshme. Informacionet nga kjo anketë e cila realizohet dy herë në vit, përveç që kanë ndihmuar për të kuptuar më mirë zhvillimet në sektorin bankar, shërbejnë edhe si input i rëndësishëm për parashikimin e rritjes ekonomike dhe të agregatëve tjerë makroekonomikë.

### **6.8. Aktivitetet kryesore në fushën e statistikave gjatë vitit 2018**

Në kuadër të përgjegjësisë së përpilimit dhe publikimit të statistikave të sektorit monetar e financiar (SMF) dhe statistikave të sektorit të jashtëm (SSJ), BQK-ja ka bërë hapa të rëndësishëm në avancimin e mëtutjeshëm të sistemit statistikor dhe aplikimin e standardeve të fundit ndërkombëtare në fushën e statistikave. Përpilimi dhe publikimi i statistikave është bërë me rregull dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare. BQK-ja ka plotësuar të gjitha kërkesat statistikore të nevojshme për mbikëqyrje të institucioneve financiare dhe monitorim të zhvillimeve kryesore makroekonomike në ekonominë e Kosovës. Përparim është bërë në harmonizimin e mëtejshëm të SSJ me kërkesat e Eurostat-it, zgjerim të gamës me statistika të reja dhe është bërë progres në krijimin e kornizës për hartimin e statistikave të llogarisë financiare.

Në përpjekje për të rritur kualitetin e statistikave gjatë verës 2018 për herë të tretë është organizuar anketa me jorezidentë që vizitojnë Kosovën gjatë kësaj periudhe. Për dallim nga dy vitet e kaluara, kësaj radhe anketa është plotësuar duke përdorur një sistem shumë të avancuar të huazuar nga Banka Botërore, i cili ka mundësuar rritje të efikasitetit të mbledhjes së të dhënave dhe përmirësim të kualitetit të tyre. Të dhënat e mbledhura janë përdorur për kalkulimin e vlerësimeve të shpenzimeve të emigrantëve në Kosovë, të cila kanë ndikim të rëndësishëm në statistikën e shërbimeve të udhëtimit dhe disa kategori tjera që lidhen me impaktin e emigrantëve në Kosovë.

Gjatë vitit 2018 Kosova ka pranuar një asistencë teknike nga Eurostat, me ç'rast janë iniciuar dy projekte që kanë për qëllim përmirësimin e statistikave që janë përgjegjësi e BQK-së; "Macroeconomic Imbalance Procedure (MIP)" dhe "International Trade in Services Statistics (ITSS)". Këto projekte financohen në kuadër të programit shumë përfitues IPA 2015 nga Komisioni Evropian dhe kanë për qëllim rritjen e kualitetit të statistikave përkatëse dhe harmonizimin e tyre me kërkesat e acquis. Afati i përmbyshjes së detyrave që ngarkojnë këto dy projekte është deri në shtator 2019.

Në vitin 2018 Kosova ka udhëhequr takimet e CEFTA-së. Në takimin e mbajtur në nëntor 2018, BQK-ja ka udhëhequr pjesën e parë të takimit. Në kuadër të përgjegjësisë si anëtare e CEFTA-së, statistikën që janë përgjegjësi e BQK-së janë raportuar në afat dhe sipas kërkesave për mbledhjen e të dhënave për anëtarët e CEFTA-së.

Departamenti i Statistikës në përpjekje për të avancuar sistemin statistikor, në pjesën e dytë të vitit 2018, në bashkëpunim me Departamentin e Teknologjisë së Informacionit (DTI) është

angazhuar në ndërtimin e një faqe online për mbledhjen e të dhënave nga anketuesit për sektorin e korporatave jo financiare e ashtuquajtur DCSSES (Data Collection System for Enterprise Survey).

Gjatë vitit 2018, gama me statistika të reja është zgjeruar, duke publikuar disa tabela të reja për asetet rezervë, eksportet dhe importet e mallrave sipas shteteve e llojeve të mallrave. Progres i rëndësishëm është bërë në avancimin e sistemit të procesimit të të dhënave nga aplikacioni final, duke bërë të mundur gjenerimin automatik të disa raporteve dhe ndërtimin e rregullave të validimit.

BQK-ja ka filluar ndërtimin e kornizës për përpilimin e statistikave të llogarive financiare (SLLF). Fillimisht është bërë një vlerësim i burimeve ekzistuese të të dhënave të nevojshme për përpilimin e statistikave për llogaritë financiare. Pastaj janë identifikuar të dhënat që mungojnë. Njëherit është definuar mënyra e procesimit të të dhënave dhe përpilimit të statistikave për llogaritë financiare të Kosovës.

### **6.9. Rishqyrtimi i kërkesave të institucioneve financiare të mbikëqyrura nga BQK-ja**

BQK gjatë ushtrimit të kompetencave të veta mbikëqyrëse, duke vepruar në pajtueshmëri me nenin 67. pika 4 të Ligjit nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, para se të shqiptojë ndëshkime administrative, i ofron një deklaratë të detajuar personit të cilit do t'i shqiptohet ndëshkimi duke përshkruar faktet dhe ligjin që mbështesin ekzistencën e shkeljes dhe do t'i japë këtij personi mundësi të plotë të ofrojë fakte dhe argumente se pse ndëshkimi nuk do duhej t'i shqiptohej.

Në dokumentin/deklaratën e dërguar nga BQK-ja (Njoftim për qëllimin e shqiptimit të masave ndëshkimore administrative), jepet edhe këshilla juridike, ku institucioni informohet me të drejtën që brenda 15 ditësh kalendarike nga dita e pranimit të kësaj deklarate, të bëjë kërkesë për rishqyrtim te Divizioni i rishqyrtimit.

Institucionet e mbikëqyrura nga BQK-ja pas pranimit të një deklarate të tillë, dhe duke qenë se kanë mundësinë e rishqyrtimit të masës ndëshkimore, në rast se vendosin të ankohen, adresojnë kërkesën në Divizionin e rishqyrtimit.

Bazuar në atë që u tha më lartë, Divizioni i rishqyrtimit gjatë vitit 2018 ka pranuar për rishqyrtim një varg kërkesash nga institucionet financiare të mbikëqyrura nga BQK-ja.

Të gjitha kërkesat janë shqyrtuar me kujdesin profesional dhe në pajtueshmëri me kuadrin ligjor, janë adresuar në formën e rekomandimeve dhe janë përcjell në Bordin Ekzekutiv të BQK-së për vendimmarrje.

Divizioni i rishqyrtimit ka identifikuar ndryshimet e nevojshme në rregullativën ligjore me qëllim të rregullimit dhe avancimit të çështjeve të caktuara me efekt të drejtpërdrejtë në çështjet e mbikëqyrjes dhe rregullimit.

Në këtë kontekst Divizioni i Rishqyrtimit ka rishqyrtuar rregullativën ligjore dhe me kërkesë edhe të Bordit Ekzekutiv të BQK-së, ka iniciuar plotësim-ndryshimin e Rregullores për procedurat për ndëshkime administrative.

## 7. Zhvillimet e brendshme

### 7.1. Auditimi i Brendshëm

Një nga hallkat kyçe të kontrolleve të brendshme të pavarura, të dizajnuara dhe vendosura në Institucione është Auditimi i Brendshëm (tutje AB). AB-ja bashkë me auditimin e jashtëm përmbyllin zinxhirin e llogaridhënies brenda BQK-së.

Korniza ligjore e BQK-së, në mënyrë formale i ka ofruar mandat të plotë AB-së që në mënyrë të pavarur të zhvillojë aktivitete të auditimit me qëllim që t'i ofrojë Menaxhmentit rekomandime në të mirë të menaxhimit sa më ekonomik, efikas dhe efektiv të buxhetit dhe pasurisë si dhe shtimit të vlerës së operacioneve dhe përmirësimit të tyre. AB-ja i ofron siguri mekanizmave të nivelit të lartë mbikëqyrës joekzekutiv, siç janë Bordi i BQK-së dhe Komiteti i Auditimit se proceset, kontrollet e brendshme, operacionet dhe aktivitetet e tjera brenda BQK-së janë duke funksionuar në mënyrë efektive.

Auditimi i Brendshëm gjatë vitit 2018 ka kryer një numër aktivitete bazuar në Planin Vjetor të punës së AB-së për vitin 2018, të miratuar nga Bordi i BQK-së. Plani vjetor është përpiluar duke u bazuar në metodologjinë e vlerësimit të rreziqeve, model ky i adaptuar nga praktika e Bankës Qendrore Evropiane. Përgatitjes së Planit Vjetor, i ka paraprirë Universi i Auditimit i përgatitur për periudhën trevjeçare 2017-2019. Plani i përgatitur nga AB-ja, pas rishikimit dhe diskutimeve me Komitetin e Auditimit, është aprovuar në Bordin e BQK-së. Me të njëjtën metodologji është përgatitur Plani Vjetor i punës së AB-së edhe për vitin 2019.

Aktivitetet e auditimeve të kryera gjatë vitit 2018 ishin të natyrës: financiare, të pajtueshmërisë, operacionale dhe të teknologjisë informative. Duhet theksuar se për herë të parë gjatë këtij viti AB-ja ka realizuar auditime të tipit të "integruar" të cilat kanë përfshirë një kombinim të auditimeve financiare dhe të rregullsisë të shoqëruara me auditime të teknologjisë informative.

Fushëveprimi i AB-së ka vazhduar të jetë i orientuar në drejtim të përmirësimit dhe avancimit të sistemeve dhe proceseve të cilat krijojnë siguri funksionale dhe e ndihmojnë Menaxhmentin në përmirësimin dhe avancimin e mëtejshëm të qeverisjes korporative dhe realizimin e objektivave të BQK-së.

Në përputhje me Ligjin e BQK-së dhe Statutin e Auditimit të Brendshëm, Shefi i AB-së, gjatë vitit 2018 ka raportuar në periudha të rregullta tremujore dhe vjetore në Komitet të Auditimit dhe Bord të BQK-së. Në këto raportime nga niveli i auditimit janë adresuar të gjeturat e auditorit, rekomandimet si dhe veprimet e ndërmarra për adresimin e tyre. Raportet janë diskutuar paraprakisht në Komitetin e Auditimit dhe Bordin e BQK-së dhe më pas çështjet për trajtim të mëtutjeshëm të cilat kanë kërkuar masa për implementim, janë drejtuar për adresim të Menaxhmenti ekzekutiv. Përmes raportimeve të tilla AB-ja, ka raportuar në lidhje me nivelin e përmbushjes së rekomandimeve të dhëna në periudhat paraprake.

Me qëllim të përmbushjes së rekomandimeve të dhëna nga vlerësimet e jashtme (Banka Botërore; Banka Qendrore Evropiane; FMN - Vlerësimi i masave mbrojtëse (Safeguard Assessment) dhe USAID-i, AB-ja ka vazhduar me aktivitetet që kanë ndikuar në këtë drejtim. Rekomandimet kanë të bëjnë me përmirësimin dhe avancimin e cilësisë së punës së auditimit në përputhje me Standardet Ndërkombëtare për Praktikën Profesionale të Auditimit të Brendshëm të publikuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit të Brendshëm.

Gjatë vitit 2018, AB-ja ka vazhduar të kryej aktivitetet e auditimeve të përcaktuara me Planin Vjetor të Punës 2017-2018. Deri në kohën e raportimit janë kryer gjithsej tetëmbëdhjetë (18) angazhime të auditimit. Fushat kryesore të cilat janë audituar në vitin 2018 kanë të bëjnë me: Paranë e gatshme, mbikëqyrjen financiare, investimin e mjeteve, sigurinë fizike, rishikimin e

pasqyrave financiare, rishikimin e funksioneve dhe proceseve të tjera në përputhje me rreziqet e vlerësuara. Në kuadër të auditimeve të planifikuara, në bazë të kërkesës nga marrëveshja midis Qeverisë së Kosovës, BQK-së dhe FMN-së, në baza gjashtëmujore janë kryer dy (2) “auditime të pavarura të rekonsilimit të llogarive të Qeverisë”. Raportet janë dërguar në FMN përmes përfaqësuesit rezident, në kohën e caktuar në Marrëveshje.

Gjatë vitit 2018 AB ka vazhduar aktivitetet rreth zhvillimit të vazhdueshëm profesional të stafit, përmes pjesëmarrjes në disa ngjarje me karakter si ndërkombëtar ashtu edhe kombëtar. Stafi i AB-së ka ndjekur disa trajnime, konferenca dhe punëtori me qëllim të edukimit të mëtutjeshëm dhe zhvillimit profesional.

Ndërsa, gjatë vitit 2018 një staf i AB-së është certifikuar në CRISC (Certified in Risk and Information Systems Control)<sup>23</sup> organizuar nga ISACA<sup>24</sup>.

## 7.2. Burimet Njerëzore

Në zbatim të objektivave strategjike të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës dhe politikave të administrimit të burimeve njerëzore, BQK-ja është fokusuar në drejtim të përvetësimit dhe zbatimit në vazhdimësi të praktikave më të mira të menaxhimit të burimeve njerëzore, që aplikohen në institucione të ngjashme.

Administrimi efektiv i burimeve njerëzore i kushton rëndësi të veçantë përshtatjes së infrastrukturës rregullative të institucionit me standardet më të mira, si dhe ofron mundësi për zhvillim dhe promovim për të gjithë punonjësit, duke synuar rritjen e profesionalizmit, performancës dhe motivimit të punonjësve.


Në fund të vitit 2018 numri i të punësuarve në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës ishte 218. Moshë mesatare e të punësuarve ka qenë 41.53 vite. Përfaqësimi gjinor në nivel specialistësh dhe drejtuesish është i ekuilibruar. Raporti i femrave ndaj meshkujve është 51.8 përqind - 48.2 përqind, ndërkohë që ky raport në nivel drejtues është 46.2 përqind - 53.8 përqind.

Në strukturën e përgjithshme të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës 4

punonjës ose 1.8 përqind janë me PhD, 74 punonjës ose 33.9 përqind me edukim pasuniversitar, 110 punonjës ose 50.5 përqind me edukim universitar, 27 punonjës ose 12.4 përqind me edukim të mesëm dhe 3 punonjës ose 1.4 përqind me edukim bazik (figura 100).

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës vlerëson personelin si një ndër resurset me rëndësi të veçantë dhe vazhdimisht angazhohet për mbështetjen e tyre që t'u sigurojë njohuri të duhura, aftësi, ekspertizë dhe ngritje profesionale adekuate për përmbushjen e detyrave dhe përgjegjësisë sipas standardeve më të larta, për arritjen e potencialit të plotë të tyre, duke krijuar kushte për vijim të studimeve pasuniversitare si dhe përmes pjesëmarrjes në konferenca, trajnime, kurse, seminare, etj.

Figura 100. Struktura sipas edukimit



Burimi: BQK (2019)

<sup>23</sup> Certifikuar në Rrezik dhe Kontroll të Sistemeve të Informacionit

<sup>24</sup> Shoqatë Globale e Profesionistëve të Sistemeve të Informacionit e dedikuar për auditim, kontroll dhe siguri të informacionit

Nga numri i përgjithshëm i të punësuarve, 99 punonjës ose 46.1 përqind e tyre kanë marrë pjesë në trajnime profesionale, të cilat kryesisht janë organizuar nga Banka Qendrore Evropiane, Fondi Monetar Ndërkombëtar - FMN, Joint Vienna Institute - JVI, Deutsche Bundesbank, Banka e Holandës, Banka e Polonisë, Banka e Francës, Banka e Italisë, Banka e Çekisë, Istanbul School of Central Banking, Shoqata e Bankave të Kosovës dhe “Center of Excellence in Finance – CEF”.

Gjatë vitit 2018 gjithsej 29 studentë mbaruan programin e praktikës në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës. Qëllimi kryesor i këtij programi ka qenë që stafi profesional i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, të ndajë përvojat e veta me studentë të dalluar dhe të realizojë një hulumtim për vlerësimin e shpenzimeve të bashkatdhetarëve tanë gjatë qëndrimit të tyre në Kosovë, në sezonin e verës.

Prej grupit në fjalë janë angazhuar 7 studentë në realizimin e një projekti studimor për vlerësimin e nivelit dhe strukturës së shpenzimeve të emigrantëve gjatë qëndrimit në Kosovë. Në kuadër të projektit, studentët kanë zhvilluar anketa në terren në disa pika të përzgjedhura kufitare të Kosovës gjatë periudhës korrik – gusht 2018, nga pyetësi janë nxjerrë rezultatet kryesore dhe në fund është përgatitur një raport i shkurtër me të gjeturat kryesore.

### 7.3. Aktiviteti ligjor i BQK-së

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës gjatë vitit 2018 ka vazhduar me harmonizimin dhe avancimin e infrastrukturës ligjore ekzistuese të sektorit financiar, me synimin kryesor që rregullativa të jetë në hap me të rehat më të fundit të zhvillimeve në legjislacionin e Bashkimit Evropian si dhe standardet ndërkombëtare.

Gjatë këtij viti është punuar për plotësim/ndryshimet e ligjeve në fuqi siç janë Ligji për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia nr. 04/L-018, si dhe Ligji për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare nr. 04/L-093. Qëllimi i plotësim/ndryshimeve të këtyre ligjeve është harmonizimi me legjislacionin e Bashkimit Evropian si dhe praktikën dhe standardet më të mira ndërkombëtare, në mënyrë që të arrihen objektivat e BQK-së për ruajtjen dhe mbarëvajtjen e stabilitetit financiar si dhe mbrojtjen e interesave të policëmbajtësve dhe depozitorëve. Ligji për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia nr. 04/L-018 është plotësuar dhe ndryshuar në funksion të përafrimit të këtij Ligji me direktivat evropiane dhe praktikën më të mira legjislative të vendeve në rajon, si dhe qartësimin të dispozitave për të cilat është hasur në vështirësi në zbatimin e tyre në praktikë, përderisa Ligji për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare nr. 04/L-093 është avancuar duke i ndarë në dy ligje të veçanta: si Ligji për Bankat dhe Ligji për Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare. Projektligji për Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare tanimë gjendet tek organet kompetente qeveritare për procedim të mëtutjeshëm të miratimit.

Gjithashtu, me qëllim të përmbushjes së objektivave dhe detyrave të Bankës Qendrore, organet vendimmarrëse të BQK-së kanë vazhduar me miratimin e akteve nënligjore, të cilat paraprakisht, para miratimit të tyre, kanë qenë subjekt i shqyrtimit nga aspekti ligjor. Më konkretisht, rregullativa e veprimtarisë së institucioneve financiare është avancuar me qëllim të implementimit të kornizës ligjore në fuqi dhe harmonizimit me legjislacionin e ri dhe atë ekzistues.

BQK-ja është angazhuar edhe në arritjen e marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucione vendore dhe ato ndërkombëtare, me qëllim të kryerjes me efikasitet të detyrave lidhur me çështjet brenda fushave të kompetencave reciproke të institucioneve përkatëse.

Në pajtim me autorizimet ligjore dhe objektivat e përcaktuara me legjislacionin në fuqi, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës vazhdon me zhvillimin e mëtutjeshëm të një rregullative

moderne ligjore në fushën e sektorit financiar, me qëllimin kryesor të nxitjes dhe mbarëvajtjes së një sistemi stabil dhe të qëndrueshëm financiar në Kosovë.

#### 7.4. Funkzioni i Menaxhimit të Rrezikut

Menaxhimi i rrezikut në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës është i orientuar drejt arritjes së objektivave të Bankës Qendrore të përcaktuara me Ligj.

Menaxhimi i rrezikut është proces i përgjithshëm i identifikimit, analizimit, vlerësimit, raportimit dhe monitorimit të rrezikut, dhe si i tillë kryhet në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës sipas Politikës për Menaxhimin e Rrezikut. Bazuar në këtë kuadër rregullues dhe strategjinë e saj, aktivitetet e BQK-së lidhur me menaxhimin e rrezikut kanë pasur qëllim të:

- Mirëmbajtjes dhe zhvillimit të mëtejshëm të kornizës për menaxhim të rrezikut për të siguruar arritjen e objektivave strategjike të BQK-së;
- Avancimit të procesit për identifikim, vlerësim, raportim dhe monitorim të rrezikut operacional duke zhvilluar më tej metodologjinë për vlerësim të rrezikut dhe duke zhvilluar instrumente që do të ndihmojnë implementimin e metodologjisë; dhe
- Integritet në të gjitha nivelet e strukturës organizative të Bankës Qendrore;

BQK-ja ka bërë vlerësimin dhe monitorimin e rreziqeve të raportuara nga procesi i vetë-vlerësimit të rrezikut nga të gjitha njësitë organizative të saj. Gjithashtu, BQK-ja ka kryer aktivitetin e vlerësimit të rreziqeve për njësi të caktuara organizative, të cilat kanë aktivitetet të rëndësishme dhe operacione të ndërlikueshme. Rezultati i vlerësimeve të rrezikut operacional dhe niveli i përgjithshëm i rrezikut është raportuar në baza tremujore në Bordin Ekzekutiv.

Me qëllim të zhvillimit të vazhdueshëm profesional, stafi i BQK-së është anëtarësuar në organizata profesionale ndërkombëtare, siç janë Instituti për Menaxhim të Rrezikut Operacional – ORMI, Instituti për Menaxhim të Rrezikut – IRM, Instituti i Auditorëve të Brendshëm–The IIA dhe ISACA, të cilat promovojnë zhvillimin e menaxhimit të rrezikut, në përgjithësi, dhe atij operacional në veçanti.

Gjithashtu, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës i është bashkangjitur IORWG-së, Grup Punues Ndërkombëtarë për Rrezikun Operacional. Kjo organizatë është e hapur për të gjitha Bankat Qendrore dhe Autoritet Monetare/Mbikëqyrëse dhe sot ka 95 anëtarë. BQK-ja, si pjesë e këtij Grupi do të përfitojë nga pjesëmarrja aktive në grupet punues dhe adoptimi i praktikave të avancuara të menaxhimit të rrezikut operacional që Grupi i zhvillon për industrinë e bankave qendrore.



## 8. Marrëdhëniet me jashtë dhe bashkëpunimi ndërkombëtar

### 8.1. Marrëdhëniet Ndërkombëtare

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK), në mënyrë intensive ka vazhduar të avancojë bashkëpunimin ndërkombëtar në kuadër të funksioneve dhe përgjegjësisë të saj.

Kryesuar nga Guvernatori Mehmeti, BQK ka realizuar bashkëpunime dhe takime produktive me institucione financiare ndërkombëtare: Fondin Monetar Ndërkombëtar (FMN), Bankën Botërore (BB), Bankën Qendrore Evropiane (ECB), Autoritetin Bankar Evropian (EBA), Agjencinë e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID), Komisioni Evropian (EC), Deutsche Bundesbank, Autoritetet e Mbikëqyrjes Federale Gjermane, Autoritetin e Mbikëqyrjes Austriake, Bankën e Turqisë dhe me institucione tjera.

Përfaqësuesit e BQK-së të udhëhequr nga Guvernatori Mehmeti, ishin pjesë e delegacionit të Republikës së Kosovës në takimet e rregullta si takimi Pranveror i FMN-së dhe BB-së, dhe takimet vjetore të Bordit të Guvernatorëve të këtyre institucioneve, të mbajtura në Uashington dhe në Bali të Indonezisë. Delegacioni i kryesuar nga Guvernatori Mehmeti, i cili përfaqëson Republikën e Kosovës në FMN, zhvilloi takime me zyrtarët më të lartë të Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe të Bankës Botërore, zyrtarë të Departamentit të Thesarit Amerikan, si dhe me përfaqësues të institucioneve tjera financiare ndërkombëtare. Gjatë këtyre ngjarjeve, delegacioni zhvilloi edhe një sërë takimesh me homologë të Bankave Qendrore të vendeve të ndryshme të botës.

Në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar, BQK-ja ka avancuar marrëveshjet bilaterale me institucionet ndërkombëtare gjatë vitit 2018, ku është arritur nënshkrimi i dy memorandumeve të bashkëpunimit me Bankën Qendrore Evropiane dhe Bankën e Turqisë.

Gjatë këtij viti, Guvernatori Mehmeti realizoi vizitë në Gjermani ku zhvilloi takime me zyrtarë të nivelit të lartë të Bundesbankës, me të cilët u diskutuan zhvillimet e fundit ekonomike e financiare të të dy vendeve. Gjithashtu, gjatë kësaj vizite, Guvernatori Mehmeti zhvilloi takim edhe me Presidentin e Autoritetit Federal Mbikëqyrës Financiar (BaFin).

Guvernatori Mehmeti mori pjesë edhe në Forumin e Evropës Qendrore dhe Lindore, i organizuar nga Euro Money Center në Vjenë, ku morën pjesë guvernatorë, ministra të financave dhe përfaqësues të institucioneve financiare. Në kuadër të këtij Forumi, takime të veçanta u realizuan me Drejtorin Menaxhues të Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), dhe përfaqësuesit e nivelit më të lartë të Raiffeisen Bank International në Vjenë.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, gjatë vitit 2018 është përfaqësuar edhe në aktivitetet e organizuara nga bankat homologe, si:

- Takimin e Guvernatorëve të Regjionit dhe Udhëheqësve të Sektorit Financiar, i mbajtur më 26-27 mars 2018 në Rovinj të Kroacisë, në të cilin u diskutua lidhur me fokusin në sfidat e politikës monetare, sfidat e ekonomisë të ndërlidhur me normalizimin e politikës monetare dhe zgjidhjen e problemit të kredive joperformuese të akumuluar. Në këtë takim, Guvernatori Mehmeti ishte pjesë e panelit të guvernatorëve.
- Konferencën e shtatë vjetore hulumtuuese, e mbajtur me 12-13 prill 2018 në Ohër të Maqedonisë së Veriut, dhe e organizuar nga Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut, e titulluar: “Rreth një dekadë pas krizës – drejt ciklit të ri global dhe normalizimit të politikës monetare”, ku Guvernatori Mehmeti ishte pjesëmarrës në panelin e guvernatorëve, si folës kryesor.
- Samitin e Ministrave të Financave, Guvernatorëve të Bankave Qendrore dhe Drejtorëve të Administratave Tatimore, e mbajtur me 13-15 qershor 2018, organizuar nga Banka Qendrore

e Malit të Zi. Në këtë Samit, si pjesë e panelit ishte Guvernatori Mehmeti, ku u diskutua tema “Stabiliteti financiar dhe monetar në rajon, dhjetë vjet pas krizës financiare globale”.

- Konferencën e tetë me temën “Misteri i Rritjes së Produktivitetit të Ulët në Evropë”, në Poloni, të mbajtur më 26 tetor 2018, e organizuar nga Banka e Polonisë, përfaqësuar nga zëvendësguvernatori për Operacione Bankare, z. Ismajli.
- Konferencën vjetore të organizuar më 1 nëntor 2018 nga Banka e Shqipërisë dhe Shkolla Ekonomike dhe e Shkencave Politike të Londrës (London School of Economics and Political Science) me temën Politika Monetare, Integrimi Ekonomik dhe “Normaliteti i Ri”, në të cilën BQK-ja u përfaqësua nga Zëvendësguvernatori për Mbikëqyrje Financiare z. Havolli.

Gjatë kësaj periudhe, BQK-ja u vizitua nga delegacione dhe zyrtarë të lartë të institucioneve financiare vendore dhe ndërkombëtare, ambasadorë të akredituar në vend dhe zyrtarë tjerë të lartë të institucioneve.

Përpos tjerash, BQK-ja ishte pjesë e rëndësishme e ngjarjeve ekonomike dhe financiare të organizuara në Kosovë nga institucione të ndryshme vendore, si:

- Më 15 shkurt 2018, me rastin e shënimit të 10 vjetorit të Pavarësisë së Republikës së Kosovës, Guvernatori Mehmeti, mori pjesë në konferencën “Zhvillimi i profesionit të kontabilitetit dhe auditimit në dekadën e parë të Pavarësisë”, e organizuar nga Shoqata e Kontabilistëve të Certifikuar dhe Auditorëve të Kosovës (ShKÇAK).
- Më 16 shkurt 2018, Guvernatori Mehmeti mori pjesë në Forumin Ekonomik “10 Vjetori i Pavarësisë Ekonomike të Kosovës” i cili u organizua nga Oda Ekonomike e Kosovës, në të cilën Guvernatori Mehmeti ishte pjesë e panelit kryesor të këtij organizimi.
- Më 5 dhjetor 2018, Guvernatori Mehmeti gjithashtu mori pjesë në Konferencën Vjetore të Bankave të Kosovës të organizuar nga Shoqata e Bankave të Kosovës me temën “Financimi i zhvillimit: Bankat për një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik të Kosovës”.

## 8.2. Komunikimi dhe Edukimi Financiar

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, në kuadër të funksioneve dhe përgjegjësi të saj, vazhdoi të informojë publikun e gjerë në mënyrë transparente dhe të vazhdueshme mbi aktivitetet e saj dhe zhvillimet në sektorin financiar. BQK-ja në bashkëpunim me mediat vendore ka informuar qytetarët përmes aktiviteteve të ndryshme si: publikimit të kumtesave në ueb-faqen dhe nënfaqen e saj; përgjigjeve në pyetjet e gazetarëve; përgjigjeve në pyetjet e qytetarëve; pjesëmarrjes në emisione dhe debate televizive, përfaqësimet në radio; organizimin e konferencave për shtyp; si dhe postimeve në rrjetet sociale dhe kanalën zyrtar në youtube. Përmes këtyre kanaleve, gjatë vitit 2018, BQK-ja iu është përgjigjur mediave dhe kërkesave të qytetarëve.

Informimi dhe bashkëpunimi me publikun ka vazhduar të realizohet gjithashtu përmes ueb-faqes zyrtare të BQK-së [www.bqk-kos.org](http://www.bqk-kos.org), ku publikohen informata dhe të dhëna ekonomike e financiare mbi rolin dhe kontributin e BQK-së dhe zhvillimeve ekonomike e financiare në vend. Në kuadër të zgjerimit të komunikimit, BQK-ja ka avancuar dhe ngritur nivelin e komunikimit edhe përmes kanaleve si facebook dhe youtube.

Në kuadër të Programit të Edukimit Financiar, BQK-ja është angazhuar dhe ka zgjeruar aktivitetet e edukimit financiar duke targetuar grupe të ndryshme të publikut, me fokus të veçantë të rinjtë dhe fëmijët. Me qëllim të ngritjes së njohurive ekonomike dhe financiare, BQK-ja ka për objektiv prezantimin e rolit dhe funksioneve kryesore të BQK-së dhe avancimin e informatave dhe njohurive për produktet dhe shërbimet e sektorit financiar.



Në kuadër të bashkëpunimit me institucionin Financat Ndërkombëtare për Fëmijë dhe të Rinj /Child and Youth Finance International (CYFI), janë organizuar një numër aktivitete rreth Javës Ndërkombëtare të Parasë 2018. Java u shënua në bashkëpunim me Shoqatën e Bankave të Kosovës, me aktivitete dhe grupmosha të ndryshme. Gjatë kësaj jave janë zhvilluar aktivitete edukative dhe ligjërata, të mbajtura nga Guvernatori, Zëvendësguvernatori dhe anëtarë tjerë të menaxhmentit të lartë të BQK-së. Aktivitetet filluan me nxënës të ciklit të ulët arsimor, dhe vazhduan me mbajtjen e ligjëratave në Universitete të ndryshme për “Rolin dhe funksionet e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës”, në Universitetin “Kadri Zeka” në Gjilan, “Tregjet Financiare dhe Tregun e Letrave me Vlerë” në Kolegjin UBT, si dhe ligjëratë në Universitetin “Haxhi Zeka” në Pejë. Gjatë vitit janë mbajtur po ashtu edhe aktivitete dhe ligjërata të tjera në kolegje dhe universitete të ndryshme.

BQK-ja ka lansuar edhe platformën e Edukimit Financiar të BQK-së <https://bqk-kos.org/edu/>, e cila përmban informata për grupe të ndryshme të publikut: nxënës, të rinj, studentë dhe konsumatorë të produkteve/shërbimeve financiare. Platforma do të vazhdojë në vijimësi të plotësohet me materiale dhe aktivitete edukative shtesë.

Gjatë kësaj periudhe janë mbajtur edhe dy seminare me gazetarë, seminari në bashkëpunim me Shoqatën e Bankave të Kosovës dhe seminari dyditor me përfaqësues të të gjitha mediave vendore.

Në kuadër të vitit mbarëkombëtar të Skënderbeut, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës në bashkëpunim me Bankën e Shqipërisë organizuan Ekspozitën 3 ditore “Gjergj Kastrioti Skënderbeu në monedhën dhe kartëmonedhën shqiptare”. Përveç thesarit numizmatik, në ekspozitë u prezantuan edhe produktet e edukimit financiar të të dyja bankave qendrore, duke prezantuar kështu një shkrirje në mes të numizmatikës, historisë dhe edukimit. Ekspozita është vizituar nga qytetarë, nxënës dhe personalitete të larta shtetërore nga Kosova, Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut.

Në funksion të nxitjes së hulumtimeve mes ekonomistëve të rinj të Kosovës, BQK-ja ndau çmimin tradicional “Ekonomist të rinj”, për hulumtimet më të mira nga domeni i sektorit financiar dhe zhvillimit ekonomik në Kosovë.

BQK-ja gjatë vitit 2018 është vizituar nga studentë e nxënës të institucioneve arsimore, të cilët janë informuar për së afërmi me rolin dhe funksionet e BQK-së dhe për të cilët janë realizuar prezantime me tema të ndryshme varësisht nga kërkesa e tyre.

Dita Botërore e Kursimeve, është aktivitet vjetor i cili u shënua edhe këtë vit nga BQK-ja, përmes aktiviteteve edukative dhe vizitave të nxënësve të BQK. Gjatë këtij viti, BQK-ja gjithashtu ishte prezente në disa programe televizive duke prezantuar çështje të ndryshme të Edukimit Financiar. Gjithashtu, BQK-ja ka përgatitur broshura dhe materiale edukative të cilat u janë dhuruar nxënësve dhe studentëve në ngjarje dhe aktivitete të ndryshme të organizuara nga BQK-ja.

### **8.3. Asistenca Teknike**

BQK-ja ka vazhduar të ketë bashkëpunim me Institucionet Financiare Ndërkombëtare si dhe me bankat qendrore dhe agjencitë rregullatore si në nivel rajonal ashtu edhe ndërkombëtar. Kryesisht gjatë vitit 2018 bashkëpunim më intenziv është realizuar me institucionet ndërkombëtare si: FMN, BB, BQE, Thesari Amerikan, BERZH, GIZ etj.

#### **Banka Botërore (BB)**

Në kuadër të bashkëpunimit dhe mbështetjes nga Banka Botërore në vitin 2018 mbështetja për BQK-në ka qenë e fokusuar në rishikimin e kornizës ligjore/rregullative për mundësimin e licencimit dhe rregullimit të institucioneve dhe aktivitetit të parasë elektronike dh, si dhe

rishikimin e kornizës ligjore për funksionimin e agjentëve në mënyrë që të krijohen lehtësira dhe të arrihet një shpërndarje më e gjerë e shërbimeve të pagesave/remitencave përmes agjentëve.

Studimi i fizibilitetit për themelimin e një operatori / SWITCH-i kombëtar për procesimin e pagesave me kartelë dhe forma tjera (me anë të telefonit mobil) brenda Kosovës (National Payment Card SWITCH), gjithashtu ka qenë projekt i përbashkët i bashkëpunimit të BQK-së dhe BB-së.

BB-ja ka mbështetur BQK-në lidhur me trajnimin e stafit e , sa i përket aplikimit të parimeve të PFMI – IOSCO/BIS PFMI – BIS/IOSCO (Principles for Financial Market Infrastructures Bank for International Settlements and International Organization of Securities Commissions) për vlerësimin e sistemeve të pagesave të rëndësisë sistemike.

Gjithashtu është realizuar Studimi lidhur me vlerësimin e kostos për pagesat me vlerë të vogël për ofruesit e shërbimeve të pagesave (BQK, bankat, IFJB-të për pagesa) dhe për përdoruesit e shërbimeve të pagesave (Institucionet qeveritare, bizneset, konsumatorët).

### **Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim – (BERZH)**

BERZH-i ka mbështetur BQK-në me asistencë teknike rreth projekteve të shumta në vazhdimësi, dhe gjatë vitit 2018 kjo mbështetje ishte kryesisht e fokusuar në: Hartimin e kornizës ligjore dhe rregullative të rimëkëmbjes, përmbylljes dhe likuidimit bankar (recovery and resolution), si dhe Hartimin e kornizës rregullative mbi aktivitetin e faktoringut.

### **Thesari Amerikan (THA)**

Që nga themelimi i BQK-së, Thesari Amerikan i ka ofruar mbështetje dhe përkrahje BQK-së qoftë përmes asistencave teknike apo edhe realizimit të projekteve të veçanta. Gjatë vitit 2018 kjo asistencë ishte kryesisht e fokusuar në mbështetjen e draftimit të ligjit të ri për banka.

Gjithashtu, në kuadër të mbështetjes së pranuar nga thesari amerikan për fuqizimin e kornizës ligjore dhe institucionale për avancimin e vlerësimit të pronave të paluajtshme në Kosovë, BQK-ja është përkrahur nga Thesari Amerikan përmes asistencës teknike lidhur me amandamentimin e Rregullores për vlerësimin e pronave të paluajtshme.

### **Unioni Evropian (UE)**

Gjatë vitit 2018 BQK-ja u bë pjesë e dy projekteve në kuadër të fondeve të IPA-së “Projekti kundër kimit ekonomik (PECK II)”, i financuar nga Këshilli i Evropës dhe Zyra e Bashkimit Evropian, dhe projekti “Mbështetje e mëtutjeshme e institucioneve të Kosovës në luftë kundër Kimit të organizuar, korrupsionit dhe ekstremizmit të dhunshëm”. Përfitimi nga këto projekte ka qenë kryesisht në trajnim dhe vetëdijësim, si dhe në hartimin e legjislacionit të fushës përkatëse.

### **GIZ (Gesellschaft fuer Internationale Zusammenarbeit GmbH – Kosovo)**

GIZ-i gjatë vitit 2018 ofroi mbështetje për BQK-në, rreth organizimit të punëtorisë me karakter ndërkombëtar e me pjesëmarrje të zyrtarëve bankarë të vendeve të rajonit dhe të ekspertëve nga Banka Qendrore Evropiane, Fondi Monetar Ndërkombëtar, BAFIN, Deutsche Bundesbank, Single Resolution Board dhe ekspert nga disa banka të vendeve tjera anëtare të BE-së. Punëtorja e mbështetur nga GIZ me temën “Ballkani Perëndimor: Reforma dhe implementimi i rregullimit bankar - sfidat në të ardhmen” u mbajt në Prevallë më 6 dhe 7 shtator 2018.

## **8.4. Integrimet Evropiane**

Me synim të realizimit të perspektivës së vendit për anëtarësim në Bashkimin Evropian (BE), Banka Qendrore e Republikës së Kosovës edhe këtë vit ka vazhduar të përmbushë obligimet e saj në kuadër të procesit të integritimit evropian.

Monitorimi i zhvillimeve kryesore legislative dhe praktikave mbikëqyrëse, respektivisht harmonizimi i legjislacionit të BQK-së me ACQUIS, si dhe zhvillimet e fundit makroekonomike janë raportuar në vazhdimësi përmes dokumenteve raportuese, si dhe takimeve me palët vendore dhe ndërkombëtare të përfshira në procesin e integritit evropian në Kosovë.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës gjatë gjithë vitit 2018 ka bashkëpunuar me institucionet relevante duke ofruar mbështetje të vazhdueshme, për ta avancuar procesin e integritit evropian në Kosovë. Rol të rëndësishëm në këtë fushë ka bashkëpunimi me Ministrinë e Integritimeve Evropiane, e cila është bartëse e procesit të integritit evropian të Kosovës.

BQK-ja gjithashtu ka pasur bashkëpunim edhe me ministri dhe institucione tjera, si: Ministrinë e Punëve të Jashtme, Ministrinë e Financave, Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, si dhe Zyrën e BE-së në Prishtinë.

BQK-ja gjatë gjithë vitit 2018 ka vazhduar raportimet e rregullta me qëllim të realizimit të konkluzioneve në kuadër të strukturave të Stabilizim Asociimit.

Gjatë kësaj periudhe, BQK-ja ka raportuar në kuadër të Nënkomitetit për Tregun e brendshëm dhe mbrojtje të konsumatorit si dhe Nënkomitetin për ekonomi, çështje financiare dhe statistika.

BQK-ja po ashtu ka raportuar edhe për takimin e Këshillit të Stabilizim Asociimit, duke raportuar te Qeveria e Republikës së Kosovës për këtë takim. Këto dokumente janë pjesë e qëndrimit zyrtar shtetëror (Position Paper), ku prezantohet progresi dhe të arriturat në fushat e caktuara (përfshirë sektorin financiar).

Përpos strukturave të përbashkëta me Komisionin Evropian, BQK-ja ka raportuar në baza të rregullta edhe në kuadër të Planit Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (PKZMSA). Në këtë kontekst, BQK-ja ka raportuar për kapitujt përbërës të PKZMSA-së, që kanë për qëllim zbatimin e reformave që kërkohen me Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit (MSA): Kapitullin e lëvizjes së kapitalit si dhe kapitullin e shërbimeve financiare.

Kapituj të tjerë në të cilët BQK-ja në vazhdimësi ka kontribuar janë: Kapitulli i të drejtës së themelimit të kompanive dhe lirisë së ofrimit të shërbimeve, kapitulli i politikave ekonomike dhe monetare, kapitulli i statistikave, kapitulli i lirisë, sigurisë dhe drejtësisë, (neni 89 Pastrimi i parave dhe financimi i terrorizmit), si dhe kapitullin e kontrollit financiar.

BQK-ja ka përgatitur Inputin për Raportin për Komisionin Evropian (KE) dhe në përputhje me afatet e parapara, janë ofruar inputet e kërkuara nga ky Komision. Inputet janë formë uniforme e raportimit për të gjitha vendet candidate dhe candidate potenciale, të cilat mbulojnë zhvillime specifike gjatë gjithë vitit, ku janë raportuar zhvillimet kryesore ligjore nëpërmjet pyetësorit të hartuar nga Komisioni Evropian për të gjitha fushat e kriterëve politike dhe ato të ACQUIS-së.

Në fund vit është bërë edhe përgatitja e draftit të konsoliduar të PKZMSA-së, në të cilin draft, BQK-ja ka bërë një përmbledhje të legjislacionit primar dhe akteve sekondare të cilat pritet të aprovohen gjatë vitit vijues. Propozimet legislative derivojnë nga kërkesat e takimeve me anëtarët e Komisionit Evropian. Bazuar në këtë, drafti i PKZMSA-së përmban legjislacion primar dhe sekondar që transponon direktiva apo që përmban sugjerime të caktuara nga Komisioni Evropian.

Raportet për vendin të KE-së kanë vlerësuar kontributin e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës në drejtim të konsolidimit të stabilitetit makroekonomik, ruajtjes së stabilitetit financiar, përmirësimit të praktikave mbikëqyrëse dhe të përmirësimit të sistemit të pagesave në Republikën e Kosovës. BQK-ja edhe më tej mbetet e angazhuar në realizimin e reformave prioritare strukturore që do t'i kontribuojnë edhe më shumë arritjes së standardeve të kërkuara nga Bashkimi Evropian. Në të njëjtën kohë, BQK-ja vazhdon të ketë një rol të rëndësishëm duke kontribuar në realizimin e agjendës së Integritimeve Evropiane të Republikës së Kosovës.



## 9. Pasqyrat financiare të BQK-së





## **Banka Qendrore e Republikës së Kosovës**

### **Pasqyrat Financiare**

**më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018**

Përmbajtja	Faqe
Raporti i Auditorit të Pavarur	3-4
Pasqyra e gjendjes financiare	5
Pasqyra gjithëpërfshirëse e të ardhurave	6
Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet	7
Pasqyra e rrjedhjes së parasë	8
Shënime për pasqyrat financiare	9 - 44



## RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR

### Për Menaxhmentin e Bankës Qëndrore të Republikës së Kosovës

#### Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Bankës Qëndrore të Republikës së Kosovës (“Banka”), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2018, pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe e të ardhurave tjera gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e rrjedhës së parasë për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2018, si dhe shënimet për pasqyrat financiare, duke përfshirë një përmbledhje të politikave të rëndësishme të kontabël.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare të bashkangjitura paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Bankës më 31 dhjetor 2018, performancën financiare dhe rrjedhën e parasë për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2018 në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

#### Bazat për opinion

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar më tej në seksionin e raportit tonë për përgjegjësitë e auditorit në auditimin e pasqyrave financiare. Ne jemi të pavarur nga Banka në përputhje me Bordin e Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Kodin e Etikës të Kontabilistëve për Kontabilistët Profesionistë (Kodi IESBA) dhe me kërkesat etike që janë relevante për auditimin e pasqyrave financiare në Kosovë, dhe ne kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që ne kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë.

#### Përgjegjësia e Menaxhmentit dhe e personave të ngarkuar me qeverisje për Pasqyrat Financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF, dhe për një kontrollë të tillë që konsiderohet e nevojshme nga menaxhmenti për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare pa anomali materiale të shkaktuara nga mashtrimi apo gabimi.

Gjatë përgatitjes së pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Bankës për të vazhduar me tutje, duke shpalosur, nëse e aplikueshme, çështje që lidhen me vazhdimësinë e biznesit dhe përdorë parimin e vazhdimësisë së biznesit, përveç kur menaxhmenti ka për qëllim të likuideojë bankën ose të ndërpresë operacionet, ose nuk ka ndonjë mundësi tjetër përveç se të veprojë në këtë mënyrë.

Të ngarkuarit me qeverisje janë përgjegjës për mbikqyrjen e procesit të raportimit financiar të Bankës.

## Përgjegjësitë e auditorit në auditimin e pasqyrave financiare

Qëllimi jonë është marrja e sigurisë së arsyeshme që pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë si pasojë e mashtrimeve ashtu edhe e gabimeve dhe lëshimit të një raporti të auditorëve i cili përmban opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk është garancion i asaj që një auditim i kryer në përputhje me SNA, do të detektojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomali mund të lindin nga mashtrimet ose gabimet dhe konsiderohen materiale nëse individualisht, ose të bashkuara, mund të pritet në mënyrë të arsyeshme që të ndikojnë në vendimet ekonomike të shfrytëzuesve të pasqyrave financiare, të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA, ne ushtrojmë gjykim profesional dhe ruajmë skepticizëm profesional gjatë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë riskun e anomalive materiale të pasqyrave financiare, si pasojë nga mashtrimet apo edhe si pasojë e gabimeve, dizajnojmë dhe kryejmë procedura të auditimit të cilat i përgjigjen këtyre risqeve dhe marrim evidenca të auditimit të cilat janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Risku i mos-zbulimit të një anomalie materiale e cila rrjedhë nga mashtrimi është më i madh sesa i atij që rrjedhë nga gabimi, pasi që mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, lëshime të qëllimshme, keqinterpretime, ose shkelje të kontrollit të brendshëm
- Marrim një kuptim të kontrollit të brendshëm i cili është i rëndësishëm për auditimin në mënyrë që të dizajnohen procedura të auditimit të cilat janë të përshtatshme për rrethanat, por jo për qëllim të shprehjes së një opinionit lidhur me efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Bankës.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të përdorura të kontabilitetit dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël dhe shpalosje të ngjashme të bëra nga menaxhmenti.
- Bazuar në evidencën e siguruar, vendosim mbi përshtatshmërinë e shfrytëzimit të parimit të vazhdimësisë së biznesit dhe nëse një pasiguri materiale egziston në lidhje me ngjarjet ose kushtet që mund të vënë në dyshim aftësinë e Bankës për të vazhduar me tutje. Nëse ne konkludojmë se një pasiguri materiale egziston, jemi të detyruar të tërheqim vëmendje në raportin tonë lidhur me këtë shpalosje në pasqyrat financiare, ose nëse shpalosjet e tilla nuk janë të duhurat, të modifikohet opinionin jonë. Përfundimet tona janë të bazuara në evidencën e auditimit të mbledhur deri me datën e raportit financiar. Sidoqoftë, kushtet ose ngjarjet në të ardhmen, mund të shkaktojnë që Banka të ndërprejë vijueshmërinë e biznesit.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, duke përfshirë dhënien e informacioneve shpjeguese dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në një mënyrë që arrin paraqitje të drejtë.

Ne komunikojmë me ata që janë të ngarkuar me qeverisjen, mes tjerash, fushëveprimin e planifikuar dhe kohën e auditimit si dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, duke përfshirë çdo mangësi të rëndësishme në kontrollat e brendshme të cilat i identifikojmë gjatë auditimit.

Deloitte Kosova Sh.p.k.

Rr. Lidhja e Pejës, Nr. 177  
Prishtinë, Republika e Kosovës  
Nr. Unik identifikues.: 810468373  
20 maj 2019



Partnere e angazhimit:  
Arta Limani

# Banka Qendrore e Republikës së Kosovës


## Pasqyra e gjendjes financiare

Më 31 dhjetor të vitit 2018

<i>Në mijë Euro</i>	<b>Shënim</b>	<b>2018</b>	<b>2017</b>
<b>Aktivët</b>			
Paraja e gatshme	7	285,376	188,547
Llogaritë rrjedhëse me bankat e huaja	8	34,797	422,845
Letra me vlerë (Bono thesari dhe Obligacione Qeveritare)	9	758,890	592,712
Depozita me bankat e huaja	10	183,734	67,342
Mjetet e ndërlidhura me FMN	11	326,051	325,764
Prona dhe pajisjet	12	5,016	5,329
Aktive të paprekshme	13	1,790	2,065
Aktive tjera	14	1,411	9,101
<b>Gjithsej aktivët</b>		<b>1,597,065</b>	<b>1,613,705</b>
<b>Detyrimet</b>			
Detyrime ndaj bankave komerciale në vend	15	343,394	331,826
Detyrime ndaj llogarive të ndërlidhura me FMN-në	16	321,854	318,616
Detyrime ndaj institucioneve qeveritare	17	762,901	811,341
Detyrime ndaj institucioneve publike dhe komerciale	18	110,863	95,807
Detyrime nga huamarrja/et	19	2,266	2,266
Detyrime të tjera vendore	20	1,797	2,047
<b>Gjithsej detyrimet</b>		<b>1,543,075</b>	<b>1,561,903</b>
<b>Kapitali dhe rezervat</b>			
Kapitali i autorizuar	21	30,000	30,000
Fondi i rezervave	21a	21,802	22,683
Rezerva nga rivlerësimi		-	-
Neto rezultati (fitimet e mbajtura)		2,188	(881)
<b>Gjithsej kapitali dhe rezervat</b>		<b>53,990</b>	<b>51,802</b>
<b>Gjithsej detyrimet, kapitali dhe rezervat</b>		<b>1,597,065</b>	<b>1,613,705</b>

Këto pasqyra financiare të shpalosura në faqet 4 deri në 44 janë miratuar nga menaxhmenti i BQK-së më 20 maj 2019 dhe është nënshkruar në emër të tij nga:

  
Fehmi Mehmeti  
Guvernator

  
Faton Ahmetaj  
Drejtore për Planifikim dhe  
raportim financiar

Shënimet nga 1 deri 33 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare

# Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Pasqyra gjithëpërfshirëse e të ardhurave

Më 31 dhjetor të vitit 2018

<i>Në mijë Euro</i>	<b>Shënim</b>	<b>2018</b>	<b>2017</b>
<b>Të ardhurat nga interesi</b>			
Të ardhurat nga interesi		2,826	2,002
Shpenzimet nga interesi		(982)	(1,036)
<b>Të ardhurat neto nga interesi</b>	22	<u>1,844</u>	<u>966</u>
<b>Të ardhurat nga tarifat dhe ndalesat</b>			
Të ardhurat nga tarifat dhe ndalesat		2,252	2,101
Shpenzimet nga tarifat dhe ndalesat		(332)	(370)
<b>Të ardhurat neto nga tarifat dhe ndalesat</b>	23	<u>1,920</u>	<u>1,731</u>
<b>Të ardhurat nga aktiviteti rregullativ dhe të ardhurat tjera operative</b>			
Të ardhurat nga aktiviteti rregullativ	24	4,451	4,178
Të ardhurat nga grantet	25	98	106
Të ardhurat tjera operative	26	11	6
Fitimi / (humbja) nga kursi i këmbimit	29	527	(1,225) <sup>1</sup>
<b>Të hyrat operative</b>		<u>8,851</u>	<u>5,762</u>
<b>Shpenzimet administrative (operative)</b>			
Shpenzimet personelit	27	(4,407)	(4,453)
Zhvlerësimi dhe amortizimi	12,13	(1,029)	(978)
Shpenzimet e përgjithshme dhe administrative	28	(1,227)	(1,212)
<b>Shpenzimet administrative (operative)</b>		<u>(6,663)</u>	<u>(6,643)</u>
<b>Fitimi / (Humbja) vjetore</b>		<u><b>2,188</b></u>	<u><b>(881)<sup>1</sup></b></u>
Të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse			-
<b>Gjithsej të ardhurat gjithëpërfshirëse për vitin</b>		<u><b>2,188</b></u>	<u><b>(881)</b></u>

Shënimet nga 1 deri 33 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare

<sup>1</sup> Fitimi / (humbja) vjetore për vitin 2018 nëse e përjashtojmë efektin e humbjes nga ndryshimi në kursin e këmbimit valutor (përkatësisht shumën 1,225 mijë euro) është **344 mijë euro**. Ky njëherit paraqet e dhe fitimin operativ faktik për vitin 2018.

Humbja nga ndryshimi i "kursit të këmbimit" është pozicioni i përkohshëm jo-operativ i rrjedhë nga zërat në valutë jo euro (USD dhe DVT-SDR), të cilët me datën e raportimit duhet të raportohen në shumën euro ekuivalente të tyre, sipas kursit valutor në datën e raportimit. Me ndryshimin e kursit të këmbimit valutor rrjedhin edhe diferenca (qoftë fitim ose humbje), që si të tilla vetëm barazojnë zërat bilancor-vlerat ekuivalentë, por që nuk janë realizime faktike (në rastin tonë humbje/shpenzimi jo-faktikë për vitin 2018 është shuma prej 1,225 mijë euro). Një shpalosje me analitike do të pasqyrohet të **shënim 29** faqe 43.

# Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

	Kapitali	Fondi rezervë	Rezervat e rivlerësimit	Fitimet e mbajtura (Neto Rezultatati/et)	Gjithsej
<i>Në mijë Euro</i>					
<b>Gjendja më 1 janar 2018</b>	<b>30,000</b>	<b>22,683</b>	-	<b>(881)</b>	<b>51,802</b>
Transferimi në fondin rezervë	-	(881)	-	881	-
<b>Gjithsej transaksionet e kërkuara me ligj</b>	-	<b>(881)</b>	-	<b>881</b>	-
Fitimi për vitin	-	-	-	2,188	2,188
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-	-	-
<b>Gjithsejt të ardhurat gjithëpërfshirëse për vitin</b>	-	-	-	<b>2,188</b>	<b>2,188</b>
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2018</b>	<b>30,000</b>	<b>21,802</b>	-	<b>2,188</b>	<b>53,990</b>
<b>Gjendja më 1 janar 2017</b>	<b>30,000</b>	<b>21,023</b>	-	<b>1,660</b>	<b>52,683</b>
Transferimi në fondin rezervë	-	1,660	-	-1,660	-
<b>Gjithsej transaksionet e kërkuara me ligj</b>	-	<b>1,660</b>	-	<b>-1,660</b>	-
Fitimi për vitin	-	-	-	(881)	(881)
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-	-	-
<b>Gjithsejt të ardhurat gjithëpërfshirëse për vitin</b>	-	-	-	<b>(881)</b>	<b>(881)</b>
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2017</b>	<b>30,000</b>	<b>22,683</b>	-	<b>(881)</b>	<b>51,802</b>

Shënimet shoqëruese nga 1 deri 33 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare

# Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

## Pasqyra e rrjedhjes së parasë

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

<i>Në mijë Euro</i>	<b>Shënim</b>	<b>2018</b>	<b>2017</b>
<b>Rrjedhja parave nga aktivitetet operacionale</b>			
Fitimi vjetor		2,188	(881)
<i>Rregullime për:</i>			
Zhvlerësimin	12	657	615
Amortizimin	13	372	363
Të ardhurat nga grantet	25	(99)	(105)
Fitimi nga shitja e pajisjeve		-	-
Të ardhurat nga interesi	22	(2,826)	(2,002)
Shpenzimet nga interesi	22	982	1,036
		<b>1,274</b>	<b>(974)</b>
Ndryshime në bono thesari		(162,114)	(25,441)
Ndryshime në depozita me bankat e huaja		(114,999)	135,000
Ndryshime në mjetet e ndërlidhura me FMN		(147)	(49,880)
Ndryshime në aktive të tjera		7,690	(7,817)
Ndryshime në detyrimet ndaj bankave komerciale në vend		11,568	35,427
Ndryshime në detyrimet ndaj llogarive të të ndërlidhura me FMN-në		3,093	35,288
Ndryshime në detyrimet ndaj institucioneve qeveritare		(48,439)	92,905
Ndryshime në detyrimet ndaj institucioneve publike dhe komerciale		15,055	36,941
Ndryshime në huamarrja/et		-	133
Ndryshime në detyrimet e tjera vendore		(152)	109
		(287,171)	251,691
Interesa të marra		(1,372)	(2,344)
Interesa të paguara		(837)	(717)
<b>Paraja neto e gjeneruar nga/(përdorur në) aktivitetet operacionale</b>		<b>(289,380)</b>	<b>248,630</b>
<b>Rrjedhja e parave nga aktivitetet investuese</b>			
Të hyrat nga shitja e pajisjeve		-	-
Blerja e pajisjeve	12	(364)	(1,461)
Blerja e aktiveve të paprekshme	13	(77)	(157)
<b>Paraja neto e përdorur në aktivitetet investuese</b>		<b>(441)</b>	<b>(1,618)</b>
<b>Rrjedhja e parave nga aktivitetet investuese</b>			
Të hyrat nga grantet		-	5
<b>Paraja neto e gjeneruar nga aktivitetet financuese</b>		<b>-</b>	<b>5</b>
<b>Rritja/(zbritja) neto në para dhe ekuivalentet e saj</b>		<b>(289,821)</b>	<b>247,017</b>
Efekti i normë së këmbimit		-	-
Paraja dhe ekuivalentët e saj më 1 janar		<b>618,728</b>	<b>371,711</b>
<b>Paraja dhe ekuivalentët e saj më 31 dhjetor</b>	<b>30</b>	<b>328,907</b>	<b>618,728</b>

Shënimet shoqëruese nga 1 deri 33 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare

# Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

## Shënimet mbi Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(në mijë Euro, nëse nuk është theksuar ndryshe)

---

### 1. Subjekti raportues

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (nga këtu e tutje "BQK" ose "Banka"), pasardhëse e Autoritetit Qendror Bankar të Kosovës, është një subjekt i pavarur juridik me kompetenca të plota si një person juridik sipas ligjit të aplikueshëm në Republikën e Kosovës. BQK është një subjekt publik i veçantë i cili ka autoritetin për të licencuar, mbikëqyrur dhe rregulluar institucionet financiare në Republikën e Kosovës. Banka vepron në përputhje me Ligjin nr. 03/L-209 për "Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës" të cilit tash e tutje i referohemi si ("Ligji për BQK-në"). Sipas këtij ligji objektivat kryesore të BQK-së janë si vijon:

- të nxisë dhe të mbajë një sistem të qëndrueshëm financiar, duke përfshirë një sistem të sigurt, të shëndetshëm dhe efikas të pagesave.
- të kontribuojë në arritjen dhe mbajtjen e stabilitetit të brendshëm të çmimeve.
- të mbështes politikatat e përgjithshme ekonomike të Qeverisë.

Siç është përshkruar në ligj, BQK duhet të veprojë në përputhje me parimet e një tregu të hapur me një konkurrencë të lirë, duke favorizuar ndarjen efikase të resurseve.

BQK vepron nga zyrat e saj që gjenden në Prishtinë. Adresa e regjistruar e zyrës së BQK-së është si më poshtë:

Rr. Garibaldi nr. 33

Prishtinë, Kosovë.

### Bordi i Bankës Qendrore, Bordi Ekzekutiv dhe Guvernatori

Organet vendimmarrëse të BQK-së janë Bordi i Bankës Qendrore, Bordi Ekzekutiv dhe Guvernatori. Sipas nenit 34, paragrafit 2, si dhe dispozitës së përkohshme të nenit 79, paragraf 2, të Ligjit për BQK-në, Bordi i Bankës Qendrore përbëhet nga Guvernatori, dhe katër<sup>2</sup> anëtar jo-ekzekutiv dhe është përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të politikave si dhe mbikëqyrjen e administrimit dhe operacioneve të BQK-së.

Më 31 dhjetor 2018, Bordi i Bankës Qendrore përbëhej nga këta anëtarë:

- Flamur Mrasori – Kryetar i Bordit (jo ekzekutivë)
- Fehmi Mehmeti – Guvernator
- Behxhet Brajshori – Anëtar (jo ekzekutivë)
- Nuhi Ahmeti – Anëtar (jo ekzekutivë)

Bordi Ekzekutiv me 31 dhjetor 2018 përbëhet nga Guvernatori, i cili është Kryesues dhe dy Zëvendësguvernatorët dhe është përgjegjës për implementimin e politikave të BQK-së dhe të operacioneve të saj.

### 2. Baza e përgatitjes

#### a) Deklarata e përputhshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF").

#### b) Baza e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur duke përdorur bazat e matjes të specifikuara nga SNRF-ja për secilin lloj të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Bazat e matjes janë shpalosur më në detaje në politikatat kontabël në shënimin 3 më poshtë.

---

<sup>2</sup> Një anëtar jo ekzekutiv është pozitë lirë për t'u plotësuar.

# Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

## Shënimet mbi Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(në mijë Euro, nëse nuk është theksuar ndryshe)

---

### 2. Baza e përgatitjes (në vazhdim)

#### c) Valuta funksionale dhe e prezantimit

Këto pasqyra financiare prezantohen në Euro ("EUR"), e cila është valuta funksionale e BQK-së, përveq nëse është specifikuar ndryshe në ndonjë shënim analitik. Nëse nuk është shënuar ndryshe, informacioni financiar i prezantuar është rrumbullakësuar në mijëshen më të afërt.

#### d) Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon nga menaxhmenti që të bëjë gjykime, vlerësime dhe supozime që ndikojnë në zbatimin e politikave dhe në shumatat e raportuara të aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet faktike mund të ndryshojnë nga ato të vlerësuara.

Vlerësimet dhe supozimet shqyrtohen në bazë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet dhe në periudhat e ardhshme nëse ato ndikohen. Në veçanti, informatat në lidhje me fushat e rëndësishme të vlerësimit të pasigurisë dhe vendimeve të rëndësishme për zbatimin e politikave kontabël që kanë ndikimin më të konsiderueshëm në shumatat e pranuar në pasqyrat financiare janë përshkruar më poshtë në shënimin 5.

Politikat kontabël të paraqitura më poshtë janë zbatuar në mënyrë të qëndrueshme në të gjitha periudhat e prezantuara në këto pasqyra financiare.

### 3. Politikat e rëndësishme kontabël

#### a) Transaksionet në valutë të huaj

Transaksionet në valutë të huaj vlerësohen në valutën funksionale me kursin e këmbimit në datat e kryerjes së transaksioneve. Pasuritë dhe detyrimet monetare të shprehura në valutë të huaj rivlerësohen me kursin zyrtar të këmbimit të asaj date. Fitimi apo humbja nga valutat e huaja për zërat monetarë është diferenca ndërmjet kostove të amortizuara në valutën funksionale në fillim të periudhës, e rregulluar me interesin efektiv dhe pagesat gjatë periudhës, dhe kostove të amortizuara në monedhë të huaj të rivlerësuara me kursin e këmbimit në fund të periudhës. Aktivitetet dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj që maten me vlerë të drejtë rivlerësohen në monedhë funksionale në kursin e këmbimit në datën kur është përcaktuar ajo vlerë e drejtë. Diferencat nga valutat e huaja që rrjedhin nga rivlerësimi njihen si fitim ose humbje.

#### b) Interesi

Të hyrat dhe shpenzimet nga interesi njihen si fitim apo humbje bazuar në metodën e interesit efektiv. Norma e interesit efektiv është norma që zbrit pagesat dhe arkëtimet e pritshme në të ardhmen gjatë jetëgjatësisë së aktivitetit ose detyrimit financiar (ose kur është e përshtatshme, për një periudhë më të shkurtër) deri në vlerën kontabël të aktivitetit ose detyrimit financiar. Norma e interesit efektiv përcaktohet në njohjen fillestare të aktivitetit ose detyrimit financiar dhe nuk rishikohet më pas.

Llogaritja e normës së interesit efektiv përfshin të gjitha komisionet dhe shumatat e paguara apo kostot e transaksioneve të pranuar dhe zbritjet apo primet që janë pjesë përbërëse e normës së interesit efektiv.

Kostot e transaksioneve përfshijnë kosto shtesë të ngarkueshme drejtpërdrejt për blerjen, emetimin apo largimin e një aktivi apo detyrimi financiar.

Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesi të paraqitura në humbje apo fitim përfshijnë interesat nga aktivitetet ose detyrimet financiare me kosto të amortizuar mbi bazën e interesit efektiv.



# **Banka Qendrore e Republikës së Kosovës**

## **Shënimet mbi Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018**

*(në mijë Euro, nëse nuk është theksuar ndryshe)*

---

### **3. Politika të rëndësishme kontabël (në vazhdim)**

#### **c) Tarifa dhe komisione**

Të hyrat dhe shpenzimet nga tarifat dhe komisionet të cilat janë pjesë përbërëse e normës së interesit efektiv për një mjet apo detyrim financiar, përfshihen në matjen e normës së interesit efektiv.

Të hyrat tjera nga komisionet dhe tarifat, përfshirë tarifat e transaksioneve për llogaritë operative, tarifat e transferimit të fondeve dhe të licencimit njihen në momentin e kryerjes së shërbimeve të lidhura me to.

Shpenzime të tjera për komisione dhe tarifa lidhen kryesisht me tarifa transaksionesh dhe shërbimesh të cilat shpenzohen në momentin që shërbimet përfitohen.

#### **d) Përfitimet e punonjësve**

BQK kryen kontributet për sigurimet shoqërore të detyrueshme që përcaktojnë përfitimet pensionale të punonjësve kur ata dalin në pension. Këto kontribute klasifikohen sipas planeve të kontributit të përcaktuara, bazuar në legjislacionin e Kosovës. Kontributet e BQK-së ngarkohen si shpenzim në të ardhura në momentin kur ato ndodhin.

#### **e) Tatimi dhe shpërndarja e fitimit**

BQK-ja është e përjashtuar nga tatimi mbi fitimin sipas Ligjit nr. 03/L-209 të miratuar më 22 korrik 2010. Shih shënimin 4 (f) se si BQK-ja alokon fitimin e saj.

# Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

## Shënimet mbi Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(në mijë Euro, nëse nuk është theksuar ndryshe)

---

### 3. Politika të rëndësishme kontabël (në vazhdim)

#### f) Aktivet dhe detyrimet financiare

Banka klasifikon investimet e saja në këto kategori: Aktivet financiare në vlerë reale përmes fitimit apo humbjes, kreditë dhe detyrimet, aktivet financiare të mbajtura deri në maturim dhe pasuri financiare të gatshme për tregtim. Ky klasifikim varet nga qëllimi për të cilin investimet janë siguruar. Menaxhmenti përcakton klasifikimin e investimeve të tij sipas njohjes fillestare dhe e rivlerëson këtë gjatë çdo date të raportimit.

#### **Aktivët financiarë në vlerë reale përmes fitimit apo humbjes**

Kjo kategori ka dy nënkategori: aktivet financiare të mbajtura për tregtim dhe ato të përcaktuara sipas vlerës fillestare reale të fitimit apo humbjes. Një pasuri financiare klasifikohet në “aktivet financiare me vlerë reale sipas kategorisë së fitimit apo humbjes së pësuar nëse parimisht sigurohet me qëllim të shitjes afatshkurtër, nëse formon një pjesë të portofolit të aktiveve financiare në të cilat ka dëshmi të përfitimit afatshkurtër, apo nëse përcaktohet kështu nga menaxhmenti.

#### **Kreditë dhe të arkëtueshmet**

Kreditë dhe të arkëtueshmet janë mjete financiare jo-derivative me pagesa fikse apo të përcaktueshme dhe që nuk kuotizohen në një treg aktiv përveç atyre që Banka ka për qëllim t’i shesë në afat të shkurtër apo që i ka përcaktuar në vlerën reale sipas fitimit apo humbjes apo vënë në dispozicion për shitje. Fillimisht kreditë dhe të arkëtueshmet njihen në vlerë reale dhe më pas maten në vlerën e amortizuar duke shfrytëzuar metodën e interesit efektiv, minus provizionin për efekt zhvlerësimi. Dispozitat për dëmin e kredive dhe të arkëtueshme përcaktohet kur ka prova objektive se Banka nuk do të jetë në gjendje që të arkëtojë të gjitha shumat e detyrueshme sipas kushteve fillestare. Banka nuk ka aktive të klasifikuara në këtë kategori.

#### **Mjetet financiare të mbajtura deri në maturim**

Aktivët financiarë të mbajtura deri në maturim janë pasuri financiare jo-derivative me pagesa fikse apo të përcaktueshme dhe me maturitet fiks përveç atyre që plotësojnë përkufizimin e kreditorëve dhe detyrimeve që menaxhmenti i Bankës ka qëllim dhe mundësi pozitive që të mbaj deri në maturitetit. Fillimisht aktivët njihen në vlerë reale dhe më pas maten në vlerën e amortizuar duke shfrytëzuar metodën e interesit efektiv, minus provizionin për efekt zhvlerësimi. Provizioni për dëmin e shumave të mbajtura në maturim përcaktohet kur ka prova objektive se Banka nuk do të jetë në gjendje që të arkëtojë të gjitha shumat e detyrimeve sipas kushteve fillestare.

#### **Mjetet financiare të gatshme për tregtim**

Mjetet financiare të gatshme për tregtim janë pasuri financiare jo-derivative të cilat ose përcaktohen në këtë kategori ose klasifikohen në ndonjërin nga kategoritë tjera. Banka nuk ka aktive të klasifikuara në këtë kategori.

#### *i. Njohja*

BQK-ja fillimisht njeh depozitat në datën kur ato krijohen. Të gjitha mjetet dhe detyrimet e tjera financiare njihen fillimisht në datën e tregtimit në të cilën BQK bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit.

Aktivi financiar apo detyrimi financiar fillimisht matet me vlerën e drejtë, të cilës i shtohen, për zë jo me vlerën e drejtë përmes fitimit apo humbjes, kostot e transaksionit që i atribuohen direkt blerjes apo emetimit të tyre.

# Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

## Shënimet mbi Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(në mijë Euro, nëse nuk është theksuar ndryshe)

---

### 3. Politika të rëndësishme kontabël (në vazhdim)

#### f) Mjetet dhe detyrimet financiare (në vazhdim)

##### ii. Çregjistrimi

BQK-ja çregjistron një aktiv financiar kur të drejtat kontraktuale të rrjedhjeve të parasë që vijnë nga asetë financiar mbarojnë, ose transferon të drejtat për të marrë rrjedhjet e kontraktuara të parasë mbi aktivin financiar në një transaksion në të cilin transferohen në thelb të gjitha risqet dhe përfitimet nga pronësia e asetit financiar. Çdo interes në aktivin financiar të transferuar i cili është krijuar apo mbajtur nga BQK-ja njihet si një pasuri apo detyrim i ndarë. Në çregjistrimin e një mjeti (aseti) financiar, ndryshimi në mes të vlerës bartëse të tij (ose vlerës kontabël të ndarë në pjesën e tij të transferuar), dhe shumën e (i) vlerës së marrë (duke përfshirë çdo aset të ri që ka marrë minus çdo detyrim të ri të supozuar) dhe (ii) çdo fitim apo humbje kumulative që është njohur në të ardhurat e tjera të përmbledhura, njihet si fitim ose humbje.

BQK-ja çregjistron një detyrim financiar kur detyrimet kontraktuale janë anuluar, ndërprerë apo shuar.

##### iii. Netimi

Mjetet dhe detyrimet financiare netohen me njëra-tjetrën dhe shuma neto paraqitet në pasqyrën e gjendjes financiare atëherë dhe vetëm atëherë kur BQK-ja ka të drejtën ligjore për të netuar këto shuma dhe ka si qëllim ose t'i shlyejë në një bazë neto ose të realizojë pasurinë dhe të shlyejë detyrimin njëkohësisht.

Të ardhurat dhe shpenzimet paraqiten në bazë neto vetëm atëherë kur lejohet nga standardet kontabël, ose për fitimet dhe humbjet e krijuara nga një grup transaksionesh të ngjashme.

##### iv. Matja e kostos së amortizuar

Kostoja e amortizuar e një mjeti ose detyrimi financiar është vlera me të cilën mjeti ose detyrimi financiar matet në momentin e njohjes fillestare, duke i zbritur pagesat e principalit, plus ose minus amortizimin e akumuluar duke përdorur metodën e interesit efektiv të çdo difference ndërmjet vlerës fillestare të njohur dhe vlerës në maturim, minus çdo zbritje për efekt zhvlerësimi.

##### v. Matja e vlerës së drejtë

Vlera e drejt (reale) është çmimi që do të merret për të shitur një aktive apo që do të paguhet për të transferuar një detyrim në një transaksion të rregullt mes pjesëmarrësve të tregut në datën e matjes.

Kur është e disponueshme, BQK-ja mat vlerën e drejtë e një instrumenti duke përdorur çmimet e kuotuar në një treg aktiv për atë instrument. Një treg konsiderohet si aktiv, nëse çmimet e kuotuar janë të disponueshme në mënyrë të shpejtë dhe të rregullt dhe përfaqësojnë transaksionet që ndodhin aktualisht dhe rregullisht në bazë të vullnetshme midis palëve.

Nëse tregu për instrumentin financiar nuk është aktiv, BQK vendos vlerën e drejtë duke përdorur një teknikë vlerësimi. Teknikat e vlerësimit përfshijnë përdorimin e transaksioneve më të fundit të midis palëve të mirë informuara dhe ne formë të vullnetshme, (nëse janë të disponueshme), referimin në vlerën e drejtë aktuale të instrumenteve tjera që në thelb janë të njëjta, analizat e zbritjes së rrjedhave të parasë dhe modelet e vlerësimit të çmimit. Teknika vlerësuese e zgjedhur, përdor maksimalisht të dhënat e tregut, mbështetet sa më pak të jetë e mundur në vlerësimet specifike të BQK-së, përfshin të gjithë faktorët që pjesëmarrësit në treg do t'i merrnin parasysh në vendosjen e çmimit dhe janë në përputhje me metodologjitë e pranura ekonomike për vendosjen e çmimit të instrumenteve financiare. Të dhënat për teknikat vlerësuese paraqesin në mënyrë të arsyeshme pritjet e tregut dhe masat e faktorëve të riskut që ekzistojnë në instrumentin financiar. BQK-ja kalibron teknikat vlerësuese dhe i teston ato për vlefshmërinë duke shfrytëzuar çmimet nga transaksionet aktuale të dallueshme të tregut në të njëjtin instrument apo në bazë të të dhënave tjera të dallueshme dhe të disponueshme në treg.

# Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

## Shënimet mbi Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(në mijë Euro, nëse nuk është theksuar ndryshe)

---

### 3. Politika të rëndësishme kontabël (në vazhdim)

#### f) Mjetet dhe detyrimet financiare (në vazhdim)

##### vi. Identifikimi dhe matja e dëmtimit

Në çdo datë raportimi, BQK vlerëson nëse ka evidencë objektive që mjetet financiare të cilat nuk mbahen me vlerën e tregut përmes fitimit ose humbjes janë zhvlerësuar. Mjetet financiare zhvlerësohen kur evidenca objektive paraqet që një ngjarje që sjell humbje ka ndodhur pas njohjes fillestare të aktivitetit dhe që ngjarja që sjell humbje ka një ndikim në rrjedhjet e ardhshme të parasë së aktivitetit, të cilat mund të maten me besueshmëri.

Evidenca objektive që mjetet financiare janë të zhvlerësuara mund të përfshijë mospagesa ose vështirësi financiare të huamarrësit, ristrukturimin e një depozite apo paradhënie nga BQK-ja me kushte dhe afate të cilat BQK-ja përndryshe nuk do t'i kishte konsideruar, që janë indikator se një huamarrës ose emetues i letrave me vlerë po falimenton, zhdukja e një tregu aktiv për letrat me vlerë, ose të dhëna të tjera të dukshme lidhur me një grup aktivesh si p.sh ndryshime të pafavorshme në statusin e pagesave të një huamarrësi ose emetuesi në BQK, ose kushte ekonomike që lidhen me mospagesën në kohë në BQK.

Humbja në vlerë (zhvlerësimi) i aktiveve financiare të kryer me koston e amortizuar llogaritet si diferenca mes vlerës kontabël të aktiveve financiare dhe vlerës aktuale të rrjedhjeve të vlerësuara të parave që skontohej me normën origjinale të interesit efektiv të aktivitetit. Humbjet njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe pasqyrohen në një llogari provizioni përkundrejt huave dhe paradhënieve. Interesat mbi aktivitetet e zhvlerësuara, nëse janë të zbatueshme, vazhdojnë të njihen nëpërmjet skontimeve të pandryshueshme. Kur një ngjarje vijuese shkakton zvogëlim të zhvlerësimit, zhvlerësimi anulohet nëpërmjet të ardhurave ose humbjeve.

#### g) Paraja dhe ekuivalentët e saj

Për qëllimin e pasqyrës së rrjedhjes së parasë, paraja dhe ekuivalentët e saj përfshijnë kartëmonedhat gatshme, depozita me bankat dhe aktive financiare me rrjedhje të madhe me maturitet origjinal për më pak se tre muaj, të cilat janë objekt i një Risku jo-domethënës të ndryshimeve në vlerën e tyre të drejtë dhe përdoren nga BQK-ja në administrimin e detyrimeve afatshkurtra.

Paraja dhe ekuivalentët e saj mbahen në pasqyrën e gjendjes financiar me kosto të amortizuar.

#### h) Letra me vlerë të investimit

Letrat me vlerë, që janë Bonot e Thesarit, maten fillimisht me vlerën e drejtë plus kosto të tjera të drejtpërdrejta të transaksionit, dhe në vijim trajtohen si investime që mbahen deri në maturim.

Letrat me vlerë që mbahen deri në maturim janë mjete financiare jo-derivative me pagesa fikse ose të përcaktueshme dhe maturitet fiks, të cilat BQK-ja ka synimin e pozitiv dhe aftësinë që t'i mbajë deri në maturim, dhe të cilat nuk janë përcaktuar me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes. Letrat me vlerë që mbahen deri në maturim përfshijnë bonot e thesarit.

Letrat me vlerë që mbahen deri në maturim mbahen me kosto të amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv. Çfarëdo shitje apo ri-klasifikim i një shume të konsiderueshme të investimeve të mbajtura deri në maturitet të cilat nuk janë afër maturitetit të tyre, që do të rezultonte në ri-klasifikimin e të gjitha investimeve të mbajtura në maturitet të gatshme për shitje, dhe do të parandalonte BQK-në që të klasifikojë letrat me vlerë të investimit si të mbajtura në maturitet për vitin aktual dhe dy vitet vijuese financiare.

# Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

## Shënimet mbi Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(në mijë Euro, nëse nuk është theksuar ndryshe)

### 3. Politika të rëndësishme kontabël (në vazhdim)

#### i) Prona dhe pajisjet

##### i. Njohja dhe matja

Zërat e pronës dhe pajisjeve paraqiten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga ndryshimi në vlerë.

Kosto përfshin shpenzime që janë drejtpërdrejt të lidhura me blerjen e mjetit. Kosto e mjeteve të ndërtuara nga vetë BQK-ja përfshin koston e materialeve dhe të fuqisë punëtore të drejtpërdrejtë, kosto të tjera që lidhen drejtpërdrejt me sjelljen e mjetit në gjendjen funksionale që ai të jetë i përdorshëm në mënyrën e synuar, dhe kostot e çmontimit dhe lëvizjes së pajisjeve dhe restaurimin e ambientit ku ato janë vendosur.

Programe kompjuterike të blera që janë thelbësore për funksionimin e pajisjes përkatëse kapitalizohen si pjesë e asaj pajisjeje.

Kur pjesë të një elementi të pronës dhe pajisjeve kanë jetëgjatësinë e dobishme të ndryshme, ato kontabilizohen si elemente të veçanta (komponentë kryesor) të pronës dhe pajisjes.

##### ii. Kosto pasuese

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një elementi të pronës ose pajisjeve njihet në vlerën e mbartur të elementit nëse është e mundur që përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i atij mjete të rrjedhin në BQK, dhe kostoja e tij mund të matet me besueshmëri. Kostot e servisimit të përditshëm të pronës dhe pajisjes (aktiveve afatgjata materiale) njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve në momentin kur ndodhin.

##### iii. Zhvlerësimi

Zhvlerësimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën lineare përgjatë jetëgjatësisë të secilës pjesë të një elementi të aktiveve afatgjata materiale.

Vlerësimi i jetëgjatësisë për periudhën aktuale dhe krahasuese është si më poshtë:

	2018	2017
Investimet në objekte me qira	20 vite	20 vite
Pajisje	5 vite	5 vite
Kompjuterë	3 vite	3 vite
Automjete	5 vite	5 vite

Jetëgjatësia e pajisjeve tjera vlerësohet rast pas rasti. Metoda e zhvlerësimit, jetëgjatësia dhe vlera e mbetur rivlerësohen në datën e raportimit.

#### j) Asetet e paprekshme

Programet kompjuterike të blera nga BQK-ja njihen me koston historike të zvogëluar për zhvlerësimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga ndryshimi në vlerë.

Shpenzimet e mëvonshme për programet kompjuterike kapitalizohen vetëm kur këto shpenzime rrisin përfitimin e ardhshëm ekonomik prej këtij aktivi. Të gjitha shpenzimet e tjera njihen në periudhën që ndodhin.

Shpenzimi i amortizimit njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, bazuar mbi metodën lineare të amortizimit gjatë jetës së dobishme ekonomike të programit kompjuterik, prej datës në të cilën ky program është i gatshëm për përdorim. Jeta e dobishme ekonomike e programeve kompjuterike bazohet në vlerësimin për shfrytëzimin e atij programi pa qenë nevoja për ndonjë përmirësim të madh, aktualisht nga 3 deri në 10 vite.

### 3. Politika të rëndësishme kontabël (në vazhdim)

#### k) Rënia në vlerë e mjeteve jo-financiare

Vlera kontabël e mjeteve jo-financiare të BQK-së, rishikohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka evidenca për ndryshim në vlerë. Nëse ka evidenca të tilla atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e mjetit.

Humbje nga rënia në vlerë njihet nëse vlera kontabël e një asetit ose e njësisë gjeneruese të parasë tejkalon vlerën e rikuperueshme. Njësia gjeneruese e mjeteve monetare është grupi me i vogël i identifikueshëm i asetëve që gjeneron rrjedhë të parasë që janë të pavarura nga mjetet dhe grupet e tjera. Humbjet nga rënia në vlerë njihen në pasqyrën e të ardhurave. Humbjet nga rënia në vlerë e njësisë gjeneruese të parasë shpërndahen në mënyrë proporcionale midis asetëve të tjera të njësive (grupi të njësive) në baza proporcionale. Vlera e rikuperueshme e një aktivi ose e njësive gjeneruese të parasë është më e madhja ndërmjet vlerës së tij në përdorim dhe vlerës së drejtë minus kostot e shitjes. Në vlerësimin e vlerës në përdorim, rrjedhjet e ardhshme të vlerësuara të mjeteve monetare zbriten në vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë zbritjeje para taksave që reflekton vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe risqet specifike për aktivin.

Humbjet nga rënia në vlerë të njohura në periudhat e mëparshme vlerësohen në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse rënia në vlerë është zbutur ose nuk ekziston më. Një humbje nga rënia në vlerë anulohet nëse ka pasur ndryshim në vlerësimet e përdorura për përcaktimin e vlerës së rikuperueshme. Humbja nga rënia në vlerë anulohet deri në atë masë sa vlera kontabël e aktivit nuk tejkalon vlerën kontabël që do të përcaktohej duke i zbritur amortizimin dhe zhvlerësimin, dhe sikur të mos ishte njohur ndonjë humbje nga rënia në vlerë.

#### l) Detyrimet financiare

Burimet e financimit të BQK-së janë depozitat nga institucionet ndërkombëtare, qeveritare, publike, bankare dhe institucione të tjera financiare. Detyrimet financiare maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e normës së interesit efektiv.

#### m) Të ardhurat nga grantet

Grandet qeveritare njihen fillimisht si të ardhura të shtyra kur ekziston një siguri e arsyeshme se ato do të merren dhe se BQK-ja do t'i përmbahet kushteve lidhur me grandin. Grandet që BQK-ja përfiton për shpenzime njihen si fitim ose humbje në baza sistematike në të njëjtat periudha në të cilat njihen shpenzimet. Grandet që BQK-ja përfiton për koston e një asetit njihen në fitim ose humbje në baza sistematike përgjatë jetës së përdorimit të asetit.

#### n) Pagat e financuara nga donatorët

Individë të caktuar të angazhuar në BQK janë ekspertë ndërkombëtar të caktuar dhe financiar për një afat të shkurtër nga organizatat ndërkombëtare. Financimi nga këto organizata ndërkombëtare ndër të tjera përfshin, por nuk kufizohet në pagesën e pagave të këtyre ekspertëve ndërkombëtar. Duke qenë se kjo ndihmë i paguhet personave të caktuar drejtpërdrejt nga organizatat ndërkombëtare, nivelet e pagesës nuk janë të njohura dhe as nuk janë të përfshira në këto pasqyrat financiare.

#### o) Provizionet

Provizioni njihet nëse, si rezultat i ngjarjeve që kanë ndodhur në të kaluarën, BQK-ja ka detyrime aktuale ligjore ose konstruktive që mund të vlerësohen në mënyrë të besueshme, dhe është e mundshme që një dalje e parave apo të mirave ekonomike do të kërkohet për të shlyer detyrimin. Provizionet përcaktohen duke e zbritur rrjedhjen e ardhshme të parasë me një normë para tatimit e cila reflekton vlerësimin aktual të tregut për vlerën kohore të parasë dhe kur është e përshtatshme, riskun specifike për detyrimet.

Provizioni për kontrata të ngarkuara njihet kur përfitimet e pritura për t'u nxjerrë nga BQK-ja nga kontrata janë më të vogla se kostoja e pashmangshme e realizimit të detyrimeve sipas kontratës. Provizionin matet në vlerën aktuale me më të voglën midis koston së pritshme të ndërprerjes së kontratës dhe koston së pritshme neto të vazhdimit të kontratës. Përpara se të njihet një provizion, BQK njuh çdo humbje nga rënia në vlerë e asetit të lidhur me atë kontratë.

# Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

## Shënimet mbi Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(në mijë Euro, nëse nuk është theksuar ndryshe)

---

### 3. Politika të rëndësishme kontabël (në vazhdim)

#### p) Ndryshimet në politikat dhe shpalosjet kontabël

##### (i) Standardet dhe interpretimet efektive për periudhën aktuale

Ndryshimet e mëposhtme të standardeve ekzistuese të publikuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit janë në fuqi për periudhën raportuese:

- **SNRF 9 “Instrumente financiare”** ( efektive për periudha vjetore që fillojnë me ose pas 1 janarit 2018),
- **SNRF 15 “Të ardhura nga kontratat me klientë”** dhe ndryshime të metutjeshme (efektive për periudha vjetore që fillojnë me ose pas 1 janarit 2018),
- **Ndryshimet në SNRF 2 “Pagesat e bazuara në aksione”** – Klasifikimet dhe Matjet e transaksioneve të pagesave të bazuara në aksione (efektive për periudha vjetore që fillojnë me ose pas 1 janarit 2018),
- **Ndryshimet në SNRF 4 “Kontratat e Sigurimeve”** - Zbatimi i SNRF 9 "Instrumentet Financiarë" me SNRF 4 "Kontratat e Sigurimeve" (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018 ose kur SNRF 9 "Instrumentet Financiarë" aplikohet për herë të parë),
- **Ndryshimet në SNK 40 "Prona e investuar"** - Transferet e Pronës së Investimit (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018),
- **Ndryshimet në SNRF 1 dhe SNK 28 për shkak të "Përmirësimeve të SNRF-ve (cikli 2014-2017)"** që rezultojnë nga projekti vjetor i përmirësimit të SNRF-ve (SNRF 1, SNRF 12 dhe SNK 28) kryesisht me qëllim heqjen e mospërputhjeve dhe sqarimin e formulimit (ndryshimet në SNRF 1 dhe SNK 28 duhet të zbatohen për periudhat vjetore që fillojnë me ose pas 1 janarit 2018),
- **KIRFN 22 "Transaksionet në monedhë të huaj dhe Konsiderata paraprake"** (efektive për periudhat vjetore që fillojnë me ose pas 1 janarit 2018),

Miratimi i këtyre ndryshimeve në standardet dhe interpretimet ekzistuese nuk ka sjellë ndonjë ndryshim material në pasqyrat financiare të Bankës.

# Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

## Shënimet mbi Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(në mijë Euro, nëse nuk është theksuar ndryshe)

---

### 3. Politika të rëndësishme kontabël (në vazhdim)

#### p) Ndryshimet në politikat dhe shpalosjet kontabël (në vazhdim)

##### ii) Standardet dhe interpretimet në përfundim që ende nuk janë efektive

Standardet dhe interpretimet që janë lëshuar, por që nuk janë ende efektive, deri në datën e nxjerrjes së pasqyrave financiare të Bankës, janë dhënë më poshtë:

- **SNRF 16 "Qiratë"** (efektive për periudha vjetore që fillojnë me ose pas 1 janarit 2019),
- **SNRF 17 "Kontratat e Sigurimeve"** (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2021),
- **Ndryshimet në SNRF 3 "Kombinimet e Biznesit"** - Përcaktimi i një Biznesi (efektiv për kombinime biznesi për të cilat data e blerjes është në ose pas fillimit të periudhës së parë vjetore të raportimit që fillon më ose pas 1 janarit 2020 dhe për blerjet e aktiveve që ndodhin në ose pas fillimit të asaj periudhe).
- **Ndryshimet në SNRF 9 "Instrumentet Financiare"** - Karakteristikat e parapagimit me kompensim negativ (efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019),
- **Ndryshimet në SNRF 10 "Pasqyrat Financiare të Konsoliduara" dhe SNK 28 "Investimet në Shoqëritë dhe Sipërmarrjet e Përbashkëta"** - Shitja ose Kontributi i Aktiveve midis një Investitori dhe Bashkëpunëtorit të tij ose sipërmarrjes së përbashkët dhe ndryshimeve të mëtejshme (data efektive shtyhet për një kohë të pacaktuar deri në metoda e kapitalit është përfunduar),
- **Ndryshimet në SNK 1 "Paraqitja e Pasqyrave Financiare" dhe SNK 8 "Politikat Kontabël, Ndryshimet në Vlerësimet Kontabël dhe Gabimet"** - Përkufizimi i Materialit (efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 Janarit 2020)
- **Ndryshimet në SNK 19 "Përfitimet e Punonjësve"** - Ndryshimi i Planit, Reduktimi ose Zgjidhja (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019),
- **Ndryshimet në SNK 28 "Investimet në Shoqëritë dhe Sipërmarrjet e Përbashkëta"** - Interesat Afatgjatë në Shoqëritë dhe Sipërmarrjet e Përbashkëta (efektive për periudhat vjetore që fillojnë në ose pas 1 janar 2019),
- **Ndryshimet në standarde të ndryshme për shkak të "Përmirësimeve të SNRF-ve (cikli 2015 - 2017)"** që rezultojnë nga projekti vjetor i përmirësimit të SNRF-ve (SNRF 3, SNRF 11, SNK 12 dhe SNK 23) kryesisht me qëllim heqjen e mospërputhjeve dhe sqarimin e formulimit efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019),
- **Ndryshimet në Referencat në Kornizën Konceptuale në Standardet e SNRF** (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 Janarit 2020).
- **KIRFN 23 "Pasiguria mbi Trajtimin e Taksave mbi të Ardhurat"** (efektive për periudhat vjetore që fillojnë me ose pas 1 janarit 2019).

Banka ka zgjedhur të mos miratojë këto standarde, rishikime dhe interpretime përpara datave efektive të tyre. Banka parashikon që adoptimi i këtyre standardeve, rishikimeve dhe interpretimeve nuk do të ketë ndikim material në pasqyrat financiare të bankës në periudhën e aplikimit fillestar.



# Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

## Shënimet mbi Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(në mijë Euro, nëse nuk është theksuar ndryshe)

---

### 4. Menaxhimi i rrezikut financiar

#### a) Hyrje dhe vështrim

BQK është ekspozuar ndaj risqeve të mëposhtme nga përdorimi i instrumenteve financiare:

- Rreziku kreditor
- Rreziku operacional
- Rreziku i likuiditetit
- Rrezikuu i tregut

Ky shënim paraqet informacion lidhur me ekspozimin e BQK-së ndaj rreziqeve të mësipërme, objektivave, politikave dhe procedurave të BQK-së për matjen dhe menaxhimin e riskut si dhe administrimi i kapitalit nga BQK-ja. Shënime të tjera sasiore dhe cilësore janë përfshirë përgjatë këtyre pasqyrave financiare.

#### *Struktura e menaxhimit të rrezikut*

Krijimi dhe mbikëqyrja e administrimit të rrezikut të BQK-së është përgjegjësi e Bordit të Bankës Qendrore. Menaxhmenti i BQK-së raporton rregullisht nëpërmjet Bordit Ekzekutiv të BQK-së tek Bordi i Bankës mbi praktikën e administrimit të rrezikut. Bordi Ekzekutiv, Komiteti i Investimeve dhe Departamenti për menaxhimin e rrezikut e kanë për detyrë të bëjnë hartimin dhe monitorimin e politikave të administrimit të rrezikut të BQK-së. Këto politika zbatohen më pas nga njësitë përkatëse organizative.

Politikat e administrimit të rrezikut të BQK-së janë krijuar për të identifikuar dhe analizuar rreziqet me të cilat përballlet BQK-ja, si dhe të vendos kufizime dhe kontroll të duhur për rreziqet, dhe të monitoroj rreziqet dhe respektimin e limiteve të vendosura. Politikat dhe sistemet e administrimit të rrezikut rishikohen rregullisht në mënyrë që të reflektojnë ndryshimet në kushtet, produktet dhe shërbimet e ofruara të tregut. BQK-ja, me anë të trajnimeve, standardeve dhe procedurave të administrimit, synon të zhvilloj një mjedis kontrolli efektiv dhe të disiplinuar, në të cilin të gjithë punonjësit të jenë të vetëdijshëm për rolet dhe detyrimet e tyre.

Komiteti i Auditimit të BQK-së është përgjegjës për monitorimin dhe rishikimin e pajtueshmërisë me politikën dhe procedurat e administrimit të rrezikut, si dhe për rishikimin e mjaftueshmërisë së strukturës së administrimit të rrezikut lidhur me rreziqet që përballlet BQK-ja. Komiteti i Auditimit të BQK-së ndihmohet në kryerjen e detyrave të tij nga Departamenti i Auditimit të Brendshëm. Auditimi i brendshëm ndërmer auditime të kontrolleve dhe të procedurave të administrimit të rrezikut në mënyrë të rregullt dhe ad-hoc, rezultatet e të cilave raportohen përmes Shefit të Auditimit të brendshëm tek Komiteti i Auditimit.

#### b) Rreziku kreditor

Rreziku kreditor është rreziku i humbjes financiare për BQK-në nëse një palë kontraktuese e instrumenteve financiare dështon t'i përmbush detyrimet kontraktuale të saj, dhe mund të rrjedh kryesisht nga investimet e BQK-së në letra me vlerë dhe depozita (në tregjet e parasë apo llogari rrjedhëse) në banka të tjera.

#### *Menaxhimi i rrezikut kreditor*

##### *i. Investimet dhe ekspozimi ndaj bankave tjera*

BQK-ja e kufizon ekspozimin e saj ndaj rrezikut të kreditimit duke investuar vetëm në letra të lëshuara nga qeveritë e vendeve të BE-së dhe duke pasur depozita pranë bankave të huaja, detyrimet afatshkurtra të cilave i janë vlerësuar në një nga dy kategoritë më të larta nga agjencitë ndërkombëtare të njohura për vlerësimin e rrezikut të kreditimit. Duke pasur parasysh vlerësimet e larta kreditore, menaxhmenti nuk pret që ndonjë nga palët kontraktuese të dështojë në përmbushjen e detyrimeve të veta.

# Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

## Shënimet mbi Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(në mijë Euro, nëse nuk është theksuar ndryshe)

### 4. Menaxhimi i rrezikut financiar / Menaxhimi i rrezikut kreditor (vazhdim)

#### ii. Ekspozimi ndaj rrezikut kreditor

Ekspozimi më i lartë ndaj rrezikut kreditor bëhet më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2018, paraqitet nga vlera e bartur e llogarive rrjedhëse me bankat jo-rezidente, e bonove të thesarit dhe depozitave me bankat jo-rezidente. Për detaje mbi ekspozimin referohuni shënimeve 8, 9 dhe 10.

Asnjë nga ekspozimet e BQK-së nuk është me vonesë ose me rënie në vlerë. Nuk ka ndryshime në politikat e administrimit të rrezikut nga vitet e kaluara. BQK-ja nuk mban asnjë kolateral apo ndonjë element tjetër avancues kreditor kundrejt ekspozimit ndaj rrezikut të kreditor.

#### c) Rreziku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit është rreziku që BQK-ja të ketë vështirësi në përmbushjen në kohë të duhur të obligimeve nga detyrimet e saj financiare.

#### Menaxhimi i rrezikut të likuiditetit

Qëndrimi i BQK-së në menaxhimin e likuiditetit është të sigurojë, sa të jete e mundur, që vazhdimisht të ketë likuiditet të mjaftueshëm për të përmbushur me kohë detyrimet, si në kushte normale ashtu edhe në ato të pafavorshme, pa pësuar humbje të papranueshme apo duke rrezikuar dëmtimin e reputacionit të BQK-së.

Politikat e monitorimit dhe adresimit të rrezikut të likuiditetit janë të vendosura nga Bordi Ekzekutiv i Bankës. BQK-ja menaxhon rrezikun e likuiditetit duke investuar në depozita afatshkurtra me bankat jo-rezidente dhe duke mbajtur shuma të mjaftueshme të mjeteve monetare në kasafortat e saj. Politikat e menaxhimit të likuiditetit janë të vendosura në një mënyrë të tillë që edhe në kushte të keqësura BQK-ja të jetë në gjendje të përmbushë detyrimet e saj. Pozicioni ditor i likuiditetit monitorohet dhe testimet rregullta të likuiditetit kryhen nën skenarë të ndryshëm si për kushte të tregut normale ashtu edhe për ato më të vështira. Të gjitha politikat dhe procedurat e likuiditetit iu nënshtrohen rishikimit dhe aprovimit të menaxhmentit të BQK-së. Raportet mujore që mbulojnë pozicionin e likuiditetit të BQK-së i paraqiten rregullisht anëtarëve të Komitetit të Investimeve nga Departamenti i Menaxhimit të Mjeteve.

#### Ekspozimi ndaj rrezikut të likuiditetit

### Maturiteti i mbetur kontraktual për detyrimet financiare, më përjashtim të pagesave të ardhshme të interesit

	Shënim	Vlera e bartur	Më pak se 1 muaj	1-3 muaj	3 muaj deri në 1 vit	1 vjet deri në 5 vite	mbi 5 vite
<b>31 dhjetor 2018</b>							
<i>Detyrimet jo-derivative</i>							
Ndaj bankave komerciale në vend	15	343,394	343,394	-	-	-	-
Ndaj llogarive të lidhura me FMN	16	321,854	161,711	4,265	25,590	130,288	-
Ndaj institucioneve qeveritare	17	762,901	762,901	-	-	-	-
Ndaj institucioneve publike dhe komerciale	18	110,863	110,863	-	-	-	-
Nga huamarrja/et	19	2,266	-	-	-	680	1,586
Detyrime tjera vendore	20	756	756	-	-	-	-
		<b>1,542,034</b>	<b>1,379,625</b>	<b>4,265</b>	<b>25,590</b>	<b>130,968</b>	<b>1,586</b>
<b>31 dhjetor 2017</b>							
<i>Detyrimet jo-derivative</i>							
Ndaj bankave komerciale në vend	15	331,826	331,826	-	-	-	-
Ndaj llogarive të lidhura me FMN	16	318,616	157,832	-	4,171	156,613	-
Ndaj institucioneve qeveritare	17	811,341	811,341	-	-	-	-
Ndaj institucioneve publike dhe komerciale	18	95,807	95,807	-	-	-	-
Nga huamarrja/et	19	2,266	-	-	-	453	1,813
Detyrime tjera vendore	20	756	756	-	-	-	-
		<b>1,560,612</b>	<b>1,397,562</b>	<b>-</b>	<b>4,171</b>	<b>157,066</b>	<b>1,813</b>

# Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

## Shënimet mbi Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(në mijë Euro, nëse nuk është theksuar ndryshe)

---

### 4. Menaxhim i rrezikut financiar (vazhdim)

#### c) Rreziku i likuiditetit (vazhdim)

Tabela e mëparshme tregon rrjedhjet e parasë të pa-zbritura të detyrimeve financiare të BQK-së bazuar në mundësinë më të hershme të maturitetit të tyre kontraktual. Për administrimin e rrezikut të likuiditetit që rrjedh nga detyrimet financiare, BQK-ja mban mjete likuide që përfshijnë para dhe kuivalentë të saj dhe letra me vlerë për të cilat ekziston një treg aktiv dhe likuid.

#### d) Rreziku i tregut

Rreziku i tregut është rreziku që ndryshimet që përhapen në çmimet e tregut, si normat e interesit, çmimet e kapitalit, normat e kursit të këmbimit dhe kreditë (që nuk lidhen me ndryshimet në gjendjen kreditore të huamarrësit/emetuesit) do të ndikojë në të ardhurat e BQK-së apo vlerën e instrumenteve financiare të mbajtur nga ajo. Objektivi i administrimit të rrezikut të tregut është të menaxhoj dhe kontrolloj ekspozimin ndaj rrezikut të tregut brenda parametrave të pranueshëm, ndërkohë që optimizon kthimin e investimeve.

#### *Menaxhimi i rreziqeve të tregut*

Operationet e BQK-së i nënshtrohen rrezikut të luhatjes së normave të interesit në atë masë që aktivet dhe detyrimet që bartin interes maturohen ose riçmohen në kohë apo shuma të ndryshme. Mjetet dhe detyrimet me norma të ndryshueshme janë të ekspozuara ndaj rrezikut bazë, i cili është ndryshimi në karakteristikat e riçimit të indekseve të shumëllojshëm me norma të ndryshueshme.

Veprimtaritë e menaxhimit të rrezikut synojnë të optimizojnë të ardhurat neto nga interesi bazuar mbi nivelet e normave të interesit të tregut konsistent me strategjitë e veprimit të BQK-së. Ekspozimi i BQK-së ndaj rrezikut të tregut lidhet vetëm me portofolet jo të tregtueshme.

#### *Ekspozimi ndaj rrezikut të normës së interesit - portofolet jo të tregtueshme*

Rreziku kryesor ndaj të cilit portofolet jo të tregtueshme janë ekspozuar është rreziku i humbjes nga luhatja e rrjedhjeve të ardhshme të parasë apo e vlerave të drejta të instrumenteve financiare për shkak të një ndryshimi në normat e tregut. Rreziku i normës së interesit kryesisht menaxhohet duke monitoruar diferencat midis normave të interesit dhe duke pasur limite paraprakisht të miratuara për intervalet e rivlerësimit. Komiteti i investimeve është autoriteti që monitoron zbatimin e këtyre limiteve. Një përmbledhje e pozicionit të BQK-së lidhur me diferencën midis normave të interesit të portfolios jo të tregtueshme paraqitet si më poshtë

# Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

## Shënimet mbi Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(në mijë Euro, nëse nuk është theksuar ndryshe)

### 4. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

#### (d) Rreziqet e tregut (vazhdim)

#### Ekspozimi ndaj rrezikut të normës së interesit - portofolet jo të tregtueshme

31 dhjetor 2018	shënim						mbi 5 vite
		Vlera e bartur	Më pak se 3 muaj	3-6 muaj	6-12 muaj	1-5 vite	
Llogaritë rrjedhëse me bankat e huaja	8	34,797	34,797	-	-	-	-
Letra me vlerë (Bonde dhe Bono Thesari)	9	758,890	-	-	5,998	752,892	-
Depozita me bankat e huaja	10	183,734	8,734	-	175,000	-	-
Mjete ne llogarit e ndërlidhura me FMN	11	242,849	82,706	-	-	160,143	-
<b>Gjithsej</b>		<b>1,220,270</b>	<b>126,237</b>	<b>-</b>	<b>180,998</b>	<b>913,035</b>	<b>-</b>
Detyrime ndaj bankave vendase	15	(343,394)	(343,394)	-	-	-	-
Detyrime ndaj llogarive të ndërlidhura me FMN	16	(245,441)	(85,298)	-	-	(160,143)	-
Detyrime ndaj institucioneve qeveritare	17	(762,901)	(762,901)	-	-	-	-
Detyrime ndaj entiteteve tregtare dhe publike	18	(110,863)	(110,863)	-	-	-	-
Nga huamarrja /et	19	(2,266)	-	-	-	-	(2,266)
Detyrime të tjera vendase	20	(756)	(756)	-	-	-	-
<b>Gjithsej</b>		<b>(1,465,621)</b>	<b>(1,303,212)</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>(160,143)</b>	<b>(2,266)</b>
<b>Ndryshimi</b>		<b>(245,351)</b>	<b>(1,176,975)</b>	<b>-</b>	<b>180,998</b>	<b>752,892</b>	<b>(2,266)</b>

31 dhjetor 2017	Shëni						mbi 5 vite
		Vlera e bartur	Më pak se 3 muaj	3-6 muaj	6-12 muaj	1-5 vite	
Llogaritë rrjedhëse me bankat e huaja	8	422,009	422,009	-	-	-	-
Letra me vlerë (Bono Thesari)	9	592,712	-	2,999	22,984	566,729	-
Depozita me bankat e huaja	10	68,178	8,172	-	60,006	-	-
Mjete ne llogarit e ndërlidhura me FMN	11	244,337	83,553	-	-	160,784	-
<b>Gjithsej</b>		<b>1,327,236</b>	<b>513,734</b>	<b>2,999</b>	<b>82,990</b>	<b>727,513</b>	<b>-</b>
Detyrime ndaj bankave vendase	15	(331,826)	(331,826)	-	-	-	-
Detyrime ndaj llogarive të ndërlidhura me FMN	16	(244,022)	(83,238)	-	-	(160,784)	-
Detyrime ndaj institucioneve qeveritare	17	(811,341)	(811,341)	-	-	-	-
Detyrime ndaj entiteteve tregtare dhe publike	18	(95,807)	(95,807)	-	-	-	-
Nga huamarrja /et	19	(2,266)	-	-	-	-	(2,266)
Detyrime të tjera vendase	20	(756)	(756)	-	-	-	-
<b>Gjithsej</b>		<b>(1,486,018)</b>	<b>(1,322,968)</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>(160,784)</b>	<b>(2,266)</b>
<b>Ndryshimi</b>		<b>(158,782)</b>	<b>(809,234)</b>	<b>2,999</b>	<b>82,990</b>	<b>566,729</b>	<b>(2,266)</b>

Aktivitet dhe detyrimet financiare që nuk bartin interes nuk janë të përfshira në tabelën më lartë.

# Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

## Shënimet mbi Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(në mijë Euro, nëse nuk është theksuar ndryshe)

### 4. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

#### (d) Rreziqet e tregut (vazhdim)

Rreziku i përgjithshëm jo-tregtar i normave të interesit jo të tregtueshme menaxhohet nga Departamenti i Menaxhimit të Mjeteve, i cili përdor investimet në letra me vlerë dhe depozitat në banka për të menaxhuar rrezikun e përgjithshëm që lind nga aktivitetet jo tregtare të BQK-së.

Menaxhimi i rrezikut të normave të interesit kundrejt limitit të ndryshimit të normave të interesit, plotësohet duke monitoruar ndjeshmërinë e mjeteve dhe detyrimeve të BQK-së ndaj skenarëve të ndryshëm standard dhe jo-standard të normave të interesit. Skenarët standard të cilët vlerësohen në mënyrë periodike, përfshijnë një rënie ose ngritje paralele në të gjitha kurbat e kthimit, prej 100 pikësh bazë ("pb"). Një analizë e ndjeshmërisë së BQK-së ndaj një rritje ose rënie të normave të interesit të tregut (duke supozuar që nuk ka lëvizje asimetrike të kurbave të kthimit si dhe një gjendje të pandryshueshme financiare) është si vijon:

#### 2018

	100 pb	100 pb
	Rritje	Rënie
Efekti i parashikuar në fitim (humbje)	2,454	(4,454)

#### 2017

	100 pb	100 pb
	Rritje	Rënie
Efekti i parashikuar në fitim (humbje)	1,588	(1,588)

### Ekspozimi ndaj rreziqeve të tjera të tregut/valutore të portofoleve jo të tregtueshme

BQK-ja është e ekspozuar ndaj DVT lidhur me aktivet dhe detyrimet e saj në FMN, të cilat i monitoron në vazhdueshmëri. Ekspozimi i BQK ndaj rrezikut të valutave të huaja është si vijon:

#### 2018

	100 pb	100 pb
	Rritje	Rënie
Efekti i parashikuar në fitim (humbje)	26	(26)

#### 2017

	100 pb	100 pb
	Rritje	Rënie
Efekti i parashikuar në fitim (humbje)	3	(3)

# Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

## Shënimet mbi Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(në mijë Euro, nëse nuk është theksuar ndryshe)

### 4. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

#### (d) Rreziqet e tregut (vazhdim)

31 dhjetor 2018	EUR	USD (Equivalentet në EUR)	DVT (Ekuivalenti në EUR)	Gjithsej
<b>Aktiv</b>				
Paraja e gatshme	285,376	-	-	285,376
Llogaritë rrjedhëse me bankat e huaja	34,574	223	-	34,797
Bono thesari	758,890	-	-	758,890
Depozita me bankat e huaja	175,000	8,734	-	183,734
Mjete ne llogarit e ndërlidhura me FMN	722	-	325,329	326,051
Mjetet e tjera	1,411	-	-	1,411
<b>Gjithsej</b>	<b>1,255,973</b>	<b>8,957</b>	<b>325,329</b>	<b>1,590,259</b>
<b>Detyrime</b>				
Detyrime ndaj bankave vendase	343,394	-	-	343,394
Detyrime ndaj llogarive të ndërlidhura me FMN	725	-	321,129	321,854
Detyrime ndaj institucioneve qeveritare	762,901	-	-	762,901
Detyrime ndaj entiteteve tregtare dhe publike	110,863	-	-	110,863
Nga huamarrja /et	2,266	-	-	2,266
Detyrime të tjera vendore	1,797	-	-	1,797
<b>Gjithsej</b>	<b>1,221,947</b>	<b>-</b>	<b>321,129</b>	<b>1,543,076</b>
<b>Pozicioni neto për valuta të huaja</b>	<b>34,026</b>	<b>8,957</b>	<b>4,200</b>	<b>47,183</b>
<hr/>				
31 dhjetor 2017	EUR	USD (Equivalente në EUR)	DVT (Ekuivalente në EUR)	Gjithsej
<b>Aktive</b>				
Paraja e gatshme	188,547	-	-	188,547
Llogaritë rrjedhëse me bankat e huaja	421,782	227	-	422,009
Bono thesari	592,712	-	-	592,712
Depozita me bankat e huaja	60,006	8,172	-	68,178
Mjete ne llogarit e ndërlidhura me FMN	581	-	325,183	325,764
Mjetet e tjera	9,101	-	-	9,101
<b>Gjithsej</b>	<b>1,272,729</b>	<b>8,399</b>	<b>325,183</b>	<b>1,606,311</b>
<b>Detyrime</b>				
Detyrime ndaj bankave vendase	331,826	-	-	331,826
Detyrime ndaj llogarive të ndërlidhura me FMN	581	-	318,036	318,617
Detyrime ndaj institucioneve qeveritare	811,341	-	-	811,341
Detyrime ndaj entiteteve tregtare dhe publike	95,807	-	-	95,807
Nga huamarrja /et	2,266	-	-	2,266
Detyrime të tjera vendore	2,047	-	-	2,047
<b>Gjithsej</b>	<b>1,243,868</b>	<b>-</b>	<b>318,036</b>	<b>1,561,904</b>
<b>Pozicioni neto për valuta të huaja</b>	<b>28,861</b>	<b>8,399</b>	<b>7,147</b>	<b>44,407</b>

# Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

## Shënimet mbi Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(në mijë Euro, nëse nuk është theksuar ndryshe)

### 4. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

#### (d) Rreziku i tregut (vazhdim)

BQK-ja kryesisht kryen veprime me Euro, ndërsa monedhat e huaja me të cilat merret BQK-ja janë kryesisht “Të Drejtat e Veçanta të Tërheqjes” (“DVT”). Kurset e këmbimit të përdorura për përkthimin më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 ishin si vijon:

	2018	2017
	EUR	EUR
1 DVT	1.21424	1.18747
1 USD	0.87336	0.83380

DVT-të janë aktive rezervë shtesë si mbështetje në këmbimin/transaksionet e jashtme që përcaktohen dhe mbahen nga Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN). Edhe pse DVT-të nuk janë valutë në vete, ato përfaqësojnë një kërkesë potenciale në valuta të vendeve anëtare të FMN-së me të cilat mund të këmbehen. DVT-të janë krijuar në vitin 1969 si pasojë e mungesës së aktiveve në valutat e preferuara të kohës si dollari amerikan dhe ari, vlera e DVT-ve përcaktohet si mesatare e shportës së katër valutave kryesore, euro, dollari amerikan, funta britanike dhe jeni japonez.

USD-të janë mjete në llogari rrjedhëse dhe afatizime brenda natës (si repo) me Federeal Rezerve New York.

#### (e) Rreziku operacional

Rreziku operacional është rreziku i humbjeve direkte apo indirekte që shkaktohen nga një shumëllojshmëri shkaqesh të lidhura me proceset e BQK-së, personelin, teknologjinë dhe infrastrukturën si dhe faktorët e tjerë të jashtëm përveç rrezikut kreditor, të tregut dhe likuiditetit siç janë kërkesat ligjore dhe rregullativ si dhe standardet e pranuar gjerësisht të sjelljes korporative. Rreziku operacional rrjedh nga të gjitha operacionet e BQK-së dhe prek të gjitha njësitë organizative.

Objektivi i BQK-së është të menaxhojë rrezikun operacional, për kete ka themeluar edhe Departamentin e manxhimit të rrezikut (si cili aktualisht ka nën menaxhimin vetëm vlerësimin e rrezikut operacional) dhe të balancojë evitimin e humbjeve financiare dhe dëmtimin e reputacionit të BQK-së me administrimin e kostove efektive.

Ndërsa, përgjegjësia kryesore për zhvillimin dhe implementimin e kontrolleve për monitorimin e rrezikut operacional i përket stafit menaxhues të çdo njësie organizative. Kjo përgjegjësi shoqërohet me respektimin e të gjitha standardeve të BQK-së për menaxhimin e rrezikut operacional në fushat e mëposhtme:

- kërkesat për ndarjen e detyrave dhe përgjegjësi, duke përfshirë këtu edhe autorizimin e pavarur të transaksioneve;
- kërkesat për vlerësime dhe monitorime të transaksioneve;
- përshtatshmëria me kërkesat rregullative dhe ligjore;
- dokumentimi i kontrolleve dhe procedurave;
- kërkesat për vlerësimin periodik të rrezikut operacional dhe përshtatshmërisë së kontrolleve dhe procedurave për menaxhimin e këtij rreziku;
- kërkesat për raportimin e humbjeve operative dhe propozimit të veprimeve korrigjuese;
- zhvillimin e planeve emergjente;
- trajnimin dhe zhvillimin profesional;
- standardet etike dhe të mirësjelljes;
- zvogëlimin të rrezikut, duke përfshirë dhe sigurimin, kur kjo është efektive.

Përshtatshmëria me standardet e BQK-së mbështetet nga një proces raportimi periodik mbi efektin e kontrollave të brendshme përmes Departamentit të menaxhimit të rrezikut dhe kontrollave të palnifikuara dhe ad-hoc të ndërmarra nga Auditimi i brendshëm.

# Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

## Shënimet mbi Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(në mijë Euro, nëse nuk është theksuar ndryshe)

---

### 4. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

#### (f) Rreziku operacional (vazhdim)

Gjetjet nga të segmentet e monitoruesve të pavarur të përmendur si Departamenti i menaxhimit të rrezikut operaciona dhe të Auditimit të brendshëm diskutohen me menaxherët e njësisë organizative me të cilat ato janë të lidhura dhe konkluzionet i dërgohen Komitetit të Auditimit dhe menaxhmentit të BQK-së.

#### (g) Menaxhimi i kapitalit

Në përputhje me Ligjin, BQK-ja krijon dhe mban një rezervë të përgjithshme. Rezerva e përgjithshme nuk mund të përdoret, përveç për qëllime të mbulimit të humbjeve që pëson BQK-ja. Përveç kësaj, BQK-ja do të krijojë llogari të rezervës së rivlerësimit të përealizuara që të japin llogari për fitimet dhe humbjet e përealizuara për shkak të pozicioneve të saj me DVT.

Sipas Ligjit nr. 03/L-209, të ardhurat neto ose humbja neto e BQK-së llogariten në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Fitimet në dispozicion për shpërndarje do të përcaktohen:

- duke zbritur nga fitimi neto, shumën totale të ardhurave të përealizuara të rivlerësimit, dhe duke ndarë një shumë ekuivalente në llogarinë përkatëse të përealizuara të rezervës së rivlerësimit, dhe
- duke zbritur nga llogaria e duhur e përealizuar e rezervës së rivlerësimit dhe duke shtuar në fitimet e shpërndara shumën e çfarëdo fitimi të përealizuar që është zbritur nga fitimi neto për një ose më shumë vitet e mëparshme dhe u realizuara gjatë vitit aktual financiar.

Humbjet e përealizuara nga rivlerësimi do të transferohen në llogaritë përkatëse rezervë të përealizuara të rivlerësimit deri në kohën kur këto llogari rezervë rivlerësimi kanë një bilanc zero, pasi që këto humbje do të mbulohen nga fitimi i vitit aktual, atëherë nga ana e rezervave të përgjithshme dhe më pas duke i autorizuar llogarisë kapitale.

Të ardhurat neto së pari do të shpërndahen në rezervën të përgjithshme derisa shuma totale e kapitalit fillestar dhe rezervat e përgjithshme barazohen me pesë për qind (5%) të detyrimeve monetare të Bankës Qendrore.

Pjesa prej 50% e bilancit neto të të ardhurave të realizuara që mbeten pas përmbushjes së kriterit të 5% të përmendur më lart, duhet t'i transferohet Ministrisë së Financave. Ndërsa 50% që mbetet nga të ardhurat e realizuar duhet t'i alokohet llogarisë së rezervës së përgjithshme të BQK-së.

#### (g) Menaxhimi i aktiveve

Në pajtim me Ligjin 03/L-209 dhe Ligjin 03/L-048, BQK-së i është caktuar përgjegjësia për bërjen dhe menaxhimin e investimeve të autorizuar në emër të Ministrisë së Financave.



# **Banka Qendrore e Republikës së Kosovës**

## **Shënimet mbi Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018**

*(në mijë Euro, nëse nuk është theksuar ndryshe)*

---

### **5. Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve**

Menaxhmenti diskuton me Bordin e Bankës Qendrore zhvillimin, zgjedhjen dhe paraqitjen e politikave dhe vlerësimeve kritike kontabël të BQK-së, dhe aplikimin e këtyre politikave dhe vlerësimeve. Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën historike dhe faktorë të tjerë, duke përfshirë pritshmërinë e ngjarjeve të ardhshme të cilat besohet të jenë të arsyeshme në rrethanat të caktuara.

Këto shënime shpjeguese mbështesin komentet mbi menaxhimin e rrezikut financiar (shih shënimin 4).

#### **Burimet kryesore të pasigurisë në matje**

##### **Lejimet për humbjet kreditore**

Mjetet e regjistruara me kosto të amortizuara vlerësohen për të identifikuar rënien në vlerë të aktivitetit, në bazë të politikave të përshkruara në 3(f)(vi). Përbërësi specifik në totalin e provizioneve për rënie në vlerë të mjeteve financiare të vlerësuara individualisht dhe bazohet në vlerësimin më të mirë të menaxhimit të vlerës aktuale të rrjedhjeve të pritshme të parasë që pritet të pranohen. Për të llogaritur këto rrjedhje të parave, menaxhmenti gjykon mbi situatën financiare të palës në transaksion dhe vlerës neto të realizueshme të çdo kolaterali të vendosur. Çdo aktiv me rënie në vlerë, matet bazuar mbi cilësitë e tij, dhe llogaritja e rrjedhjeve të parasë që konsiderohen të arkëtueshme aprovohet në mënyrë të pavarur.

##### **Gjykime kritike kontabël në aplikimin e politikave kontabël të BQK-së**

Gjykimet kritike kontabël të kryera gjatë aplikimit të politikave kontabël të BQK-së përfshijnë:

##### **Klasifikimi i mjeteve dhe detyrimeve financiare**

Politikat kontabël të BQK-së krijojnë mundësinë që aktivet dhe detyrimet të vendosen që në fillim në kategori të ndryshme kontabël sipas rrethanave të caktuara.

Në klasifikimin e aktiveve financiare si të mbajtura deri në maturim, BQK-ja ka treguar se ka qëllimin pozitiv dhe aftësinë për ti mbajtur mjetet deri në datën e maturimit, siç kërkohet nga politikat kontabël 3 (h).

# Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

## Shënim mbi Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(në mijë Euro, nëse nuk është theksuar ndryshe)

### 6. Mjetet dhe detyrimet financiare (klasifikimet kontabël dhe vlerat e drejta)

Tabela më poshtë paraqet klasifikimin për çdo klasë të aktiveve dhe detyrimeve financiare të BQK-së, si dhe vlerat e drejta të tyre.

Në mijë Euro 31 dhjetor 2018	Shënim	Kreditë dhe llogari të arkëtueshme	Të mbajtura në maturitet	Të tjera me kosto të amortizuar	Vlera totale e bartur	Vlera e drejtë
Paraja e gatshme	7	285,376	-	-	285,376	285,376
Llogaritë rrjedhëse me bankat e huaja	8	34,797	-	-	34,797	34,797
Bono thesari	9	-	758,890	-	758,890	758,682
Depozita me bankat e huaja	10	-	183,734	-	183,734	183,734
Aktive me FMN	11	326,051	-	-	326,051	326,051
